

الله
رسول
محمد

KEQKUPTIMET QË I BART MOSBESIMI

A thua mos po kërkojnë gjykimin e kohës
së injorancës, po për një popull që
bindshëm beson, a ka gjykim më i
mirë se ai i All-llahut?
(Surja Maide: 50)

HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)

Ky libër përfshin referencë të gjerë të ambientit të zymtë me të cilin janë të rrethuar njerëzit injorantë si edhe jetën e shpërblyer që prezentohet në Kuran. Një krahasim midis këtyre dyjave, nga natyra, fton njeriun në udhëzimin e Kuranit. Ajeti

Ai robit të vet i shpall argumente të qarta për t'iu nxjerrë juve prej errësirave në dritë. E, s'ka dyshim se All-llahu është i butë e i mëshirshëm ndaj jush. (Surah Al-Hadid: 9) sygjeron se ata që e zbatojnë Kuranin do të fitojnë shpëtimin e përhershëm.

Ky libër është përkujtues dhe paralajmërues për injorantët. Siç thotë ajeti: Këto janë një përkujtim qortues, e kush do, ai e zgjedh rrugën për te Zoti i vet. (Surja Muzemmil: 19) ata që duan të ndjekin udhëzimin e shenjtë duhet të pranojnë paralajmërimin dhe të kenë vëmendjen.

Kjo jetë është e shkurtër dhe e përkohshme. Për të gjithë njerëzit, pa ndonjë përjashtim, koha e kaluar në këtë botë është e shkurtër sikur rrahja e qerpikut. Sigurisht që është jomençuri të neglizhohet bota tjetër vetëm për hir të kënaqësisë së përkohshme të kësaj jete. Mënyra e vetme për të fituar shpëtimin e përjetshëm është të spastruarit e vetvetes nga mësimet e shoqërive injorante dhe të zbatuarit e religjionit të vërtetë, religjionit të urdhëruar nga Allahu. Ajo që pritet nga lexuesit e kësaj libere është që të bëjnë zgjidhjen e vërtetë.

Dhe thuaj: "Erdhi e vërteta e u zhdruk e kota". Vërtet, e kota gjithnjë ka qenë e zhdukur. (Surja Isra: 81)



RRETH AUTORIT

Adnan Oktar, i cili shkruan nën pseudonim Harun Jahja, ka lindur në Ankara në vitin 1956. Që nga viti 1980, autori ka botuar shumë libra mbi çështjet lidhur me besimin, shkencën dhe politikën. Ai është i njohur si autor i veprave të rëndësishme të njohura për demaskimin e mashtrimit të evolucionistëve, pretendimet e tyre të pavlefshme, dhe lidhjeve të errëta në mes të Darwinizmit dhe ideologjive të tilla të përgjakshme si fashizmi dhe komunizmi.

Të gjitha veprat e autorit kanë një qëllim të vetëm, të përcjellin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit të marrin në konsideratë besimin bazë lidhur me çështjet e tilla si ekzistenca e Zotit, unitetit dhe botën tjetër, dhe për të ekspozuar e vënë në dukje themelet e sistemeve të dobëta dhe të ideologjive çoroditëse jofetare. Më shumë se 300 veprat e tij, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, gëzojnë dhe kanë një rrjet të gjerë lexuesish në të gjithë botën.

Me vullnetin e Zotit, librat e Harun Jahja do të jetë një mjet përmes të cilit njerëzit në shekullin njëzet e një do të arrijnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kuran.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ
رَسُولُ
مُحَمَّدٍ



KEQKUPTIMET QË I BART MOSBESIMI

A thua mos po kërkojnë gjykimin
e kohës së injorancës, po për një popull
që bindshëm beson, a ka gjykim më
i mirë se ai i All-llahut?

(Surja Maide: 50)

HARUN JAHJA (ADNAN OKTAR)



PËR AUTORIN

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirë si autor i veprave të rëndësishme, të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahjasë, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej mëse 55,000 faqesh me 40,000 ilustrime. Pseudonimi i tij është një ndërthurje e emrave të Harunit (Aaron) dhe Jahja (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimeve të Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo ngrehinë të ideologjive që mohojnë fenë dhe të thotë "fjalën e fundit" në mënyrë që ta bëjë të heshtë çdo kundërshtim ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili arititë urtësinë më të lartë dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë një qëllim të përbashkët: të japin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit për të menduar mbi çështje që kanë të bëjnë me besimin, si për shembull, ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij dhe besimi në Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrejtë të kalbura të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malajzi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi. Disa nga librat e tij mund të gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane, Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze, Dhivehi (folur në ishujt Mauritius) Ruse, Serbo-Croate (Boshnjake), Polake, Malaje, Turke, Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.



Duke qënë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Mençuria dhe sinqeriteti që i karakterizon librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një ndikim i shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje të kotë, sepse këta libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Jahja.

Kjo është, pa dyshim, një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rrugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht, do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të reklamua libra të tjerë, të cilët krijojnë çoroditje në mendjet e njerëzve, i shpien ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preciz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtë mosbesimin dhe, njëkohësisht, të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysht: Arsyeja kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të tij dhe, njëkohësisht, duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit, në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysht gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të suksesshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë drejtim, librat e Harun Jahjasë marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

PËR LEXUESIN

Arsyeja pse një kapitull i veçantë i është kushtuar teorisë së evolucionit është se kjo teori përmban bazat e të gjitha filozofive anti-shpirtërore (fetare). Pasi që Darwinizmi kundërshton faktin e krijimit, dhe me këtë, ekzistencën e Zotit, në këto 140 vitet e fundit ka bërë që shumë njerëz ta braktisin besimin e tyre apo të bien në dyshim. Kështu që, të treguarit se kjo teori është një mashtrim është një detyrë e rëndësishme, e cila është ngushtë e lidhur me religjionin. Është e domosdoshme që ky shërbim i rëndësishëm t'i ofrohet secilit. Disa nga lexuesit tanë mund të kenë shansin që të lexojnë vetëm një nga librat tonë. Kështu që, ne mendojmë se është me vend që një kapitull t'ia kushtojmë kësaj teme.

Të gjitha librat e autorit shpjegojnë në dritën e vargjeve Kur'anore çështje që kanë të bëjnë me besimin dhe njerëzit ftohen që të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë sipas tyre. Të gjitha temat që kanë të bëjnë me vargjet e Allahut janë të sqaruara në atë mënyrë sa që nuk lënë hapësirë për dyshim apo pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i qartë dhe i rrjedhshëm bëjnë që lexuesi i çdo moshe dhe nga cilido grup shoqëror t'i kuptoj ato me lehtësi. Ky tregim efektiv dhe i qartë bën të mundur që ato të lexohen shumë shpejt. Edhe ata të cilët ashpërsisht kundërshtojnë natyrën shpirtërore janë të influencuar nga faktet që këto libra dokumentojnë dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

Ky dhe të gjithë librat e tjerë të autorit mund të lexohen në mënyrë individuale, apo të diskutohen në grup. Lexuesit e etshëm që të marrin sa më shumë nga librat e shikojnë të dobishëm diskutimin duke ia treguar njëri tjetrit mendimet dhe përvojat.

Përveq kësaj, është në shërbim të madh të religjionit që të kontribohet në prezentimin dhe leximin e këtyre librave, të cilat janë të shkruara vetëm për kënaqësin e Allahut. Të gjithë librat e autorit janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, ata të cilët dëshirojnë t'ju komunikojnë fenë njerëzve të tjerë, njëra nga metodat më efektive është inkurajimi i tyre që të lexojnë këta libra.

Shpresojmë se lexuesi do të shikojë pasqyrën e librave të tjerë në fund të këtij libri dhe të vlerësoj materialin e pasur në çështjet e lidhura me besimin, të cilat janë të dobishme dhe kënaqësi për t'u lexuar.

Në këta libra, nuk do të gjeni, sikurse në disa libra tjerë, pikëpamje personale të autorit, sqarime të bazuara në burime të dyshimta, stile të zhveshura nga respekti dhe nderimi i duhur i temave të shenjta, e as rrëfrime të pashpresa, dyshim-nxitëse dhe pesimiste që krijojnë dyshime në mendje dhe devijime në zemër.



KEQKUPTIMET
QË I BART
MOSBESIMI

HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)

GLOBAL PUBLISHING

Kayisdagi Mah. Degirmen Sok. No: 3
Ataşehir-Istanbul / TURKEY
Phone: (+90 216) 660 00 59

Printed by: Secil Ofset
100. Yil Mahallesi MAS-SIT Matbaacilar Sitesi
4. Cadde No: 77 Bağcılar -Istanbul / Turkey
Phone: (+90 212) 629 06 15

E-Mail: info@globalkitap.com
<http://globalkitap.com>

www.harunyahya.com/albanian
www.harunyahya.com
www.en.harunyahya.TV

PËRMBAJTJA

Hyrje	10
Të njohurit e shoqërisë injorante	15
Stili i jetës që e vë në dukje injoranca	31
Vlerat morale të injorancës	55
Besimet e devijuara të njerëzve injorantë lidhur me religjionin.....	116
Një karakteristikë e rëndësishme e shoqërive injorante: Pamundshmëria e pabindshmërisë së tyre.....	135
Të larguarit nga të keqkuptuarit që e bart mosbesimi.....	148
Konkluzion	153
Mashtrimi i evolucionit	156

HYRJE



Allahu ka krijuar jetën dhe vdekjen për një arsye të veçantë. Ai ia komunikoi këtë njeriut duke dërguar Librat të cilat sqarojnë qartë dallimin midis veprave të drejta dhe atyre të gabuara. Ky qëllim i jetës është shpallur në ajetin vijues:

Ai është që krijo vdekjen dhe jetën, për t’ju provuar se cili prej jush është më vepër-mirë. Ai është ngadhnyesi, mëkatëfalësi. (Surja Mulk: 2)

Esenca e këtij qëllimi është të nderuarit e Allahut me nderimin që i përket Atij, të zbatuarit e kufizimeve të vëna nga Ai, të mirëkuptuarit e natyrës së përkohshme të kësaj bote dhe riorientimi i të gjitha veprave dhe sjelljeve në dritën e vullnetit të Krijuesit.

Individi që sillet me përgjegjësi ndaj Krijuesit të vet do të arrijë mirësi, rehati, siguri dhe paqe në këtë botë. Mënyra më e përshtashme e jetës dhe plotësimi i të gjitha nevojave të shpirtit njerëzor tregohen në Kuran. Të qenit i vëmendshëm në ndjekjen e urdhërave të Kuranit, mund të shndërrojë jetën e njeriut në një imazh që i ngjet parajsës.

Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre. (Surja Nahl: 97)

Në ajetin e lartëpërmendur, Allahu u jep lajmin e gëzuar besimtarëve se ata që sillen sipas urdhërave të Kuranit do të kenë jetë të hareshme, duke bartur në këtë mënyrë te qenjet njerëzore një mister të rëndësishëm të jetës. Fama, prosperiteti ose pamja e mirë nuk premtojnë kurrë jetë paqësore, shpërblyese e të parrëfyeshme, përveçse kur njeriu zbaton parimet morale të Kuranit.

Kjo në të vërtetë përbën objektivin kryesore të këtij libri; ofrimin e një ilustrimi të gjallë të shqetësimeve e jorehatisë që përjeton gjatë jetës njeriu, kur bën jetë tjetër e jo atë që është menduar si e përshtatshme nga Allahu, dhe jetën e gëzuar që mund të arrijë njeriu duke kompletuar bindjen ndaj urdhërave të Allahut.

Allahu e definon mënyrën e të jetuarit para mbërritjes së Profetit Muhamed si injorante, ose si periudhë e injorancës.

Fjala injorancë, siç përdoret në Kuran, bart kuptim të ndryshëm nga konotacionet e pranuar normalisht. Në përdorimin e zakonshëm, injoranca nënkupton analfabetizmin, joarsimimin ose mos-posedimin e sjelljeve të mira. Sidoqoftë, në kuptimin Kuranor, injoranca definohet si gjendje mendore ku personi është plotësisht i pa ndërgjegjshëm për qëllimin e ekzistencës së tij në jetë, për atributet e Krijuesit të tij dhe informatat e shpalosura në Librat e Shenjta që i janë dërguar

për jetën e përtejme. Kështu, shprehja, i referohet gjendjes së pavetëdijshme dhe mënyrës së veçantë të të jetuarit që është pasojë e thjeshtë e injorancës. Sigurisht, mungesa për të kuptuar Krijuesin, botën në të cilën jetojmë dhe sistemin që na rrethon, është forma më ekstreme e injorancës. Asgjë, as mënyra moderne e të jetuarit që e adopton njeriu, as gjuha e huaj që ai e flet, as raftet me libra që ai lexon ose sjelljet e mira, nuk mund të kompenzojnë injorancën.

Shoqëria injorante është një shoqëri e tillë ku mbizotëron një pandërgjegjshmëri për injorancën. Koncepti i shoqërisë injorante, sidoqoftë nuk zbatohet te njerëzit që jetuan përpara shpalljes së Kuranit. Në rradhë të parë, shprehja i referohet të gjithë njerëzve që u shmangën nga sjelljet morale dhe mënyra e të jetuarit pasi që u shpall Kurani. Kështu ky definicion është shprehje mjaft gjithëpërfshirës.

Arsyeshmëria themelore e shoqërive injorante i bën njerëzit që të formojnë idetë e tyre personale lidhur me të drejtën dhe të gabuarën mbi të cilat ata pastaj ndërtojnë tërë jetën e tyre. Çfarë pasojash rezultojnë nga një pozicion i tillë? Përgjigja është e thjeshtë: zhvillimi i qasjes apatike ndaj temave kryciale të jetës: jeta përtej vdekjes. Një qasje e tillë, sidoqoftë, është më së shumti e dëmshme për jetën e përtejme të njeriut si dhe për çdo shpresë rreth një jete paqësore e të shpërblyer në këtë botë. Arsyeja e vetme për këtë është se sistemi moral që mbizotëron në shoqëritë injorante është krijuar vendosmërisht në bazë të të arsyetuarit të keqkuptuar. Qëllimi fundamental i jetës është pak a shumë i njëjtë për çdo individ: që të arrijë standard më

të mirë të të jetuarit gjatë jetës, e cila është e kufizuar në një mesatare prej 60-70 vjetësh...

Sigurisht ky është ideal që ka aq shumë mungesë në vizion saqë pashmangshëm e bën njeriun që të humb drejtimin në këtë botë të vogël. Një botë e tillë përfshin llojin e njerëzve me botëkuptime të ngushta e të kufizuar në të menduarit e tyre. Këta njerëz paraqesin qëndrime primitive e të thjeshta dhe u kushtojnë shumë vëmendje detajeve të vogla. Kjo ndodh për faktin se ky ideal lë pas dore shqetësimet siç janë ato se pse dhe si është krijuar njeriu. E vërteta për jetën matanë vdekjes, marrja parasysh e saj dhe përgatitjet rreth saj, janë plotësisht të papërfillshme në këtë lloj ideali.

Për anëtarin e shoqërisë injorante jeta është konkurrencë, ose betejë për të mbajtur ekzistencën e dikujt në mënyrën më të favorshme; qëllimet kryesore janë të qenit i suksesshëm e i pushtetshëm. Në këtë skajshmëri, individi ndërton ndërgjegjen vet-koncentruese. Kur njëherë të ketë fituar prosperitet, ai zhvillon lidhje të fortë ndaj parave dhe prosperitetit material. Për më tepër, statusi i arritur përcillet nga dëshira për më shumë status. Kjo ambicje e skllavëron njeriun aq thellë saqë ai nuk mund të arrijë të kuptojë injorancën e vërtetë dhe bie në të duke mos ia arritur kurrë që të lirohet nga ajo.

Një krahasim me mënyrën e të jetuarit, me të menduarit dhe vlerat morale të inkurajuara nga Kurani do të shpalos natyrën primitive e të prishur të kësaj jete.

Qëllimi I këtij libri është që të shkojë më tutje me këtë krahasim dhe të demonstrojë se deri në ç'masë arrin

vrazhdësia në të kuptuar te anëtarët e shoqërive injorante. Më tutje, ky libër ekzaminon rrënjësisht vlerat morale të këtij të kuptuari të patakt dhe paraqet mënyrën e jetesës, të zgjedhur e të gëzuar nga Allahu, si të vetmën zgjedhje për të eliminuar këtë lloj mentaliteti.

Në ajetin vijues, Allahu I drejtohet njerëzve të shoqërive injorante:

A thua mos po kërkojnë gjykimin e kohës së injorancës, po për një popull që bindshëm beson, a ka gjykim më i mirë se ai i All-llahut? (Surja Maide: 50)

TË NJOHURIT E SHOQËRISË INJORANTE



Karakteristika më e shquar dhe e qenësishme e anëtarëve të një shoqërie injorante është pagatishmëria për të zhvilluar ndjenja ndaj Allahut. Kështu, njerëzit në këtë shkallë të injorancës thjeshtë i shmangen bindjes së urdhërave të Allahut, duke zhvilluar parimet e tyre morale dhe një mënyrë të të menduarit që është në kundërshtim me çdo gjë, që aprovet si e drejtë në Kuran. Kurani, Libri i fundit i Shenjtë, ofron të gjitha përgjegjet e mundshme në të gjitha pyetjet e mundshme që mund t'i ngrisë një individ gjatë jetës së tij. Kurani ofron të gjitha shpjegimet kryesore dhe zgjidhjet të cilat i duhen atij në çdo aspekt të jetës së vet.

Përkundër ekzistimit të Kuranit, udhëzuesit të vetëm drejt rrugës së vërtetë për njerëzimin, njerëzit në këtë shkallë injorance braktisin këtë burim të saktë të urtësisë dhe

drejtohen ndaj aftësive të tyre të kufizuara të të menduarit, në mënyrë që të përcaktojnë se si të kalojnë jetën e tyre ashtu që të kenë një shpërblim nga ajo. Duke pasur parasysh këtë fakt, mentaliteti i një shoqërie të tillë dëshmon përfundimisht se është injorante kur krahasohet me mentalitetin ideal që përshkruhet në Kuran. Në kaptinat vijuese të librit, shqyrtimi i mëtutjeshëm i mënyrës së pëlqyer të të jetuarit nga shoqëritë injorante do të na ofrojë të kuptojmë më mirë natyrën e saj primitive.

Para se të vazhdojmë me mënyrën e të jetuarit dhe të kuptuarit e moralit në shoqëritë injorante, sidoqoftë, do të ishte mirë të kemi një opinion për veçoritë e saj të përgjithshme.

Në çdo epokë ka ekzistuar një shoqëri injorante

Që nga koha kur është krijuar njeriu, gjithmonë kishte dy shoqëri të ndryshme: shoqëritë injorante dhe komunitetet e besimtarëve. Të gjithë ata që dështuan së vërejturi kufizimet e vëna nga religjioni, përbëjnë shoqëritë injorante. Përkundër mospajtimeve në besim, mendimeve dhe mënyrës së të jetuarit, ekziston një shkak themelor fundamental që shtron bazën e jetës së të gjitha shoqërive injorante: mos zbatimi i religjionit të vërtetë. Anëtarët e shoqërive injorante, thjeshtë të kufizuar në mënyrë strikte në botëkuptimet ndaj jetës së kësaj bote, definoohen në ajetin vijues:

Ata që nuk presin takimin Tonë, që janë të kënaqur me jetën e dunjasë dhe kanë gjetur prehje në të, dhe ata që janë indiferentë ndaj argumenteve tona. (Surja Junus: 7)

Vërtet, ata (idhujtarët) e duan shumë këtë jetë dhe e zënë asgjë ditën e rëndë që i pret. (Surja Insan: 27)

Në asnjë mënyrë nuk është e gabuar që të gëzohen të mirat e kësaj bote. Allahu i ka krijuar këto të mira dhe ua ka dhënë ato në shërbim njerëzve. Sidoqoftë, anëtarët e shoqërive injorante, bëjnë gabim në këtë pikë: ata kurrë nuk ndjehen të kënaqur me atë që kanë dhe gjithmonë duan të kenë më tepër. Sipas fjalëve të Kuranit, ata janë të mashtruar nga kjo botë. Ajo që është më me rëndësi, është se ata kurrë nuk ndjehen falënderues ndaj Krijuesit, i vetmi që u dhuron atyre këto të mira.

Kjo është arsyeja pse, pavarësisht nga dallimet në mënyrën e të jetuarit, prosperiteti, raca, ngjyra e gjuha, të gjitha shoqëritë injorante, përgjatë historisë, kanë ekspozuar një ngjashmëri të habitshme në arsyeshmërinë dhe mentalitetin e tyre fundamental. Pavarësisht se a ishte komuniteti një ndër fiset më primitive në histori ose një civilizim madhështor që datonte nga kohërat që s'mbahen mend, ose një shoqëri bashkëkohore; qëllimi i të gjitha shoqërive që kanë një ekzistencë që i ka rrënjët në injorancë ka qenë gjithmonë një dhe i ngjashëm: përfitimi nga kjo botë.

Moraliteti i injorancës është sistem I të besuarit i trashëguar nga një gjeneratë në tjetrën

Një tipar tjetër i shoqërive injorante është mënyra se si ato sigurojnë informatat rreth jetës. Në vend se nga librat e shenjta të shpalosura nga Krijuesi, anëtarët e shoqërive injorante mbledhin gjithë njohuritë e tyre për jetën nga paraardhësit (prindërit, gjyshërit...etj). Paraardhësit, drejtues të pandryshuar të anëtarëve të shoqërive injorante, udhëzojnë gjeneratat e reja në religionin e injorancës dhe në vlerat morale që ajo inkurajon, duke mbajtur kështu vazhdimësinë e këtyre primitive të religionit. Edhe këta udhëheqës për vetën e tyre ishin të informuar mbi fundamentet e këtij religioni të korrumpuar nga gjeneratat paraprake.

Çuditërisht, ky sistem, i trashëguar nga një gjeneratë në tjetrën, nuk është vënë kurrë në pyetje. Çdo gjë që i përket informatës është pranuar si një fakt i kryer. Të gjitha vlerat e të gjykuarit, qoftë të drejta ose të gabuara, kanë kaluar te gjeneratat vijuese, të gatshme për përdorim. Natyrisht qëndrimi i këtyre nuk i inkurajon kurrë anëtarët e rinj që të vënë në pikëpyetje sistemin ose që të gjejnë çfarëdo qoftë lidhur me seriozitetin e tij.

Kurani fton që t'i kushtohet vëmendje mbështetjes pa asnjë pikëpyetje që i ofrohet këtij sistemi dhe mënyrës se si njerëzit injorantë largohen nga udhëzimi i Allahut pa ndjerë madje as nevojë që të mendohen për këtë:

E kur u thuhet atyre (idhujtarëve): “Pranoni atë që All-llahu e shpalli!” Ata thonë: “Jo, ne ndjekim atë rrugë në të cilën i gjetëm prindërit tanë!” Edhe sikur prindërit e tyre të mos kenë kuptuar dhe të mos jenë udhëzuar në rrugën e drejtë (ata do t’i pasonin)? (Surja Bekare: 170)

Fakti se ata përbëjnë shumicën e shoqërisë nuk indikon seriozitetin e shpjgimit të tyre themelor

Kurani ofron një fakt tjetër të rëndësishëm lidhur me shoqëritë injorante: ata gjithmonë përbëjnë shumicën e shoqërisë krahasuar me komunitetin e besimtarëve. Kurani na informon se besimtarët janë gjithmonë pakicë:

Po ti edhe pse lakmon (për besimin e tyre), shumica e njerëzve nuk do të besojnë. (Surja Jusuf: 103)

Por për disa prej tyre, ata nuk besojnë. (Suraja Nisa: 46)

Dhe shumica e tyre nuk e beson ndryshe All-llahun, vetëm se duke i shoqëruar (zota të tjerë) (Surja Jusuf 106)

Me siguri kjo nuk është një rastësi por një situatë e veçantë e krijuar me paramendim nga Allahu për një arsye të qëlluar. Fakti se besimtarët janë në pakicë i bën ata që moralin e tyre ta përçojnë në mënyrë sa më të vyer në këtë botë. Për më tepër, ky është një faktor që e ngritë shpërblimin e tyre

në jetën e përtejme. Kjo botë sigurisht josh, si pjesë thelbësore e të gjykuarit nga Allahu. Veçse, nëse interesimi për jetën e përtejme zotëron mendjen e dikujt tërësisht, për pasojë, veprat e atij personi me siguri që do të jenë superiore nga ato të shumicës që është mashtruar nga joshja prej të mirave të kësaj bote.

Kjo është një çështje e rëndësishme e të gjykuarit për pabesimtarët. Për shumicën e njerëzve është traditë që të ndiqen mënyrat e përgjithshme të bërjes së gjërave në shoqëri. Ata thjeshtë e marrin si të garantuar se qëndrimi i përgjithshëm i shoqërisë është ai i drejti. Mëtutje, në saje të të arsyetuarit të ngjashëm, konsiderohet se shumica paraqet të vërtetën absolute, përderisa pikëpamja e pakicës është që t'i qaset kësaj pa dyshime dhe shqetësime. Qëllimi ynë, thënë shkurtimisht, është: kur, të udhëzuar nga Allahu, ftohen për në rrugën e vërtetë, njerëzit në gjendjen e injorancës refuzojnë të pajtohen me këtë ftesë nën pretekstin jobindës se kjo nuk përputhet me urdhërat e pranuar sociale. Sidoqoftë, gatishmëria e pranuar nuk mund të jetë në asnjë mënyrë argument i së vërtetës.

Kriteri social sigurisht nuk është gjë tjetër përveç se të gjykuarit e sëmurë të të kuptuarit të lartpërmendur të vrazhdë. Njerëzit injorantë përbëjnë shumicën e komunitetit thjeshtë sepse të gjithë ata kthehen në jomirënjohjes totalë për Krijuesin e tyre, thjeshtë duke preferuar këtë botë ndaj tjetrës. Sigurisht, ata që adoptojnë qëndrimin e një shoqërie të tillë thjeshtë mashtrojnë veten.

Në Kuran, Allahu na informon shkaqet se përse njerëzit

në gjendje injorance e përbëjnë shumicën e shoqërisë dhe i paralajmëron besimtarët që të jenë kundër të konsideruarit të kësaj si një kriter për vetveten:

Në qoftë se u bindesh shumicës (mohuese që janë) në tokë, ata do të largojnë ty nga rruga e Allahut. Ata nuk ndjekin tjetër vetëm supozime dhe nuk janë tjetër vetëm se rrenacakë.

S'ka dyshim, Zoti yt e di më së miri për atë që është larguar rruga e Tij dhe Ai është më i dijsmi për të udhëzuarit. (Surja En'am: 116-117)

Shumica e tyre nuk përkojnë tjetër pos supozim, e supozimi nuk është asgjë ndaj të vërtetës. All-llahu di shumë mirë për atë që punojnë. (Surja Junus: 36)

Qëndrimi i supozuar i besimtarëve për të gjetur të vërtetën shpjegohet në Kuran:

Është e vërtetë se prej nesh ka besimtarë (myslimanë) dhe prej nesh ka që janë jashtë rrugës (jobesimtarë), e kush e pranoi islamin, të tillët mësynë rrugën e shpëtimit. (Surja Xhin: 14)

Shoqëritë injorante kanë qenë të parajamëruara gjithherë gjatë historisë

Kush e udhëzon veten në rrugën e drejtë, ai e ka udhëzuar vetëm vetveten e vet, e kush e ka bërë humbjen kundër vetvetes së vet, e askush nuk do ta bartë barrën e tjetrit. E Ne nuk dënuam askë

para se t'ia dërgojmë të dërguarin. (Surja Isra: 15)

Zoti yt nuk është i tillë që të shkatërrojë vendbanimet para se në kryeqendër të tyre të dërgoj peygamber, i cili do t'u lexojë atyre argumentet Tona, dhe Ne nuk shkatërroam vendbanime, po vetëm kur banorët e tyre ishin zullumqarë. (Surja Kasas: 59)

Ajetet e lartëshënuara tregojnë një fakt të vetëm: çdo shoqërie injorante i qe dërguar një profet që t'ua komunikojë mesazhin e Allahut. Me mëshirën e tij të pakufijshme, Allahu nuk dënon një shoqëri së cilës nuk i është komunikuar porosia e tij e shenjtë. Përmes profetëve, Allahu njoftoi njeriun se nuk ka të mirë tjetër përveç Tij dhe ua përkujtoi atyre Ditën e Gjykimit.

Edhe atyre u dërguam peygamber nga mesi i tyre (që u tha): “Adhuroni All-llahun, ju nuk keni zot tjetër pos Tij, a nuk frikësoheni!” (Surja Mu'minun: 32)

Një çështje tjetër meriton të përmendet këtu: anëtarët e shoqërive injorante insistojnë me qëllim që të mbajnë mënyrën primitive të të menduarit. Ata ekspozojnë këmbëngulje të pakuptueshme në zbatimin e religjionit të injorancës, edhe pse profetët u ofruan atyre shpjegime të qarta për ekzistencën e Allahut dhe jetën e përtejme. Në një ajet tjetër, qëndrimi i zakonshëm i njerëzve të spikatur të shoqërive injorante ndaj porosisë së shenjtë është rrëfyer hollësisht:

Ja pra, Ne nuk kemi dërguar para teje peygamber

në ndonjë vendbanim, që të mos i ketë thënë paria e begatshme e tij: “Ne i gjetëm të parët tanë në këtë fé dhe ne jemi të orientuar gjurmëve të tyre” (Surja Zuhruf: 23)

Ata kalojnë jetën e tyre në mundim e ankth

Njerëzit në gjendje injorance investojnë të gjitha shpresat dhe ëndërrat e tyre vetëm në këtë botë dhe harrojnë jetën e përtejme. Sidoqoftë, lidhshëmria që ata krijojnë për këtë jetë shpesh kthehet në një ambicje të pafre. Në këtë pikë, fati, fama ose statusi pushojnë së kënaquri trillet dhe dëshirat botërore të individit. Suksesi dhe prosperiteti vetëm shkaktajnë ambicje e lakmi të mëtutjeshme, në vend se të nxisin gjendje mendore paqësore. Një ambicje e tillë, sidoqoftë është dëmtuese për mirëqenjen fizike të njeriut. Ambicjet poashtu bëjnë që ai të humbasë vlerat morale. Vet-interesi përfundimisht i izolon ata. Edhe pse të rrethuar nga shumë njerëz, njerëzit në gjendje injorance ndjehen të vetmuar e të pasigurtë, duke mos gjetur kurrë një mik të vërtetë. Ky faktor, bashkë me faktorët e tjerë (ekzaminuar në kaptinat vijuese) u bë burim kryesor i dëshpërimit. Nën kushte të këtilla, jeta bëhet më shumë barrë se sa burim i gazmendit e i kënaqësisë.

Kjo është ajo që saktësisht u ngjan injorantëve, si rezultat i preferencave të tyre vetjake. Sidoqoftë, pavarësisht se çfarë u ngjan atyre, ata nuk e kuptojnë kurrë se çfarë u ngjan jetëve të tyre. Shumica nga ta e kuptojnë vetëm pasi të kenë kaluar tërë jetën të dhënë pas kënaqësive të kësaj bote, dhe vetëm

atëherë kur e ndjejnë se u është ofruar vdekja. Për hidhërimin e tyre, kjo ndodh shumë vonë. Madje edhe atëherë, hidhërimi nuk mbaron këtu. Allahu na informon se nuk është vetëm jetë e kësaj bote që ata kanë humbur. Për shkak të zbatimit të arsyeve primitive, këta njerëz do të ndeshin një fund të pikëllueshëm në jetën e përtejme:

Ata që përgënjeshtroan se do të takohen me All-llahun (në Ditën e Gjykimit) kanë humbur përderisa t'u vijë momenti (Kiameti) befas e të thonë: “Të mjerët ne për atë që lëshuam” (nga punët e mira në dynja), e duke i bartur gabimet e veta në shpinë, dhe, e shëmtuar është ajo që bartin. (Surja En’am: 31)

Në anën tjetër, besimtarët që kalojnë jetën e tyre pas kauzës së Allahut shpërblehen me jetë të bukur si në këtë botë ashtu edhe në botën e përtejme:

Ndaj All-llahu ua dha atyre shpërblimin e kësaj bote dhe shpërblimin më të mirë të botës tjetër; All-llahu i do punëmirët. (Surja Ali Imran : 148)

Thuaj: “Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që All-llahu i krijoi për robtë e vet?” Thuaj: “Ato janë në këtë botë për ata që besuan, e në ditën e Kiametit janë të posaçme për ta. Kështu i sqarojmë argumentet një populli që kupton. (Surja –A’raf : 32)

Ky është ajeti që fillon me:

(Ata janë ata) Të cilët besuan dhe ishin të ruajtur.

Atyre u jepen myzhde në jetën e dynjasë (në çastin e vdekjes) dhe në jetën tjetër (për shpëtim në xhennet). Premtimet e All-llahut nuk mund të pësojnë ndryshim. E, ai është suksemi i madh. (Surja Junus : 63-64)

Pse ata preferojnë jetën primitive?

• Sepse ata besojnë se çdo gjë është e kufizuar në këtë jetë

Mënyra e tyre e të menduarit është se njeriu ka trashëguar karakteristikat e injorancës, që kufizon ekzistencën e tyre në këtë botë. Kjo ka një kuptim: pranimi i kësaj bote të përkohshme si e vërtetë, dhe mospërgatitja për botën tjetër...rrjedhimisht, një qëndrim i këtitillë na bën të besojmë se këta njerëz nuk kanë besim, ose më mirë kanë besim të varfër, në jetën e përtejme. Të kënaqur me jetën së cilës vdekja do t'i jap një fund, ata në gjendje të injorancës luftojnë që të mbahen shtrëngueshëm për këtë botë. Mentaliteti i këtyre njerëzve shprehet në Kuran me fjalët e vetë atyre:

Nuk ka tjetër, pos jetës sonë të kësaj bote, vdesim, lindim dhe ne nuk do të ngjallemi! (Surja Mu'minun: 37)

Ata që kanë bindje të tillë nuk vëzhgojnë kufizimet e vëna nga Allahu dhe, në pajtim me këtë, nuk demonstrojnë dëgjueshmëri ndaj urdhërave të Tij. Një mënyrë e tillë e të kuptuarit është e bazuar në dëshirën e të qenit superior në këtë botë, duke harruar atë tjetrën.

Në këtë pikë, ka një gabim fundamental që e bëjnë këta njerëz: ata preferojnë një mënyrë të tillë të të jetuarit në tokë duke u orvatur të fitojnë më shumë nga kjo jetë. Sidoqoftë, është dëshmuar se pasojat e kësaj janë të ndryshme. Lëre anash kënaqjen në përfitimet materiale e shpirtërore, vështirë që ata nxjerrin kënaqësi nga dobia e kësaj bote.

Kjo ndodh sepse, për shkak të pandjeshmërisë së tyre ndaj nevojës për të zënë veten me kujtimin e Allahut, Allahu ose i merr prapa të mirat e Tij nga ta ose u jep zemrave të tyre një frikë të përhershme se do t'i humbasin këto të mira. Kjo vërtetë është një situatë bezdisëse sepse ata nuk mund të pushojnë kurrë nga frika rreth së ardhmes së tyre. Mendimet për këtë zënë çdo moment të jetës së tyre.

Mënyra e vetme për të përfituar nga të mirat e kësaj bote është të pasurit në zotërim të plotë të faktit se ato ua ka dhuruar Allahu. Ai që kupton këtë e di me siguri se këto të mira janë të përkohshme dhe inferiore krahasuar me të mirat në jetën e përtejme.

Këtu ngritet një pyetje e rëndësishme: a nuk ndjehen ata të frustruar dhe që përfundimisht të kuptojnë misterin e jetës? Aletnativisht, kur njëherë të kuptojnë se nuk mund të kënaqen në këtë botë, pse ende e mbajnë këtë mentalitet? Përgjigjet e ofruara nga Kurani në këtë pyetje janë eksplicite:

Këtë (dënim të madh) ngase ata më tepër e deshtën jetën e kësaj bote se sa jetën e botës tjetër, e Allahu nuk i udhëzon njerëzit jobsimtarë. (Surja Nahl: 107)

All-llahu i ofron furnizim me bollëk atij që do dhe

ia kufizon (atij që do). Po ata (jobesimtarët) janë të gëzuar me jetën e kësaj bote. E jeta e kësaj bote ndaj botës tjetër nuk është tjetër vetëm se një përjetim (i shkurtër). (Surja Rra'd: 26)

Këto ajete shpalosin rrenën e arsyeshme prapa mënyrës primitive të të menduarit që mbizotëron në shoqëritë injorante: ndjenjën e një lidhshmërie me jetën e kësaj bote dhe të harruarit e jetës së përtejme. Në kundërshtim me këtë bindje; sidoqoftë, kjo jetë është thjeshtë një skenar i dizajnuar për të vënë njeriun në gjyq. Jeta e vërtetë është në të vërtetë ajo që do të fillojë kur njeriu të nxjerrë frymën e fundit. Ky realitet lidhet me ajetin e mëposhtëm:

Kjo jetë e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se dëfrim e lojë, e jetë e vërtetë, padyshim është ajo e botës së ardhme (Ahireti), sikur ta dinin. (Surja Enkebut: 64)

Njerëzve u është zbukuruar dashuria ndaj të këndshmeve, ndaj grave, djemve e ndaj pasurisë së grumbulluar nga ari e argjendi, ndaj kuajve të stolisur, bagëtisë e bujqësisë. Këto janë kënaqësi të kësaj bote, po te All-llahu është e ardhmja më e mirë. (Surja Ali Imran: 14)

Allahu përshkruan në këto ajete joshjet e veçanta mbi të cilat njeriu bëhet më i ephëm- paratë dhe pronësitë. Por prosperiteti material nuk sjell paqe e kënaqësi. Orvatjet për të gjetur dashurinë e vërtetë dhe respektin shpesh provohen të jenë të kota. Miqësia e vërtetë poashtu kërkohet kot sepse nuk arrihet kurrë në shoqëritë injorante. Ato nuk mund të

arrihen kurrë sepse dashuria, respekti e miqësia janë të arritshme vetëm kur individi sillet në pajtueshmëri me Krijuesin e vet, duke arritur kështu përsosmërinë morale. Një besimtar i sinqertë që ka vlera morale lë një përshtypje pozitive te njerëzit e tjerë dhe ndërton një lidhje besueshmërie; në të vërtetë kjo është baza e dashurisë dhe respektit të vërtetë. Ai që është pa këto vlera morale mund të grumbullojë me shpejtësi pasuri, të ketë vilën më madhështore në botë, ose të udhëtojë në resoret pushuese më të mira të botës. Shkurt, ai mund të kënaqë shijen për secilën kënaqësi që mund ta sjell paraja. Megjithatë një prosperitet i tillë material nuk ofron kurrë paqen e mendjes dhe ndjenjën e sigurisë që i duhen atij personi. Të arriturat e tij nuk kënaqin kurrë lakminë e tij që të mund ta bëjnë të lumtur. Përkundër faktit se posedon gjithë çfarë ka nevojë, ai ende gjen shkaqe për t'u ankuar.

Në mënyrë të pashmangshme ambicjet bëhen burim i korrupsionit të thellë moral. Dëshira për para e shtyn njeriun në falsifikim, gënjeshtëri, egoizëm, vepra të padrejta dhe sjellje të tjera të këqija, të cilat bëjnë që të tërbohët e vuajë ndjenja të tensionit e ankthit.

Në Kuran, është shpallur një tjetër arsye për çka ngulmimi i shoqërisë injorante ndaj këtij të arsyetuari të vrazhdë është shpallur të jetë prirje për mburrjen të cilën e ushqen:

Dije se jeta e kësaj bote është vetëm lojë, një fjalë e kotë, një salltanet, dhe mburrje ndër ju, dhe rivalitet për pasurinë e fëmijë. (Surja Hadid: 20)

Njerëzve u është zbukuruar dashuria ndaj të këndshmeve,

ndaj grave, djemve e ndaj pasurisë së grumbulluar nga ari e argjendi, ndaj kuajve të stolisur, bagëtisë e bujqësisë. Këto janë kënaqësi të kësaj bote, por te All-llahu është e ardhmja më e mirë.

Çdo çështje që është e lidhur me jetën e kësaj bote bëhet temë për lëvdatë. Njerëzit i kushtojnë shumë rëndësi të qenit i vlerësuar nga të tjerët kështu që jeta e tyre bëhet hulumtim për të pasur gjërat për të cilat mund të lavdërohen. Arsimimi i mirë, të pasurit e një statusi të admirueshëm në shoqëri, të martuarit me një anëtar të një familjeje të spikatur ose madje edhe të pasurit e fëmijëve, për njerëzit injorantë, janë material i rëndësishëm për t'u lavdëruar. Pamja e mirë ose inteligjenca e fëmijës, shkolla të cilën e ndjek ai/ajo bëhen çështje lavdatash. Jeta që është e kufizuar në vetëm gjashtë ose shtatë dekada kalohet kështu në qetësimin e ambicjeve për pasuri, sukses ose ndonjë formë tjetër prosperiteti. Duke pasë parasysh se arsyeja kryesore për këtë dëshirë është të dëshmuarit para njerëzve të tjerë, të cilët janë të dobët e të vdekshëm si çdo njeri tjetër, kjo është diçka për të cilën duhet menduar. Mbi të gjitha, askush nuk duhet të guxojë që të humbasë jetën e përhershme me çmimin e lënjes së përshtypjes së mirë ndaj të tjerëve në këtë botë.

• Sepse para se të sillen me ndërgjegje, ata mundohen të plotësojnë dëshirat e tyre të kota

Nëse përkujtohet vetëm një gjë që lidhet me arsyet e ndjekjes së një jete primitive kur çdo gjë tjetër harrohet, sigurisht që kjo duhet të jetë tendenca e njerëzve injorantë

për të ndjekur dëshirat e tyre.

Allahu ka frymëzuar në shpirtin e njeriut dy zëra, të kundërta ndaj njëri tjetrit në natyrë. Një nga këta zëra frymëzon shpirtin me ndërgjegje se çka është e mirë dhe çka është e keqe. Nëse dikush dëgjon zërin e këtij udhëzuesi të shenjtë, që është ndërgjegja e vet, ai nuk do të devijoj nga rruga e drejtë dhe do të mbesë I urtë e me pikëpamje të qartë. Zëri tjetër, përkundrazi, thërret për një jetë në pajtim me anën negative të shpirtit të njeriut. Këta dy zëra në të vërtetë janë ndërgjegja e shpirtit (an-nafs). Ky fakt qëndron në Kuran:

Pasha njeriun dhe Atë që e krijoi atë! Dhe ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij. Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten. E ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten. (Surja Shems: 7-10)

Në punën e përkushtuar për të identifikuar dhe definuar shoqërinë injorante nga çdo aspekt, dallimi ndërmjet ndërgjegjes dhe shpirtit meriton një vëmendje të veçantë. Sepse shkaku kryesor që një person të jetë injorant është tendenca për të ndjekur trillet dhe dëshirat si dhe indiferenca e tij e plotë ndaj pëshpëritjes që e fton atë në udhëzimin hyjnor.

Në kundërshtim me të priturat e larta, jeta e shënuar nga dashuria për dobitë e kësaj bote shpirtërisht nuk shpërblehet.

STILI I JETËS QË E VË NË DUKJE INJORANCA



A do të dëshironit të kishit një jetë të përsosur të mirësisë, sigurisë e rehatisë, ku koncepti i kohës ose një jetë e kufizuar në pesë ose gjashtë dekada nuk ka ndonjë rëndësi? Ndërkohë, mbajeni në mend se dekada e parë e kësaj jete do të kalojë në pandërgjegjësinë e fëmijërisë kurse e fundit duke u marrë me shëndetin e dobët dhe problemet e tjera që sjell moshja e shtyrë.

S'ka dyshim se përsone i mençur do të preferonte një jetë të përsosur të mirësisë e rehatisë; për hir të disa dekadave ai nuk do të humbte jetën e përjetshme. Sidoqoftë, ka edhe disa sish që janë magjepsur e verbuar nga magjia e kësaj bote, e cila kalon sa të rrahësh qerpikun.

Njerëzit që preferojnë jetesën duke ndjekur dobite personale, e kuptojnë shpejt se kjo nuk është mënyrë e qëndrueshme për të realizuar qëllimet e tyre. Çfarëdo që të bëjnë ose kudo që të shkojnë, gjatë jetës së tyre ata kurrë nuk

arrijnë t'u ikin dhimbjeve e shqetësimeve. Por të kuptuarit e një realiteti të tillë shpesh vjen vonë; zakonisht, kur i ofrohet vdekja, njeriu mendon për zgjedhjet e gabuara që ka bërë.

Jeta në këtë botë, e bazuar në lidhjet e forta, ofron vetëm një kënaqësi të moderuar; ajo nuk ofron asgjë më tepër se pak jetesë dhe strehë. Në Kuran, Allahu jep arsyet për një preferencë të këtillë: mungesën e mençurisë. Pra, cilat janë tiparet e kësaj mënyre të të jetuarit, cili është thjeshtë burimi i jorehatisë e i mundimeve i cili shpie te tortura e plotë për tërë përjetësinë? Çfarë jete bëjnë njerëzit injorantë ?

Në faqet në vijim është dhënë një kornizë e plotë për ambientin që i rrethon njerëzit injorantë. Qëllimi është që të shpaloset të kuptuarit e vrazhdë që trashëgon ajo dhe të tregohet se sa e dëmshme është kjo mënyrë jetese për mirëqenjen e individit në aspektin afat shkurtër dhe aftagjatë.

Sidoqoftë, para se të hyjmë në detaje, secili duhet ta mbajë në mend se mënyra e jetesës e përshkruar këtu duhet të shihet në termat e të kuptuarit të përgjithshëm të shoqërive injorante. Kështu, edhe pse zakonisht praktikohet në shoqëri, kjo nuk do të thotë që ajo është e vërtetë për të gjithë individët. Mund të ketë njerëz që nuk përfshihen në praktikat të cilat përmenden në seksionet vijuese të kësaj libre. Sidoqoftë, qëllimi është që të shprehet natyra primitive e këtij të arsyetuarit që shpalo veten në shpirtin njerëzor në disa mënyra: nganjëherë ne e shohim atë në qasjen individuale ndaj vlerave morale; alternativisht, mund të shihet edhe në mënyrën e të jetuarit të botës egocentrike që personi ka ndërtuar për vete. Pa marrë parasysh se si e zbulon veten stili

i jetës, ka një fakt që duhet nënvizuar: njerëzit që e braktisin veten në jetën e kësaj bote, duke harruar tërësisht Ditën e Gjykimit pa asnjë kusht zbulojnë këtë primitivizëm në një mënyrë ose në tjetrën.

Jeta monotone

Ata që e pranojnë injorancën, herët a vonë zihen në kurthën e monotonisë. Të paaftë për të gjetur shkaqet e saj, ata përfundimisht i dorëzohen kësaj monotonie dhe thjeshtë e përvetësojnë si mënyrë të të jetuarit. Që nga atëherë, ata nuk orvaten të pasurojnë jetën e tyre, duke e bërë më të shëndoshë, më të rehatshme e të kënaqshme. Ata kalojnë jetën duke pritur vdekjen.

Në këtë pikë, për injorantët fillon monotonia. Në momentin që hapin sytë, ata gjenden të pushtuar nga rutina e çdoditshme. Shumë njerëz i shohin orët e gjata të kaluara në shtëpi ose në punë si diçka të kotë. Nuk është ndonjë punë e madhe që ata mund të ecin në hap me shoqërinë kur në të vërtetë ata kërkojnë diçka që t'u jap kuptim jetës së tyre. Herët në mëngjes ata lënë shtëpinë për të shkuar në punë ku takojnë njerëzit e njëjtë dhe flasin për gjëra të njëjta. Kur puna të ketë mbaruar, ata kthehen në shtëpi me veturën e njëjtë, nëpër rrugën që e ndjekin gjithmonë. Në shtëpi nuk ndodh asgjë e ndryshme; në tavolinën e darkës familja angazhohet për llafet e përditshme. Së shpejti ata fillojnë të shohin televizionin, dhe pastaj shkojnë të flenë. Kështu ata përgatiten për ditën tjetër që nuk do të sjell asgjë të re.

Duke e ditur se, në kuptimin kohor, nuk do të ndryshojë

asgjë, çdo gjë bëhet edhe më e padurueshme dhe e mundishme. Ata fillojnë të mos e pëlqejnë shtëpinë e tyre, edhe pse është e zbukuruar me kujdes e entuziazëm. Koha përfundimisht zhduk atraksionin e shtëpisë, mobiljeve, zbukurimeve, shkurt, gjithçka që e pëlqejnë. Koha poashtu i bën njerëzit që të humbasin dashurinë për njerëzit që i rrethojnë; pas një kohë ata nuk nxjerrin ndonjë kënaqësi nga raportet e tyre siç bënin dikur. Anëtarët e familjes dhe miqtë e afërt nuk ofrojnë më kënaqësinë e dikurshme; njerëzit në gjendjen e injorancës i duan ata përreth vetëm për shkak të shprehisë.

Shkak kryesor për këtë monotoni janë sigurisht qëllimet e vogla që ata kanë. Edhe personi më ambicioz në botë ka qëllime të rëndomta, kurse e tëra kjo është rezultat i të jetuarit në një botë të vogël: diplomimi në një universitet me prestigj, fitimi i një pune të mirë, martesë e lumtur, dërgimi i fëmijëve në shkollë, përmirësimi i standardeve të të jetuarit dhe përfundimisht pritja e vdekjes... thënë ndryshe, ardhja në ekzistencë, rritja dhe vdekja.

Kalimi i kufinjve të këtyre caqeve, të imponuara nga kultura e injorancës, është i pamundshëm. Të gjitha idealet janë vënë për disa dekada të jetës.

Sidoqoftë, individi, duhet t'ia përkushtojë burimet e tija plotësisht të urdhërave të Allahut me qëllim që të sigurojë kënaqësinë e Allahut. Jeta që kalohet për shkakun e Allahut nuk bëhet kurrë monotone. Secili moment bëhet burim i kënaqësisë e përkushtimit. Njeriu do të qëndrojë për pak në këtë botë, por në Parajsë, vend i lumturisë së pafundme, ai

përfundimisht do të marrë shpërblimin për atë që ka bërë. Prandaj, për besimtarin, është joutësi që të vrasë kohën kot. Përkundrazi, personi e gjen se çdo moment i kësaj jete të kufizuar është i çmuar.

Ai që ndjek urdhërat e Kuranit nuk përjeton kurrë monotoninë. Ai është njeri i mençur që në mënyrë të vazhdueshme sjell diçka të re në jetë. Ai nuk lejon kurrë që njerëzit që e rrethojnë atë ose jetën e tij të hyjnë në rreth të mbyllur. Madje edhe me burime të kufizuara e në kohëra të vështira, ai gjithnjë gjen mënyra për ta përmirësuar jetën e vet. Në moshë të shtyer, gjithashtu, entuziazmi i tij për përmirësimin e jetës nuk zhduket kurrë. Përcaktimi i tij që të ndjekë rrugën e drejtë përfundimisht i sjell jetë të mirë në këtë botë dhe në parajsë e në jetën e përtejme:

E ata thonë: “Falënderuar qoftë All-llahu që largoi prej nesh brengat; vërtet, Zoti ynë është që falë shumë dhe është bamirës. I cili nga mirësia e Tij na vendosi në vendin e përjetshëm, ku nuk do të na prekë ndonjë mundim fizik dhe ku nuk na prek ndonjë molisje. (Surja Fatir: 34-35)

Përkundër shpërblimit të këtyllë, njerëzit injorantë pranojnë kotshmërinë e jetës së tyre. Allahu, në Kuran i jep arsytet për një qëndrim të tillë:

Ata të gjithë së bashku nuk kanë guxim t’ju luftojnë, vetëm kur gjenden në ndonjë vend të fortifikuar ose kur janë pas ndonjë muri. Armiqësia ndërmjet tyre është e ashpër. Mund të mendohet për ta se janë të bashkuar, e në realitet

zemrat e tyre janë të përçara, sepse janë njerëz që nuk logjikojnë. Si shembulli i atyre jo fort moti që përjetuan të keqen e punës së vet, edhe ata kanë një dënim të rëndë. (Surja Hashr: 14-15)

Ambienti i lodhshëm

Në shoqëritë injorante njerëzit bëjnë jetë të mundimshme. Kjo sigurisht është pasojë direkte e mos vënjes së besimit në Allahun. Duke mos besuar në Allah, ata supozojnë se mund t'i shmangen përgjegjësiive të tyre ndaj Allahut dhe të kënaqen në të gjitha kënaqësitë botërore të kësaj jete. Por, për zhgënjimin e tyre, një gjë i shqetëson ata pa masë: stresi. Zgjidhja e tyre e mosbesimit qëndron vetëm në të supozuarit se një ambient ku nuk imponohet një sjellje e përshtatshme nga një ndjenjë absolute e së drejtës dhe së gabuarës por nga përkushtimi i parimeve vetjake do t'i ofronte atyre paqe, rehati e kënaqësi. Megjithatë, në kundërshtim me ato që presin ata, përvoja e tyre dëshmohet të jetë tjetër.

Shkaku kryesor për këtë bezdi është pasiguria. Kjo pasiguri është pasojë e mos besimit në Allahun. Njerëzit, që nuk mendojnë fuqinë dhe kontrollin e Allahut mbi tërë njerëzit dhe incidentet, ndjejnë frikë të vazhdueshme e parehati. Të pavetëdijshëm për fatin, i cili është nën kontroll të plotë vetëm të Allahut, ata luftojnë të përballen me tërë jetën. Sipas kësaj arsyeshmërie ata, në çdo moment, mund t'i godasë fati i ligë kurse ata do të jenë të dobët e të pandihmë.

Ndaj çdo gjëje që ndodh, ata kanë qasje negative. Frikë e

madhe i rrethon ata nga çdo anë. Të ngarkuar me stres, mendjet e tyre dështojnë të gjejnë zgjidhje për problemet. Sikur të trajtonin këto probleme duke qenë në gjendje të qetë mendore, këto do të ishin çështje minore për t'u zgjidhur. Kryesisht ata janë të palumtur, çdo gjë që takojnë gjatë jetës, pa marrë parasysh se a është e rëndësishme ose e kotë i bën ata të tendosur. Veçanërisht situatat që ata i përshkruajnë si të pafat bëhen burim kryesor i stresit për ta.

Megjithatë, ajo që është e zakonshme për këta njerëz është dëmi që ata i shkaktojnë shëndetit të tyre mental. Fjalitë që fillojnë me çka nëse...? I preokupojnë mendjet e tyre me skenare shkatërruese. Një biznesmen, për shembull, i merr parasysh të gjitha pasojat e mundshme të humbjes së një takimi të rëndësishëm që do të mbahet javën tjetër: çka nëse i ikën aeroplani dhe nuk mund të arrijë me kohë në takim?; cila do të ishte humbja e tij në situatë të tillë?; si mund t'ia shpjegojë situatën shefit të tij? Janë vetëm disa nga pyetjet që i shkojnë nëpër kokë. Ky qëndrim, nuk është i kufizuar në vetëm një temë. Një qasje e tillë është e vërtetë për çdo aspekt jetësor, siç është shëndeti, familja e miqtë, çështjet shoqërore e ekonomike, vetëm disa nga to. Problemet e imagjinuara të bashkëshortëve të tyre, fëmijëve e miqve e shtojnë stresin.

Në anën tjetër, besimtarët që janë në pajtim me urdhërat e Kuranit, ndjejnë thellë në zemrat e tyre paqe, rehati e lumturi. Duke qenë të ndërgjegjshëm për ekzistencën dhe fuqinë e Allahut, ata kurrë nuk tronditen nga hallet e shqetësimet. Ata i zgjidhin problemet me mençuri. Nëse hasin

në vështirësi gjatë zgjidhjes së problemit, kjo nuk ua then shpirtin. Ata e dijnë, se çfarëdo që të ndodhë, ka një të mirë në vete. Sërish, në një gjendje të paqme mendore, ata shikojnë se si të përmirësojnë situatën. Me një qëndrim të këtillë, rrjedhojë e drejtëpërdrejtë e besimit të tyre në Allah, ata qëndrojnë larg nga çfarëdo e keqe që mund të jap stresi e tensionimi në trupin e shpirtin e njeriut.

Besimtarët nuk e humbin kurrë besimin e tyre te Allahu; humbja materiale, një aksident ose sëmundje nuk e prekin besimin e tij ndaj Krijuesit, meqë e dijnë se në çdo gjë ka një të mirë. Ata e dijnë se, përveç Allahut, njerëzit nuk kanë mbrojtës ose ndihmës tjetër... në situatat ku veçanërisht rrethanat nuk janë të favorshme, ata shpejt vërtetohen se kjo është provë e Allahut. Allahu ofron arsytet themelore për këtë qëndrim në ajetin vijues:

Juve u është bërë obligim lufta, ndonëse ju e urreni atë. Por mund që ju ta urreni një send, e ai është shumë i dobishëm për ju, dhe mund që ju ta doni një send, e ai është i dëmshëm për ju. All-llahu di (fundin e çdo sendi) e ju nuk dini. (Surja Bekare: 216)

Njerëzit injorantë janë në mënyrë të veçantë të lëndueshëm. Stresi, pasojë e arsyes së pakuptimtë, shkakton dëm të pakthyeshëm në trupin dhe shpirtin e tyre. Derisa ndjekin deri në pambarim kënaqësinë e jetës, ata e gjejnë veten të mbuluar nga hidhërimi i brengave të tyre të paarsyeshme. Përveç kësaj bote, ata humbin edhe jetën e përtejme. Nëse, sidoqoftë, do ta kalonin kohën e tyre duke

menduar për jetën e përtejme, në vend se të prodhojnë skenare negative, që janë thjeshtë pjellë e imagjinatës, ata sigurisht që do të arrinin lumturinë si në këtë, poashtu edhe në botën e përtejme.

All-llahu bleu prej besimtarëve shpirtërat dhe pasurinë e tyre me xhennet. Luftojnë në rrugën e All-llahut, mbysin dhe mbyten. (All-llahu dha) Premtim të cilin e vërtetoi në Tevrat, Inxhill e Kur'an. E kush është më zbatues i sigurt i premtimit të vet se All-llahu? Pra, gëzonju marrëveshjes që bëtë me Të. Ky është sukcesi i madh. (Surja Tevbe: III)

Dhënja rëndësi njerëzve bazuar në pasurinë e tyre, statusin e pamjen e mirë

Njerëzit e pasur vlerësohen lartë nga injorantët. Sa më shumë para që të ketë personi, aq më i respektuar bëhet.

Në shoqëritë injorante nuk fitojnë nderin vlerat morale, serioziteti dhe modestia. Këto në të vërtetë nuk janë virtyte të cilave iu kushton rëndësi injoranca. Duke qenë bazë e vetme e të gjitha raporteve dhe vlerave, paraja paraqet një strukturë krejtësisht tjetër të vlerave morale dhe botëkuptimeve në shoqërinë injorante; në këtë sistem secili dhe çdo gjë ka një çmim dhe nuk ka asgjë që nuk mund të realizohet derisa e paguani çmimin.

Për shkak të këtij të ashtuquajturit superioritet, njerëzit në gjendje të injorancës ndjejnë një admirim të jashtëzakonshëm

për elitën e shoqërisë. Pa marrë parasysh se sa janë ata të korrumpuar, mënyra e tyre e jetesës çmohet shumë, madje edhe imitohet. Sipas kësaj filozofie, personi, megjithëse krejtësisht i korrumpuar moralisht, mund të zë një status të lartë e të respektuar në shoqëri.

Si pasuria, edhe statusi dhe pamja e mirë, gëzojnë një admirim poashtu në shoqëritë injorante. Shpesh, edhe pa e pasur as idenë më të vogël për karakterin e personit, injorantët mendojnë se një person është superior ndaj të tjerëve për shkak të pamjes së tij ose pozitës së tij prestigjioze në biznes. Në të vërtetë ky është sistem mbi të cilin qëndron shoqëria injorante. Qysh në fëmijërinë e hershme, të gjithë anëtarët e shoqërisë i mësojnë këto vlera dhe fillojnë të jetojnë sipas tyre. Secili e di se cilës klasë shoqërore i përket, dhe cilat dobi e përparësi i përkasin duke qenë anëtar i asaj klase. Pasuria ka një përparësi ndaj varfërisë, sikurse përparësia që e gëzojnë njerëzit e shkolluar ndaj analfabetëve dhe njerëzit e njohur ndaj qytetarëve të thjeshtë. Ky është burimi kryesor qesharak i lakmisë dhe ndjenja e inferioritetit ndaj këtyre njerëzve që duket se kanë gjetë vend më të mirë në këtë jetë se të tjerët. Ndjenjat e tilla i shtyjnë pashmangshëm njerëzit në konkurrencë. Ata ia kushtojnë tërë energjinë, të menduarit për aftësitë dhe kohën e angazhimit në betejë për këtë status. Një konkurrencë e tillë pashmangshëm i bën njerëzit të harrojnë qëllimin e ekzistencës së tyre.

Si pasojë e indoktrinimit shoqëror, ata që mendojnë se janë superiorë, supozojnë se kanë të drejtë të kenë kontroll

shtypës ndaj të tjerëve. Kierarkia e pashkruar që mbizotëron në shoqëri, për shembull, bën që pronari të bezdisë qiramarrësin e tij. Ngjashëm, qiraxhiu mendon se ka të drejtë të bezdisë rojtarin. Rojtari ushtron autoritetin në shtëpi, mbi gruan, dhe sipas kësaj mënyre gruaja mbi fëmijët. Në botën e tyre, ka një hierarki të superioritetit. Në këtë hierarki secili i di të drejtat e tija individuale dhe kufizimet e autoritetit të tij.

Sigurisht ky është një sistem i sjelljes shoqërore me të meta. Njerëzit në këtë gjendje injorance krijojnë një sistem dhe pastaj ballafaqohen me vështirësi që të pajtohen me rregullat e sistemit që vetë e kanë krijuar. Ky është rezultat i drejtpërdrejtë i të arsyetuarit të patakt. Sidoqftë, në vend se të zhdukin këtë gabim fundamental, njerëzit injorantë luftojnë të gjejnë mënyra për të qenë të suksesshëm në këtë konkurrencë të pamëshirshme.

Në kundërshtim me kriteret e shoqërisë injorante për superioritetin, me fjalë të tjera pasurinë, pushtetin e statusin, superioriteti i vërtetë fton për besim në Allahun dhe frikën nga Allahu. Ngjyra e dikujt, pamja e mirë ose prosperiteti nuk kanë rëndësi në prezencën e Allahut. Një ditë, secili, i varfër ose i pasur, i bukur ose i shëmtuar, do të hidhet në qefin ku trupi i tij do të reduktohet në parëndësi.

Kurani vendos kriteret reale për njeriun:

O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat) e All-llahu është i dijshtëm

dhe hollësisht i njohur për çdo gjë. (Surja Huxhurat: 13)

Duke jetuar në një komunitet njerëzish, që kanë një zotërim të brendshëm të këtij të arsyetuari kuranor, sigurisht që është burim i madh i komfortit. Një ambient ku konceptet e dashurisë e të respektit janë të izoluara nga vlerat morale dhe të zëvendësuara nga virtyte si ndershmëria, ndërgjegjësimi moral etj, i jep një fund natyror këtij konkurrimi të pamëshirshëm. Një konkurrim i tillë duhet zëvendësuar duke u orvatur për të qenë në rrugë të Allahut. Allahu shpall superioritetin e atyre që luftojnë në rrugën e Allahut:

Të tillët janë duke nxituar drejt të mirave dhe të parët do t'i arrijnë ato. (Surja Mu'minun: 61)

Secili (popull) ka një anë, të cilës ai i kthehet, ju shpejtoni kah punët e mbara, kudo që të jeni All-llahu ka për t'ju tubuar të gjithëve, All-llahu ka fuqi për çdo send. (Surja Bekare: 148)

I besojnë All-llahut dhe së ditës, këshillojnë për të mirë dhe largojnë nga të këqijat përpiqen për punë të dobishme, edhe ata janë prej të mirëve. (Surja Ali Imran: 114)

Ata jetojnë në një ambient ku urtia e ndërgjegja nuk kanë vend

Sistemi i injorancës nuk le hapësirë për të menduar; kjo do të thotë të jetosh pa menduar, të flasësh pa menduar, të

japësh vendime pa menduar, të implementosh pa menduar... Njerëzit injorantë e konsiderojnë të menduarit sikur humbje kohe, dhe çka është më me rëndësi, e përceptojnë këtë si të mundimshme, meqë definitivisht kjo fton për ndërgjegje e mençuri, dy koncepte që nderohen vetëm në teori por kurrë në praktikën e mënyrës injorante të të jetuarit. Në vend të kësaj, pa ia nënshtruar ato hulumtimit të plotë, njerëzit aplikojnë dhe vëzhgojnë rregullat, parimet e traditat që i bëjnë vetë, sigurisht një mënyrë e lehtë e të jetuarit që kurrë nuk kërkon të mendojnë.

Për shembull, meqë janë të udhëzuar ata e dijnë saktësisht se çfarë duhet të bëjnë. Në rast urgjence ose të një situatë të papritur, atyre u mungon iniciativa për të ofruar zgjidhje për problemin. Kjo është thjeshtë sepse ata janë mësuar në zgjidhje të gatshme. Habia dhe të vepruarit pavendosmërisht janë vetëm disa nga pasojat e mos të aplikuarit të urtisë e ndërgjegjes.

Ngjashëm, injorantët shfaqin apati ndaj risive. Përveç në rast zori, ata shprehin ngurrim për të prodhuar çfarëdo gjëje të re, pavarësisht se për çka është fjala. Një shembull nga përditshmëria i bën këto shpjegime më të qarta. Njerëzit injorantë janë të gatshëm të blejnë çfarëdo që u servojnë dizajnerët, sado qesharake që të jetë ajo. Vetëm për të qenë në hap me modën, ata veshin rroba që duken qesharake. Ata rrallë e përdorin gjykimin e shëndoshë që të duken mirë. Ngjashëm, të përcaktuara nga tendencat e përgjithshme të modës, janë edhe preferencat sa i përket zbukurimit të shtëpisë, filmave, argëtimit, shfaqjeve televizive etj.

Gjatë përditshmërisë, pikëpamjet shpalosen në shumë mënyra. Kur takohen me lypësin me duar të shtrira në rrugë, ata nuk mund të ecin anash, por i japin ca para. Sidoqoftë, ky është një veprim reflektiv, që është rezultat i procesit të të mësuarit e jo vendim i ndërgjegjshëm. Në situatë tërësisht tjetër, është plotësisht e mundur që ata do të vepronin në mënyrë të pamenduar e të pandjeshme. Gjatë jetës është e mundshme të jemi dëshmitarë të qindra shembujve të këtyre veprimeve reflektive. Esenca e çështjes është se pasojat e pamendueshmërisë shprehimore mund të jenë më serioze se sa që dikush mund të imagjinojë. Sigurisht, e meta më e madhe është të kuptuarit e varfër të madhësisë së Allahut dhe të ekzistencës së jetës së përtejme. Në Kuran, shkaqet për këto karakteristika të shoqërisë injorante janë shpallur shumë thjeshtë:

“... sepse janë njerëz që nuk logjikojnë...” (Surja Hashr: 14)

Në anën tjetër, besimtarët janë ata që kanë një mendjehollësi për rëndësinë e urtisë e të ndërgjegjes. Në çdo aspekt të jetës, ata shfrytëzojnë përparësitë e kësaj të mire deri në masën më të madhe. Ata përsiasin për çdo incident që i godet edhe ndërmarrin vepra të mençura e të menduara mirë. Besimtarët mësojnë nga këto incidente dhe fitojnë përvojë të shkëlqyer për ta përdorur më vonë në jetë. Ata kurrë nuk angazhohen në praktika të trashëguara, pa parashtruar pyetje paraprakisht. Nëse sistemi ia del që t'i ofrojë atyre diçka vërtetë të mirë, ata e përvetësojnë atë. Ndërkohë, ata nuk lejojnë që komponentat jo të përdorshme

të këtij sistemi të ndikojnë në jetët e tyre, dhe nuk humbin kohë në ndryshimin ose përmirësimin e kushteve, nëse kërkohet ripërtrirja. Ajo që është më me rëndësi, ata jetojnë jetë të qetë e të shpërblyer në këtë botë, dhe gjithashtu duke iu falënderuar sjelljes së tyre të konsideruar arrijnë lumturinë në përjetësi. Këto janë të mirat aktuale që sjell ndërgjegja e mençuria.

Degjenerimi

Ato të cilave i referohemi si vlera morale, janë koncepte të paraqitura nga religjioni e që e bëjnë jetën të bukur e të shpërblyer. Saherë që këto vlera shtrembërohen, ballafaqohemi me pamje shqetësuese në shoqëri. E para, në një ambient ku nuk ka rregulla e kufizime, mbizotëron paligjshmëria. Në këtë sistem, secili vë rregullat e parimet e veta, të bazuara në kritere tepër të ndryshme. Parimi bazë që aplikohet në shoqëritë injorante është që të mos shkohet në ekstreme të sjelljes shoqërore që do të nxisin reagime shoqërore. Është e pranuar gjerësisht se mund të bëhet çdo e padrejtë, përderisa kjo nuk bëhet publike. Njerëzit injorantë mbajnë fjalime për sjelljen virtuozë e morale, ose i dënojnë ata që kanë pikëpamje të tjera. Sidoqoftë, ata për vete i shkelin këto vlera saherë që janë të bindur se nuk i sheh askush.

Ky në të vërtetë është themeli kryesor mbi të cilin qëndron filozofia e tyre. Ata kurrë nuk mendojnë se Allahu i rrethon në çdo moment, ata kurrë nuk e konceptojnë se Ai sheh çdo vepër që ata bëjnë dhe dëgjon çdo fjalë që ata lëshojnë. Ata e shohin degjenerimin si një mënyrë moderne të të jetuarit.

Ata frikësohen se do të jenë të poshtëruar nëse nuk e projektojnë imazhin e personit modern. Ky imazh para së gjithash thërret për talljen e vlerave morale siç është ndershmëria. Për shembull, dikush që ia kthen pronarit paratë që ka gjetur në rrugë, është qesharak. Në një situatë të tillë, sjellja e pranueshme sipas njerëzve injorantë do të ishte që paratë të mos ktheheshin. Ky shembull reflekton vetëm një aspekt të të kuptuarit të vlerave morale në shoqëritë injorante. Konceptet si ndershmëria dhe thjeshtësia gjithashtu humbin rëndësinë e tyre. Falsifikimi dhe të gënjerit pranohen si diçka normale. Personi mund të kryejë vjedhje meqë nuk sheh asgjë të keqe në të. Ngjashëm, në këtë sistem secili mund të gënjejë sa herë që të dojë. Në këtë sistem ata që mendojnë ndryshe nuk kanë të drejtë të kundërshtojnë sepse edhe ata kanë të drejtë të sillen lirisht (!) në pajtueshmëri me vlerat e tyre morale.

Kurani e bën të qartë se njerëzit që zbatojnë vlerat morale të kohës së injorancës vuajnë për këtë:

All-llahu nuk u bën asgjë të padrejtë njerëzve, por ata i bëjnë të padrejtë vetes së tyre. (Surja Junus: 44)

Në shoqëritë ku njerëzit zbatojnë vlerat religjioze, ata sillen me përgjegjësi ndaj njëri tjerit meqë kanë frikë nga Allahu. Ata kurrë nuk denjojnë që të jenë të pandershëm ose të pasinqertë, dhe sigurisht kurrë nuk i shtypnë gjërat deri në ekstreme për t'i bërë gjërat të vështira për të tjerët. Vlerat morale bëhen bazë e të gjitha akteve dhe sjelljeve.

Raportet e bazuara në interes në vend se në ndershëmri e sinqeritet

Raportet e nxitura nga baza interesi, gjithashtu një tipar ky i shoqërive injorante, nuk e lejojnë fromimin e shoqërive të sinqerta. Miqësitë e vërteta kërkojnë sakrificë dhe të menduar; njeriu duhet të marrë parasysh nevojat dhe interesat e personit tjetër dhe të synojë mënyra për të ofruar paqe dhe rehati ndaj tij/saj. Një qasje e këtillë, sidoqoftë, është në kundërshtim të plotë me të arsyetuarit e njerëzve injorantë. Arsyeshmëria e tyre primitive fton për bindje jo paqësore ndaj interesave vetjake për idetë e gabuara se jeta është e shkurtër dhe bota një vend i përkohshëm.

Kjo mënyrë e të arsyetuarit sjell dëm e jo dobi.. Telashtet e shkaktuara nga kjo qasje vetjake l prekin më së shumti ata. Gjatë tërë jetës, ata duhet të kalojnë kohën në një ambient ku nuk përjetojnë kurrë dashurinë dhe respektin e vërtetë. Ata e dijnë gjithmonë se miqësitë e tyre bazohet në interesa të dyanshme. Pa dyshim që ata e ndjejnë se në kohë të turbullta miqtë e tyre do të largohen. Ata u qasen njerëzve të tjerë me mentalitet të njëjtë. Megjithatë gjatë tërë jetës së tyre ata ankohen se nuk kanë miq të vërtetë.

Njerëzit që janë injorantë supozojnë një qasje vet-sakrifice ndaj miqve të tyre vetëm kur besojnë se do të kenë ndonjë përparësi. Përkohësisht ata shtiren sikur janë miq të mirë. Megjithatë, kur përparësitë që fitohen nga lidhja të kenë kaluar, ata mbajnë një qasje të largët e të ftohtë, duke lënë të kuptohet se ata nuk kanë më nevojë për një lidhje të tillë.

Ky në të vërtetë është një proces shumë i njohur. Është interesant fakti se askush nuk dënon të tjerët ose nuk i kundërvihet këtij sistemi, sepse të gjithë anëtarët e shoqërisë injorante mendojnë në mënyrë të njëjtë. Madje edhe martesat dhe raportet ndërmjet anëtarëve të ngushtë të familjes janë të bazuara në këtë sistem. Në vend se të ofrojnë besim, dashuri e respekt, të dyja palët i qasen njëra tjetrës me qëllim që të përfitojnë ndonjë dobi. Në përgjithësi gratë e shohin martesën si garancë për të ardhmen. Xhirrollogaria bankare e burrit të ardhshëm në të shumtën shërben si siguri jetësore. Edhe pse nuk thuhet haptazi, martesat konsiderohet si kontratë. Nëse njeriu është i pasur, gruaja supozon se ka bërë një zgjidhje të duhur. Burri e ndjen të njëjtën gjë dhe supozon se është ai që ka mashtruar tjetrin. Sikur në të gjitha punët, ai synon që të ketë disa dobi; gruaja e tij e bukur bëhet diçka më të cilën ai lavdërohet. Tekefundit, ai siguron ekzistencën e dikujt në shtëpi, kurse gruaja gjatë tërë jetës do të kryejë në qetësi punët shtëpiake, të hekurosë këmishat e tij dhe të kujdeset për fëmijët.

Sistemi i tillë është pashmangshëm pasojë e të qenit larg nga botëkuptimet islamike. Të shikuarit e njeriut si një mjet për të realizuar qëllime të veçanta është, në një masë të madhe, pjesë e dëmit që shkaktohet nga jobesimtarët në shoqëritë që janë zhytur në injorancë.

Kjo arsyeshmëri e shtrembëruar është bartur gjithashtu te brezat e rinj. Të ndikuar nga prindërit e tyre, fëmijët fillojnë t'i shohin ata si furnizues të cilët kujdesen për ta, i marrin nga shkolla, dhe përfundimisht aranzhojnë për ta një profesion të

respektueshëm. Në anën tjetër, prindërit i shohin fëmijët si pronë në të cilën duhet investuar. Qëllimi i tyre final është që të kenë dikë që do të kujdeset për ta kur të plaken. Këto qëllime, që kurrë nuk thuhet zëshëm, por ndjehen e përjetohen intenzivisht, e preokupojnë mendjen e të gjithë individëve në shoqëritë injorante.

Siç e kemi parë, duke besuar se kanë bërë më të mirën për jetën e tyre, të gjithë anëtarët e shoqërive të tilla, i përshtaten këtij rregulli pa ndonjë përjashtim. Sidoqoftë, është humbje e madhe nëse nuk përjetohet miqësia dhe ndershmëria e vërtetë, madje edhe me bashkëshortin ose fëmijët. Njohuria se edhe anëtarët e familjes së ngushtë, i qasen njëri tjetrit me qëllime materiale sigurisht që shkakton dhimbje të brendshme.

Sidoqoftë, rrënjët e sëmura nga mentaliteti i korruptuar i shoqërive injorante nuk janë të kufizuara vetëm në rastet e lartpërmendura. Vetmia që ndjehet në këtë botë zgjat poashtu në përjetësi. Allahu paralajmëron njeriun për një zhgënjim të tillë që më përpara.:

Në të vërtetë ju na erdhët një nga një (të vetmuar), ashtu si ju krijuam së pari; keni lënë prapa shpinës atë që u patëm dhënë, e nuk po shohim se i keni me vete ndërmjetësuesit tuaj, të cilët i mendonit se për ju janë ndihmëtarë (i shoqëronit All-llahut). S'ka dyshim, është këputur lidhja mes jush, dhe mbaroi ajo çka mendonit (ndërmjetësues apo zotëra tjerë) (Surja En'am: 94)

Kur personi i dorëzohet Allahut, Ai e mbron atë. Personi i tillë bëhet mik i përjetshëm i të gjithë profetërve, engjujve e besimtarëve.

E kush do që i bindet All-llahut dhe të dërguarit, të tillët do të jenë së bashku me ata që All-llahu i shpërbleu: (me) pejgamberët, besnikët e dalluar, dëshmorët dhe me të mirët. Sa shokë të mirë janë ata! (Surja Nisa: 69)

Të jetuarit në kushte të papastra

Të arsyetuarit primitiv, puna për të mbijetuar qëllimin e fundit të jetës, bën që anëtarët e saj të bien në stil jetësor të paorganizuar. Një ndër themelet e këtij mentaliteti është që të ketë më shumë kohë që të nxirret kënaqësi nga jeta. Ky qëllim, duke manifestuar veten në fraza të zakonshme siç është përfitimi sa më shumë nga jeta ose ruajtja e momenteve të caktuara, promovohet energjikisht dhe inkurajohet, si stil i bashkohor i jetesës.

Ka një çështje tjetër që kërkon të përmendet këtu: fakti se individët nuk i kushtojnë rëndësi askujt tjetër pos vetes, duke mos treguar kështu dashuri të vërtetë dhe respekt për askend, në të vëretë paraqet një mënyrë të tillë të të jetuarit. Situata bëhet më e qartë në martesë ku çiftet humbin respektin e ndërsjellë. Menjëherë pas martesës, të dyja palët nuk hezitojnë të sillen në mënyrë në të cilën nuk kanë guxuar të sillen para se të martoheshin. Të kaluarit e pjesës më të madhe të ditës në pishama, me fytyrë të palarë, flokë të pakrehur e aromë të keqe nga goja, ose të jetuarit në shtëpi

ku sipërfaqet e kuzhinës vlojnë nga enët e palara tërë ditën, janë të gjitha rezultat i këtij mentaliteti.

Me të vërtetë, ky mentalitet nuk sjell tjetër përveç vështirësive, çrregullimit e kaosit për jetën e njerëzve injorantë. Me pretekstin e mos humbjes kohë, ata i shmangen shumë gjërave që do të sillnin një grimë estetikë në jetën e tyre. Ata merren vetëm me esencën dhe nuk përpiqen që të bëjnë ambientin e tyre të bukur. Për shembull, gjatë kryerjes së punëve shtëpiake ata nuk i kushtojnë rëndësi detajeve. Atyre u duket e vështirë që të pastrojnë; nëse papastërtia përreth nuk shihet, është një arsye e majftueshme për të mos pastruar. Disa njerëz e përceptojnë hekurosjen, bërjen dush, ndërrimin e çarçafëve të ndotur, peshqirëve ose rregullimin e dhomave të tyre si humbje kohe. Ata nuk i pastrojnë rrobat e tyre derisa nuk shihen njolla ose ndyrësi e dukshme në to. Ata nuk mërzhiten që të rruhen. Veçanërisht në kohë të ftohtë ata nuk duan që të pastrohen. Në të shumtën ata pastrojnë vetëm flokët. Në disa kultura, femrat gjejnë zgjidhje praktike për këtë: ato vizitojnë floktarin njëherë në javë dhe nuk ndiejnë nevojë që të pastrojnë flokët e tyre deri në vizitën tjetër të floktari. Në vend se të bëjnë dush, ata përgjithësisht kamuflojnë çfarëdo kundërmimi të padëshirueshëm me parfum e dezodoransë, që i bën edhe më shqetësues. Njerëzit injorantë i kushtojnë rëndësi pamjes së jashtme të rrobave, megjithëse nuk ndiejnë nevojën për të pastruar rrobat që kundërmojnë erë të rëndë të djersës, ushqimit ose cigareve.

Të kuptuarit primitiv të higjienës është veçanërisht i përhapur te të rinjtë. Rrobat e tyre të parapëlqyera janë të

ngrëna, ose janë xhinse të shqyera të zhytura në papastërti. Në universitete e diskoteka ose edhe nëpër rrugë, është e njohur mirë ulja nëpër trotuare ose shkallë, duke mbajtur veshur xhakëtë të ndotur lëkure, këpucë të përbaltura, dhe çantë të çngjyrosur. Ata përgjithësisht nuk e pastrojnë garderobën e tyre; rrobat e ndyra e të shkatërruara hidhen në garderbë, bashkë me të pastrat. Pastruesja bën pastrimin njëherë në javë; dhe për të mos kaluar kohën duke larë enët ata preferojnë ushqimin e shpejtë.

E inkurajuar nga preteksti i modernizmit, kjo mënyrë të kuptuari e jetesës gëzon një popullaritet të veçantë ndër një shtresë të shoqërisë të quajtur intelektualë. Shumica e këtyre njerëzve, në të shumtën e rasteve e përbërë nga gazetarët, autorët, piktorët, aktorët, poetët e njerëzit e shou biznesit, projekton imazhin e intelektualit me mjekrra të ndyra, flokë të yndyrshme e rroba të çrregullta. Ata besojnë se paraqitja me rroba të pastra e të shtruara është në papërshtatshmëri me karizmën e tyre. Disa kushte të papastra sigurisht që ndikojnë negativisht te këta njerëz injorantë. Qofshin të rinj apo të vjetër, ata zhvillojnë sëmundje të shkaktuara nga paushqyeshmëria dhe kushtet josanitare. Duke thithur tym cigaresh në zyrat e tyre, tregtuar në qendra tregtare, kafiteri etj., lëkura e tyre shndërrohet në të verdhë dhe ata vuajnë nga probleme serioze të mushkërive. Sidoqoftë, këto janë efekte negative që shihen vetëm në trup. Të jetuarit në vende të ndotura e të çrregullta, bashkë me njerëzit e tjerë që nuk brengosen për kushtet sanitare, ka efekt negativ edhe në psikologjinë e tyre. Me kohë, ata bëhen tërësisht të

pandjeshëm ndaj bukurisë dhe estetikës. Në të vërtetë kjo është pasojë e zgjidhjes që ata duan ta bëjnë.

Përkundrazi, Kurani inkurajon njeriun që të jetojë në vendet më të pastra e më të bukura të mundshme. Në Kuran, Allahu jep llogari të detajuar se si duhet të drejtojnë jetën e tyre besimtarët:

Dhe rrobat tua pastroji! (Surja Mudeththir: 4)

All-llahu i do ata që pendohen, dhe ata që ruhen prej punëve të ndyta e të neveritshme. (Surja Bekare: 222)

O ju njerëz, hani nga ajo që është në tokë e që është e lejuar dhe e mirë, e mos shkoni hapave të djallit se ai është armik i hapët i juaji. (Surja Bekare: 168)

Të pyesin ty (Muhammed), çka u është lejuar atyre? Thuaju: “U janë lejuar të gjitha gjërat e mira. (Surja Maide: 4)

Ai do të lejojë për ta çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe. (Surja A'raf: 157)

Dhe kur shtëpinë (Qaben) e bëmë vendkthimi dhe vendsigurie për njerëzit, (u thamë) Vendin ku qëndroi Ibrahim i pranojeni për vendfaljeje! Ibrahimin dhe Ismailin i urdhëruam: ju të dy pastrojeni shtëpinë Time për vizituesit, për ata që qëndrojnë aty dhe për ata që falen aty. (Surja Bekare: 125)

Disa thanë: “Zoti juaj e di më së miri se sa keni

ndejur, prandaj dërgojeni njërin prej jush me këtë argjend (monedhë argjendi) në qytet, e të zgjedhë ushqim më të mirë, e t'ju sjellë atë juve dhe le të ketë shumë kujdes e të mos i japë të kuptojë askujt për ju". (Surja Kehf: 19)

O Jahja, merre librin me shumë kujdes, dhe ashtu, dhe ashtu Ne i dhamë atij urtësi kur ishte fëmijë. (Surja Merjem: 12)

Në emër të modernizmit, njerëzit injorantë, me duar të veta, krijojnë papastërti dhe ambient të paorganizuar. Në anën tjetër duke qenë në pajtueshmëri me parimet e Kuranit, besimtarët gëzojnë bukuritë e kësaj jete para se të arrijnë në jetën e përtejme.

VLERAT MORALE TË INJORANCËS



Në shoqërinë e zhytur në injorancë, ekziston vetëm një lloj i vetëm i karakterit njerëzor. Edhe pse sa u përket detajeve, ata ndryshojnë nga një person te tjetri, tiparet e këtij karakteri janë rrënjësisht të njëjta. Arsyeja kryesore pse njerëzit injorantë e kanë këtë karakter të përbashkët është evidente: mosbesimi i tyre në Allahun e jetën e përtejme.

Është e padobishme që të presim nga dikush, i cili nuk i frikësohet Allahut, që të sillet me ndershmëri e përgjegjësi. Kjo ndodh sepse këta njerëz mendojnë se Allahu nuk është në dijeni se çfarë ka në mendjet e tyre ose se çka bëjnë ata fshehurazi.

Në këtë pjesë, ne do të shqyrtojmë mëtutje, vlerat morale të dënueshme të cilat indoktrinohen nga arsyeshmëria primitive e injorancës. Megjithatë, para se të hyjmë në detaje duhet sqaruar një çështje: karakteristikat që do të përmenden

më poshtë ekzistojnë në shpirtin e çdo njeriu. Në Kuran, Allahu e informon njeriun se këto tipare janë inspiruar në shpirt për shkak të gjykimit themelor të njeriut në tokë:

Pasha njeriun dhe Atë që e krijoi atë! Dhe ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij. Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten. E ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten. Surja Shems: 7-10

Vetëm njerëzit e pajisur me mirëkuptim të besimit nuk lejojnë që urdhërat negative të shpirtit t'i udhëheqin ata drejt devijimit të rrugës. Ata demonstrojnë një përkushtim të fortë për pastrimin e shpirtit të tyre:

Natyrisht, njerëzit injorantë, të cilët kurrë nuk mendojnë për Ditën e Gjykimit, nuk gjejnë asnjë arsye për të dënuar vlerat morale të dënueshme dhe që t'i zëvendësojnë ato me vlera që janë të drejta në praninë e Allahut.

Ka edhe një çështje tjetër që kërkon të përmendet: ndër njerëzit injorantë, mund të ketë të tillë që, për arsye të caktuara, heqin dorë nga kualitetet e dënueshme të lartpërmendura. Mund të jetë që këta njerëz, për dobi personale ose shkaqe të tjera, i shmangen sjelljes sipas urdhërave të injorancës. Sidoqoftë, duhet të kuptohet se këta njerëz sillen me përgjegjësi, por jo nga fakti se ia kanë frikën Allahut. Me fjalë tjera, nuk është frika nga Zoti që i bën ata të mos ndjekin rrugën e injorantëve. Kjo është një çështje me rëndësi, sepse kur të kenë ndërruar kushtet të cilat nuk shkonin krahas interesit të tij, personi që nuk ka frikë nga Allahu mund të ndryshojë befasisht. Kështu, një person zemërgjerë e i butë, mund të bëhet befasisht i keq e i ashpër.

Duke mos ndjerë frikë nga Allahu, ai është i prirur për të liga dhe i zoti për të kryer vepra të këqija në çdo kohë.

Shkurt, pra jo të gjithë individët në shoqëritë injorante paraqesin qëndrimet e përshkruara në faqet në vijim. Sidoqoftë, nuk ka arsye për të besuar se ata nuk do të ndryshojnë kurrë mendjet e tyre dhe befaz të fillojnë e të sillen me injorancë. Fakti se dikush nuk ka frikë nga Allahu e bën atë të hapur ndaj fiksimeve të injorancës. Përkundrazi, zbatimi i parimeve kuranore, që bazohen vendoshmërisht në frikën nga Allahu, nuk lejon kurrë indoktrinim të çfarëdo lloji dhe e bën njeriun të përkushtuar drejt Vullnetit të Tij.

Në këtë pjesë, do të shpjegohen disa aspekte të dënueshme të injorancës:

Përtacia

Njerëzit e konsiderojnë përtacinë si diçka me konotacione të kufizuara. Në të shumtën ata kurrë nuk e pranojnë idenë se edhe ata mund të jenë përtacë. Përtacia u mvishet vetëm atyre njerëzve që janë më pak të ndjeshëm që të marrin përsipër çfarëdo përgjegjësie në krahasim me individët e tjerë në shoqëri. Nëse e lëmë këtë anash, ajo që nënkuptohet me përtaci është një çrregullim i sjelljes, që në shoqëri ka pasoja serioze negative, si në aspektin shpirtëror ashtu edhe në atë material. Ka gjasa që njerëzit injorantë ta kenë pikërisht këtë çrregullim.

Ekziston një dëm i madh që ia bën përtacia njeriut: vënja në një gjendje të plogësht mendore. Sidoqoftë, ajo që e mbush

njeriun me virtytin e të qenit qenje njerëzore është aftësia e tij për të menduar. Nëse njeriu nuk e vë kurrë në punë këtë aftësi, ai bëhet një qenje mekanike, plotësisht i pa mençuri e mendjehollësi. I reduktuar në këtë shkallë, individi mbështetet në një stil jete statike, të kufizuar nga rregulla e parime të dhëna. Bërja ndryshe e diçkaje, me qëllim të përmirësimit të jetës, bëhet pothuajse e pamundur për personin e tillë. Në vend të të qenit skrupulozë dhe të përkushtuar për përmirësimin e kushteve ekzistuese, atyre ju duket sikur është më lehtë të pajtohen me status quo-n, pa gjykuar ose pyetur.

Ndkimi i përtacisë mbi ndërgjegjen dhe vullnetin shihet në të gjitha dimensionet e jetës. Ata që mendojnë pengesa kurrë nuk synojnë përgjigje në pyetjet më thelbësore siç janë: pse jetojmë në këtë botë? Edhe pse e njohin rëndësinë e këtyre çështjeve, ata preferojnë të tjerët që të mendojnë thellë në dobi të tyre. Kjo gjendje mendore në një pikë të caktuar mund edhe të rrezikojë mirëqenjen shpirtërore e materiale të njeriut.

Për shembull, ai dështon që të ndërmarrë masa për të mbajtur shëndetin e plotë. Ose fjala vjen ai e shtyen vizitën te mjeku kur vuan nga sëmundje serioze. Për më tepër, ai bën çdo përpjekje që t'i shmanget nënshtrimit të tretmanit të këshilluar nga mjeku.

Përtacia e largon atë nga të gëzuarit e jetës, ose nga të kaluarit e kohës së mirë. Në vend se të kënaqet vetë, ai i shikon të tjerët se si kënaqen, sepse nuk bën asnjë orvatje në drejtim të vetvetes.

Duke pasur mundësi të përgatisë një vend të rehatshëm për veten, ai preferon të jetojë në një vend të parehatshëm, vetëm e vetëm sepse e konsideron si të vështirë që të mendojë për këtë.

Në vend se të gatuajnë ushqim të shëndetshëm, njerëzit injorantë preferojnë ushqimin e shpejtë, sepse ai sigurohet më lehtë. Atyre u duket e vështirë të lexojnë dhe të zgjerojnë horizontet e tyre, dhe kështu gjithmonë e kufizojnë veten duke menduar në mënyrë të ngushtë. Në vend se të koncentrohen në mënyra të ndershme të fitimit të parave, ata duan që të fitojnë shuma të mëdha parashë, prandaj provojnë mënyra ilegale e të pa mundimshme. Kur ballafaqohen me vështirësi serioze, ata preferojnë vetvrasje që është mënyra më e lehtë për të shpëtuar nga situata. Në këtë temë mund të jipen shembuj pakufi; sidoqoftë ideja kryesore e njerëzve injorantë është që të mbijetojnë duke bërë orvatjet minimale.

Mënyra më e mirë për ta bërë këtë është që të lejohet përjetësimi i status quo-s. Kjo është arsyeja pse në shoqëritë injorante produktiviteti e kreativiteti vazhdimisht bien. Si në nivel personal, një prapakthim i tillë zë vend edhe në nivelin shoqëror. Nuk ndodh që diçka të popullarizohet në një vend e të mos jetë në modë edhe në vendin tjetër. Këngët, filmat, e metodat komerciale të propagandës kopjohen menjëherë. Arsyeja kryesore që qëndron prapa kësaj është sigurisht përtacia dhe mungesa e përkushtimit ndaj risive.

Siç e pamë, përtacia është një ndër çrregullimet serioze të sjelljes nga e cila vuajnë njerëzit injorantë. Sidoqoftë, është interesante se kjo sjellje nuk dënohet kurrë në shoqëri;

përkundrazi pranohet si tipar normal. Njerëzit që janë të përfshirë në këtë sistem as nuk janë të vetëdijshëm madje për dëmin që sjell ai në jetën e tyre dhe për bukuritë që i humbasin. Sëkëndejmi, ata nuk gjejnë arsye që të ndryshojnë situatën.

Zbatimi i parimeve kuranore i largon të gjitha këto tipare të cilat janë karakteristike për injorantë, çka e bën njeriun që të ndër marrë veprime në besimin e vet ndaj Allahut e jetës së Përtejme; kjo e bën atë që të bëj orvatje serioze që të angazhohet në vepra të mira. Personi i tillë nuk ka kohë që të humbasë në këtë botë. Çdo moment që kalon sjell një mundësi për vepra të mira. Ai ka qëllime të larta që duhen arritur. Sëkëndejmi, në vend se të jetë përtacë, ai provon të jetë produktiv dhe të demonstrojë përkushtim të papërkulshëm ndaj punës. Allahu shpall në Kuran se ky është lloji i njeriut që ai e vlerëson:

Shpejtoni në atë që fitoni falje prej Zotit tuaj dhe Xhennetit që gjerëia e tij është si gjerësia e qiellit e e tokës, i përgatitur për ata që i besuan All-llahut dhe të dërguarve të Tij. Ajo është dhunti e All-llahut që ia jep kujt të dojë, e All-llahu është dhurues i madh. (Surja Hadid: 21)

E kush e ka për qëllim botën tjetër, duke qenë ai besimtarë, përpiqet për të ashtu si i tako asaj, angazhimi i tyre do të jetë i pranishëm (të Zoti). (Surja Isra: 19)

Xhelozia

Një ndër ve[oritë themelore të shoqërive injorante është xhelozia. Duke mos pasur besim në jetën e përtejme, njeriu e përzgjedh këtë botë plot ambicje. Ai dëshiron të ketë përparësi ndaj të gjitha mundësive që ofron kjo botë dhe të kënaqë pasionet e paskajshme që i ka. Me aq intensitet ndjehet ambicja sa që ai gjithmonë dëshiron që të jetë më i miri në çdo aspekt të jetës. Qëllimi i tillë bën që njeriu në mënyrë të pashmangshme t'i përceptoj të gjithë ata që e rrethojnë si rivalë potencialë.

Ky pikëvështrim, që është baza kryesore e xhelozisë, i jep formë pothuajse tërë jetës së personit duke filluar që nga lindja e tij. Ai i mëson përmendësh rregullat e konkurrencës dhe, pa ndonjë vështirësi, i shndërron ato në praktikë. Në një moment të caktuar të jetës, ky pasion arrin ekstreme të tilla sa që ai nuk mund të pranojë që qenjet e tjera të jenë superiore ndaj tij ose thjeshtë nuk mund të përballojë që të tjerët të jenë të suksesshëm..

Me një botëkuptim të tillë, njerëzit injorantë orvaten që t'ia përkushtojnë tërë energjinë e tyre epërsisë në jetën e tyre profesionale ose në çfarëdo aspekti të jetës sociale. Ata duhet të martohen me gruan më të bukur ose burrin më të pashëm. Atyre gjithmonë duhet t'u takojnë shtëpitë më madhështore, mobiljet më luksoze, vetura më e mirë, fëmijetë më të suksesshëm, rrobat më kualitative. Duhet të jenë ata të tillët që të udhëtojnë në vendet më të bukura në botë. Ky botëkuptim përfundimisht çon në konkurrencë vitale për njerëzit injorantë. Të shtyrë nga xhelozia, ata nuk duan që të

tjerët të prosperojnë. Kjo me siguri demonstroi një mentalitet me të meta, meqë bukuria, pasuria ose standardet relativisht më të mira të jetesës së të tjerëve nuk janë pengesë për përmirësimin e dikujt.

Arsyeja me të meta e shoqërive injorante nuk është e kufizuar në këta shembuj. Të qenit xheloz është pranuar sikur karakteristikë e të qenit të vlerësuar në publik. Ata që thonë se nuk janë xhelozë besohet se janë jonormalë dhe të jashtëzakonshëm. Sipas asaj që kërkojnë bindjet e injorancës, raportet njerëzore duhet të udhëhiqen nga xhelozia. Nëse, fjala vjen, një person injorant ka dikë që me të vërtetë e do, ai kujton se nuk duhet ta lë askënd tjetër që t'i ofrohet, që të ndjejë ndonjë lidhje me të ose të bëhet mik i tij; ai duhet të mbetet miku i tij dhe vetëm i tij. Sidoqoftë, një individ mund të duhet nga më shumë se një person. Dashuria e njërit nuk e afekton aspak dashurinë e tjetrit. Përkundrazi, nëse ai individ i caktuar ka një personalitet të mrekullueshëm, është e natyrshme që shumë njerëz do të kenë dëshirë që ta duan.

Duke mos ndjerë kurrë kënaqësi me atë që kanë, ata që vuajnë nga xhelozia nuk mund të arrijnë kurrë lumturinë e vërtetë. Ekzistenca e gjërave më të bukura rreth tyre i bën ata që gjithmonë të jenë nervozë dhe depresivë. Ky është shpjegim i arsyeshem i dëmit që mund të shkaktohet nga xhelozia.

Në vend se të zbatohet një sistem i tillë i vështirë e i mundimshëm, është më e përshtatshme që të pajtohemi me atë që është shpallur nga Allahu dhe të spastrojmë mendjen nga xhelozia, zilia e lakmia dhe t'i shmangemi joshjes. Shpirti i

njeriut është i prirur nga xhelozia, por është e mundshme, dhe në fakt, e lehtë që përmes urtisë e ndërgjegjes të lirojmë veten nga kjo ndjenjë. Ky fakt shpjegohet në Kuran si vijon:

Koprracia është e pranishme ndër njerëz. Por, nëse silleni mirë dhe ruheni, s'ka dyshim se Allahu hollësisht është i njohur me gjithçka veproni. (Surja Nisa: 128)

Allahu I urdhëron njerëzit që të pastrojnë shpirtin e tyre nga xhelozia dhe ta zëvendësojnë atë me një qëndrim krejt tjetër, duke I dhënë përparësi dëshirave e nevojave të njerëzve të tjerë më shumë se sa shpirtit të vet.

Ky me të vërtetë është një qëndrim vet-sakrifice. Në një numër ajetesh në Kuran, janë treguar veprat e shpirtit të spastruar tërësisht nga xhelozia:

Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër. (Surja Insan: 8)

Ata që përkundër dashurisë për të, u japin pasurinë e vet të afërmve e jetimëve, të varfërve dhe udhëtarëve, lypësve dhe për lirimin e skllëvërve. (Surja Bekare: 177)

Muslimanët ia japin të tjerëve të gjitha, madje edhe gjërat të cilave u kushtojnë shumë rëndësi dhe duke bërë kështu ata kurrë nuk devijojnë nga asnjë lloj ambicje ose xhelozie. Ndjekja e parimeve të Kuranit sigurisht që do të largojë tërë hidhërimin nga zemra dhe do të ndihmoj që të arrihet kënaqësia e mirë e Allahut.

Arroganca

Për shkak të të mirave që u janë dhënë nga Allahu, njerëzit injorantë janë shpesh të pushtuar nga mania e madhështisë. Ata që janë helmuar nga kjo e ligë e quajtur arrogancë e shohin shumë shpejt veten si njeriun më të mençur e më të talentuar në tokë.

Për më tepër, paraja, statusi ose bukuria nuk janë thelbësore që dikush të jetë arrogant; kur një person e sheh inteligjencën e vet si superiore ndaj të tjerëve ai mund të zihet lehtë në injorancën e vet-besimit. Një person arrogant beson se të gjithë njerëzit rreth tij janë të paaftë, përderisa ai, vetë, është shumë i talentuar e sëkëndejmë edhe madhështor.

Me kohë, këto bindje u bënë filozofi bazë e të gjitha sjelljeve. Me këtë mënyrë të të menduarit, njerëzit arrogantë mospërfillin gjithë këshillat ose kritikën që mund t'u ndihmojnë për të menduar më qartë. Ata shpesh poshtërojnë njerëzit e tjerë duke shprehur shpesh antipatinë për ta ose idetë e tyre. Për më tepër, ata bartin bindjen se sa herë vihen në dukje gabimet e të tjerëve, del në shesh përsosmëria e tyre.

Një keqkuptim i tillë në të vërtetë është i dëmshëm për njeriun. Arroganca e errëson mendjen në atë masë sa që njeriu kurrë nuk arrin ta kuptojë shkallën në të cilën ka arritur. Derisa, si pasojë e mungesës së të kuptuarit të duhur, secili që e rrethon ndjen mëshirë për të, ai beson për veten se është një person i mrekullueshëm. Ai mëtutje beson se është person që gëzon respektin e të tjerëve. Sidoqoftë, në kundërshtim me atë që beson, një qëndrim i tillë me synim të dukshëm për të qenë superior e bën njeriun inferior në sytë

e të tjerëve; njerëzit e këtij lloji janë thjeshtë antipatikë, të pa respektuar dhe përfundimisht lihen vetë në shoqëri.

Një person arrogant kurrë nuk mund të bëj në shok të afërt; duke mos pasur zemërgjerësi e modesti, ai nuk shfaq respekt për të tjerët. Sjellja e tillë pashmangshëm shkakton ankth ndërmjet njerëzve që e rrethojnë.

Jo vetëm për njerëzit rreth tij, por edhe për vetë personin, arroganca me siguri është burim kryesor për telashe. Së pari, personi që pohon se është superior ndaj të tjerëve duhet gjithmonë të jetë i matur; ai nuk duhet të gabojë kurrë. Përndryshe, ai mund ta humbasë të ashtuquajturin respekt që e ka fituar në sytë e njerëzve. Një qëndrim i tillë me siguri që kërkon orvatje të dhimbshme. Ai nuk mund të shprehet lirshëm ose të trajtojë njerëzit ashtu siç ka dëshirë; ai duhet të ketë parasysh të gjitha pasojat e çdo sjelljeje që mund të nxijë imazhin e tij. Nëse ndonjë lloj sjellje e veçantë i përshtatet imazhit të tij, ose ka një efekt përmirësues në të, ai vendos ta plotësojë. Nëse jo, ai thjeshtë mbetet i heshtur. Ai nuk mund të qeshet, kënaqet e as të marrë pjesë në ndonjë bisedë intime ashtu siç do të dëshironte. Kjo vëmendje e përpiktë ndaj detajeve të këtilla përfundimisht e shpalos veten në trup e fytyrë, në formë të gulçit. Një shfaqje e tillë i jep fytyrës paraqitje të shëmtuar e të padomethënje. Për më tepër, përkundër faktit se shpirti i njeriut është krijuar si qenje sociale me kënaqësi natyrore të shoqërimin, një person arrogant mbetet i largët dhe i ftohtë ndaj njerëzve, dhe sëkëndejmë nuk përjeton kurrë një raport të afërt me njerëz.

Sjellja e tillë, sidoqoftë, është e padomethënje dhe e

dëmshme për shpirtin e njeriut. Njeriu është vetëm shërbëtor i Allahut, qenësisht i dobët dhe i varur nga Krijuesi për të gjitha nevojat e tij. Ai nuk ka kontroll mbi formën e trupit të tij ose mbi talentet që zotëron. Të gjitha këto formësohen nën kontrollin e Allahut.

Arroganca krijon një person jo të shëndoshë mentalisht, të paaftë madje edhe për të kuptuar nga madhështia e Allahut. Personi i tillë nuk mund të mendojë se edhe ai vetë është thjeshtë një ndër miliarda qenje që jetojnë në këtë planet. Kapaciteti i të menduarit i një njeriu arrogant bëhet aq i kufizuar saqë ai nuk arrin të kuptojë se ai nuk mund kurrë të krijojë diçka të ngjashme me krijimin e Allahut. Ai as nuk mund të mendojë se sa i lëndueshëm është ndaj sëmundjeve që shkaktohen nga viruse e mikrobe, të gjitha të padukshme për syrin e lirë. Duke pasur parasysh këto fakte, për njeriun e urtë, shmangja nga të qenit rob i Allahut është e pakuptueshme.

Dëmi që i shkaktohet shpirtit të njeriut nga arroganca është i dukshëm. Sidoqoftë, shkatërrimi që sjell ai nuk kufizohet vetëm në këtë botë. Allahu shpall se, në botën e përtejme, ata që janë sjellur me arrogancë do të përballen me dënim të hidhur.

Andaj, hyni në dyert e xhehennemit, aty do të jeni përjetë: sa vend i keq është ai i kryelartëve!”
(Surja Nahl: 29)

Dhe kur i thuet atij: “Kij frikë All-llahun!”, atë e kap eufori për punë mëkati. Shtrat i shëmtuar është ai që i takon atij (Xhehennemi). (Surja Bekare: 206)

Të qenit hakmarrës

Për njeriun, mendja e të cilit nuk kupton plotësisht botën e përtejme nuk ka ndonjë arsye që të falë dhe të jetë tolerant. Arsyeja që i udhëheqë thjeshtë i sygjeron se kjo jetë është e shkurtër dhe e përkohshme, prandaj secili duhet të marrë sa më shumë nga ajo. Nën kushte të tilla, interesi personal duhet të ruhet vendosmërisht kurse atyre që janë pengesë për përparimin e këtyre interesave duhet t'u jepet një mësim i mirë. Më tutje, kjo arsyeshmëri urdhëron se personi nuk duhet të harrojë kurrë asnjë sjellje të keqe. I udhëhequr nga ndjenja e hidhërimit, ai duhet gjithmonë të preokupojë mendjen me kujtimin për sjelljen e e padrejtë ndaj tij dhe të bëjë plane që të hakmerret sa më shpejt që të jetë e mundur.

Kujdesi për hidhërimin, te personi i tillë, sa nuk bëhet shprehur; nganjëherë një gabim i vogël nuk harrohet me dekada. Kryesisht, sjellja e keqe është e vogël; aq e vogël sa që nuk mund të kujtohet nga fajtori. Megjithatë” I supozuari” beson se fitili ndezës qëndron prapa atij gabimi. Në shoqëritë injorante, pasioni për hakmarrje shpesh rezulton në incidente të padëshiruara siç janë lëndimet ose vrasjet.

Sidoqoftë, një qëndrim i tillë i shkakton më shumë dëm vetë personit. Ai ndjehet i shqetësuar dhe beson se njerëzit rreth tij ndajnë armiqësi ndaj tij. Ai e vlerëson çdo incident në dritë të këtij mosbesimi të pabazë. Duke i përkushtuar tërë energjinë dhe aftësitë e veta ndjekjes së inspirimeve negative të shpirtit të tij, personi i tillë përfundimisht bëhet i pa kreativitet dhe produktivitet. Për më tepër, ai është lënë në mëshirë të urrejtjes e hidhërimit, dhe tërësisht e humb gëzimin në jetën e tij.

Megjithatë, hareja që i jep njeriut falja dhe toleranca është pakrahasueshëm më e madhe se çdo kënaqësi nga të qenit i xhindosur, pasoja e urrejtjes dhe dëshira për hakmarrje. Në kundërshtim me atë se si shihet kjo në shoqëritë injorante, falja është virtyt dhe është sjellje që ia vlen të lavdërohet. Në Kuran, falja lavdërohet kështu:

Thuaj: “All-llahu më urdhëroi mua drejtësinë dhe në tërësi kthejuni Atij në çdo namaz (lutje) dhe adhurojeni Atë duke qenë të sinqertë në lutje vetëm për të. Ashtu sikur që ju filloi (krijoi) së pari do të ktheheni te Ai. (Surja Araf: 199)

Ndëshkimi i të keqes, bëhet me një të keqe në të njejtën masë, e kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është tek All-llahu. Vërtet, Ai nuk i do zullumqarët. (Surja Shura: 40)

Për dallim nga kjo jetë e zyrtë e injorancës, parimet e Kuranit ofrojnë një ambient më të ngrohtë. Kjo poashtu është treguar si një karakteristikë e parajsës. Kështu na përkujtohet se falja është sjellje e vityeve të larta:

Nga zemrat e tyre kemi hequr (kemi zhdukur) çdo gjë që ishte krijuar nga zilia (nga urrejtja), janë në Xhennet, ku rrjedhin lumenj, e ata thonë: “falënderojmë All-llahun që na udhëzoi për këtë (për iman, për punë të mira, na hoq zilinë, na futi në Xhennet), pse sikur të mos na drejtonte All-llahu, ne nuk do të dinim të udhëzohemi. Vërtetë, të dërguarit e Zotit na e thanë të vërtetën dhe ne i besuam!” E atyre u drejtohet thirrje: “Ky është

Xhenneti, iu dha juve për atë që vepruat. (Surja Araf: 43)

Të qenit i inatosur dhe i mërzitur

Ata që zbatojnë “parimet morale” të cilat i kanë rrënjët në injorancë e kanë një tipar të përbashkët: të qenit i mërzitur dhe depresiv. Njerëzit e tillë vazhdimisht shprehin ankesa. Për më tepër, atyre që nuk u mungon asgjë orvaten të gjejnë diçka në mënyrë që të mund të ankohen. Në shoqëritë injorante, kjo është shndërruar në shprehi absolute, sikur të ngrënit e të pirët. Përveç kësaj, meqë kjo është shprehi e shumë njerëzve kjo është pranuar me gatishmëri nga shoqëria.

Që nga momenti kur dikush zgjohet në mëngjes, çdo gjë mund të bëhet shkak për ankesë. Mungesa e gjumit të mirë, moti i nxehtë ose zhurma e fqinjëve mund të jenë shkak për ankesën e asaj dite. Njerëzit injorantë pamëshirshëm ankohen për trafik të dendur, jetë të zyrtë në qytetet e mëdha, natyrë të sëmurë të njerëzve përreth, të lodhuri, jetë monotone, fqinj të këqinj, moskuptim nga njerëzit e tjerë dhe shumë gjëra të tjera që mund të imagjinohen. Nëse nuk ka arsye për ankesa, ankuesit me shprehi gjejnë pseudo arsye për t’u ankuar; nëse është fjala për grua- ankohet pse është grua. Nëse është e zeshkët, shfaq pakënaqësinë që s’është bjonde ose sykaltër.

Nuk ka ndonjë fund për këto ankesa...për këtë gjendje mendore kurse njerëzit shfaqin ngurrim që ta ndryshojnë këtë.

Në këtë gjendje mendore, njerëzit injorantë nuk ndjehen të lumtur me asgjë. Duke mos qenë kurrë pozitivë për jetën

dhe duke mos parë kurrë anën e mirë të gjërave, ata kurrë nuk ndjehen të kënaqur, edhe kur i kanë të gjitha të mirat.

Edhe pse të pajisur me të mira të pakufishme, njeriu ndjehet i pakënaqur dhe tregon mosmirënjohje. Në Kuran kjo përmendet me fjalët në vijim:

Nga zemrat e tyre kemi hequr (kemi zhdukur) çdo gjë që ishte krijuar nga zilia (nga urrejtja), janë në Xhennet, ku rrjedhin lumenj, e ata thonë: “falënderojmë All-llahun që na udhëzoi për këtë (për iman, për punë të mira, na hoq zilinë, na futi në Xhennet), pse sikur të mos na drejtonte All-llahu, ne nuk do të dinim të udhëzohemi. Vërtetë, të dërguarit e Zotit na e thanë të vërtetën dhe ne i besuam!” E atyre u drejtohet thirrje: “Ky është Xhenneti, iu dha juve për atë që vepruat. (Surja Ibrahim: 34)

Kjo mënyrë e të arsyetuarit primitiv që buron nga injoranca dobëson ndjenjat e njerëzve dhe u shkakton atyre që të mbesin apatikë ndaj të mirave që i rrethojnë.

Parimet morale të Islamit, sistem ky i cili plotëson më së miri nevojat shpirtërore e fizike të njeriut, ka efekt të kundërt. Duke përceptuar çdo detaj të krijimit që e rrethon si dhuratë nga Allahu, besimtari pandërprerë i shpreh falënderimin Atij. Ai e vlerëson pozitivisht çdo incident dhe gjen të mira në të. Për më tepër, ai ia përkushton gjithë aftësitë ripërtërirjes. Kështu, ai do të shpërblehet nga Allahu me më shumë të mira. Allahu shpall në Kuran se ata që ankohen dhe shfaqin jofalënderim ndaj Tij do të zhveshen nga gjithë këto të mira.

**Dhe (përkujtoni) kur Zoti juaj njoftoi bindshëm:
“Nëse falënderoni, do t’ua shtojë të mirat, e nëse
përbuzni, s’ka dyshim, dënimi Im është i
vështirë!” (Surja Ibrahim: 7)**

Mungesa e shpresës

Personi që nuk zbaton parimet e religjionit, beson se çdo incident ndodh për shkak të rastësisë. Ai ia mvesh çdo gjë fatit të mirë apo të keq. Gjendja e dëshpëruar mendore është paevitueshëm pasojë e shpirtit të këtillë; pa dyshim, fati nuk është diçka në të cilin duhet mbështetur ose në të cilin duhet investuar shpresa ose ëndërra.

Gjendja e këtillë mendore është në të vërtetë fatkeqësi që godet injorantin. Kjo është pasojë e natyrshme e të moskuptuarit plotësisht të Fuqisë së Allahut dhe mos të kuptuarit se çdo gjë është paracaktuar nga Ai. Besimtari nuk i humb kurrë shpresat dhe mbetet gjithmonë pozitiv për jetën, meqë ai me vendoshmëri beson se nuk ka asnjë incident të vetëm që paraqitet e që nuk është nën kontrollin e Allahut. Ka vetëm një dhe vetëm një Fuqi që ka krijuar gjithçka, të gjallë e jo të gjallë dhe që kontrollon ata në çdo moment; e kjo është Fuqia e Allahut. Personi që është i vetëdijshëm për këtë fakt e kupton se asgjë nuk është e pamundur dhe se me Vullnetin e Allahut çdo gjë mund të ndërrojë për një moment. Prandaj është shumë e natyrshme që personi, që nuk beson te Allahu por te rastësitë nuk mund të tejkalojë dëshpërimin. Në të vërtetë kjo është gjendja mendore, një pasojë e dukshme e këtij pikëvështrimi.

Njerëzit injorantë janë të prirur të shohin ngjarjet e zakonshme si një rulet ogurzi që mund të shkatërroj jetërat e tyre. Prandaj, ata kurrë nuk janë në marrëdhënje të mira me jetën. Ata e braktisin veten plotësisht ndaj bindjeve negative dhe konceptojnë pothuaj të gjitha rrethanat si të pjekura për tragjedi. Ata mërzhiten në një shkallë ekstreme. Që nga fillimi, ata u qasen problemeve me qëndrim të humbësit. Duke bartur gjithmonë bindjen se asgjë nuk do të jetë në rregull, ata besojnë se jetërat e tyre do të jenë plot mjerim. Ata gjithmonë shohin të ardhmen e tyre si të zyrtë. Për shembull, ata supozojnë se nuk do të kenë karrierë të shkëlqyer akademike. Edhe nëse fitojnë diplomën, frika e tyre është se nuk do të kenë karrierë të mirë. Ata gjithashtu janë jo të qetë lidhur me martesat e tyre. Ata kanë dyshim të thellë rreth martesës, fëmijëve, edukimit të fëmijëve të tyre, dhe të gjitha planeve sa i përket së ardhmes. Paqetësia e tyre e padepërtueshme vazhdon kohë të gjatë. Për shembull, ata u jepen mendimeve se si do të vdesin një ditë, se do të harrohen së shpejti dhe se askush nuk do të vizitojë varrin e tyre. Kjo gjendje e dëshpëruar, në Kuran, rrëfëhet kështu:

E kur e begatojmë (me të mira) njeriun, ai prapësohet dhe largohet i mashtruar, e kur e godet e keqja, ai humb shpresën. (Surja Isra: 83)

Njeriu nuk lodhet prej kërkesës për mirë, e kur atë e godit e keqja, ai keqësohet shumë dhe humb shpresën. (Surja Fusilet: 49)

Injorantët njihen gjithashtu edhe si shitës shkatërrimesh. Ata gjithmonë parashikojnë më të keqen dhe kështu i

orientojnë edhe njerëzit e tjerë në dëshpërim. Për shembull, sapo miqtë e tyre të flasin për të hipur në aeroplan, ata fillojnë të flasin për rreziqet e udhëtimit me aeroplan. Ose, në vend se t'i urojnë të tjerëve investim të mirë, ata shprehin shqetësimin e tyre rreth situatës së rënjes së tregut dhe gjasave për mosesukses.

Pa dyshim këta janë vetëm disa nga shembujt. Megjithatë, ajo që vlen të përmendet këtu është se çka paraqet sistemi i injorancës: njerëzit që zbatojnë moralin e injorancës jo vetëm që vuajnë vetë por ata bëhen shkak edhe për parehatinë e të tjerëve. Padyshim ky është rezultat i parashikuar i secilit sistem që i ka rrënjët në injorancë. Ajo që është më me rëndësi është se njerëzit injorantë, me vetëdije të plotë, e miratojnë sistemin që krijon telashe dhe nervozë si në këtë, ashtu edhe në botën tjetër.

Vlerat morale të religjionit i japin njeriut pikëpamje më ngazëllyese, që në asnjë mënyrë nuk krahasohet me arsyeshmërinë injorante, duke ditur se Fuqia e Allahut i bën njerëzit më me shpresë dhe të lumtur, si në këtë ashtu edhe në botën tjetër. Kjo ndodh për shkak të faktit se ata pajtohen me urdhërat e Allahut:

Mos e humbni shpresën nga mëshira e All-llahit, pse vetëm populli jobesimtar e humb shpresën në All-llahun. (Surja Jusuf: 87)

Të qenit indiferent

Fjala indiferencë shpreh qëndrimin e pabringë e jo të ndjeshëm që mbajnë njerëzit ndaj ngjarjeve. Të çorientuar nga

injanca, njerëzit e konceptojnë indiferencën si sjellje që tingëllon shkëlqyeshëm. Tekefundit, ata kanë lindur në shoqëritë e njerëzve injorantë të cilët shprehimisht paraqesin sjelljen e tillë. Sidoqoftë, një botëkuptim objektiv, i spastruar tërësisht nga keqkuptimet e injorancës, e pohon të kundërtën: të qenit i pa brengosur sigurisht që nuk është një pikëvështrim i pafajshëm siç tingëllon; në të vërtetë, indiferenca është një gjendje në të cilën ndërgjegja është e ngrirë.

Personi që dëshiron të ketë ndërgjegje të pastër duhet të jetë gati çdoherë që të marrë përsipër secilën përgjegjësi që nevojitet. Kjo, padyshim, është pengesë për ata që nuk besojnë në jetën e përtejme. Sëkëndejmi, me qëllim që t'i shmangen kryerjes së detyrave ata e shndërrojnë këtë gjendje mendore në filozofi fundamentale të ekzistencës së tyre. Në gjendje të tillë, individi kryesisht nuk merr përsipër përgjegjësitë e tija. Në vend të tij, këtë duhet ta bëjnë njerëzit rreth tij.

Jo më pak se vetë personi indiferent, për shkak të qëndrimit të tillë vuajnë edhe njerëzit që e rrethojnë atë. Për shkak të qëndrimit të tij të pakonsideratë, personi i tillë jep premtime, por nuk i përmbush kurrë ato. Ngjashëm, ai merr para hua, por nuk i kthen kurrë; jo sepse nuk ka para, por thjeshtë sepse harron. Nganjëherë sjelljet e tija të pakonsiderata shkojnë edhe më tutje dhe bëhen kërcënim për shëndetin e tij si dhe për shëndetin e të tjerëve. Ai, fjala vjen, është neglizhent për të marrë një bar vital. Ose, ai lë foshnjë që sapo ka zënë të ecë në plazhë, duke mos e pasur

kurrë parasysh se mund të fundoset. Gjatë jetës, njeriu mund të shohë me mijëra shembuj të ngjashëm.

Për shembull, ajo që do të bëj një njeri i ndërgjegjshëm kur has një person të lënduar keq në një aksident trafiku, është se do ta dërgojë në spital, pavarësisht se sa për ngut mund të jetë për vete. Sidoqoftë, personi që mbetet indiferent i hedh vetëm një shikim skenës së tillë dhe vazhdon ngasjen. Ose, ai thjeshtë mendon se dikush tjetër do të vijë dhe do ta ndihmojë personin e lënduar.

Siç e pamë, “të qenit indiferent” është një mënyrë tjetër për të thënë se mungon ndërgjegjja. Në gjendje të tillë, për shkak të pandjeshmërisë, personi indiferent thjeshtë mospërfill shumë çështje dhe nuk vuan as brejtjen më të vogël të ndërgjegjes. Për më tepër, së brendshmi ai e mendon veten si njeriun më të mençur në tokë. Një qëndrim i tillë shkakton humbje të pazëvendësueshme për jetën e përtejme të njeriut; ai i humbë të gjitha mundësitë që të arrijë kënaqësinë e mirë të Allahut.

Në anën tjetër, besimtari i cili paraqet sjellje të konsiderueshme, e bën më të mirën për jetën e tij të përjetshme. Ndjeshmëria e tij poashtu ia bën atij të mundur që të bëjë një jetë komfore në këtë botë.

Lakmia

Lidhja me këtë jetë dhe dëshira për prona bën që njerëzit injorantë të bëjnë çmos që të realizojnë qëllimet e tyre në këtë botë. Personi që synon të përfitojë sa më shumë nga kjo jetë sigurisht nuk shfaq asnjë hezitim në paraqitjen e qëndrimit

lakmitar. Jeta është e shkurtër, mendon ai, dhe më mirë se sa të angazhohet për vepra të mira për të siguruar jetën e përtejme, ai beson se është mençuri që të përfitohet sa më shumë nga kjo jetë. Me këtë synim në mendje, ai shfrytëzon çdo rast që nxjerr sa më shumë prej çdo gjëje të mundur.

Kjo strukturë, edhe pse shihet qartë në çdo fushë të shoqërisë injorante, thuhet se vlen vetëm për një pjesë të veçantë të saj. Në këtë kontekst, besohet gjerësisht se vetëm disa njerëz janë të prirur për lakmi. Megjithatë faktet tregojnë ndryshe. Duke qenë një ndër karakteristikat mbizotëruese të moralitetit të injorancës, lakmia shpalos pikëvështrimet e njerëzve e të shoqërisë injorante në një mënyrë të shkëlqyer.

Të pasur ose të varfër, njerëzit injorantë, të indoktrinuar me filozofinë e bazuar në dobitë e kësaj bote, udhëhiqen nga lakmia. Për shembull, në tubimet shoqërore, nëpër ndeja, ata hanë e pijnë së tepërmi, madje edhe kur nuk janë të uritur. Në punë, ata bëjnë një varg telefonatash të panevojshme vetëm sepse ato janë pa pagesë. Ose, shëtiten me orë të tëra në komplekse dyqanesh për të tregtuar gjëra që nuk u duhen. Kjo në të vërtetë është një sëmundje që ndikon madje edhe raportet mes anëtarëve të familjes. Një grua, për shembull, kërkon që burri i saj t'i përkushtohet me ambicje punës së tij, në mënyrë që ajo të mund të plotësojë shijet e saja të shtrenjta. Ambicja e lakmia dominojnë shoqërinë në atë masë sa që i shtyen injorantët që të shndërrohen në vjedhës e batakinj.

Ky moralitet, të bërit e njeriut lakmitar për çdo cikërrimë, shihet nga njerëzit injorantë si shenjë mençurie. Megjithatë, qartazi kjo i degradon ata.

Të qenit i sinqertë e i ndershëm është shumë më e lehtë dhe e kënaqshme se sa të shfrytëzuarit e dinakërive të ulëta për të arritur qëllime të caktuara. Personi besimtar merr përfitimet e secilës së mirë në këtë botë në mënyrën më të mirë. Ai e di se çdo e mirë i takon Allahut dhe se, nëse Ai ka Vullnet, ai e shpërblen njeriun vazhdimisht. Kështu, ai as nuk ndjehet ambicioz e as nuk bëhet lakmitar. Një qëndrim i tillë e shpërblen njeriun me fisnikëri e respektueshmëri, dhe me më shumë miratim nga Allahu.

Egoizmi

Në shoqëritë injorante njeriu kujdeset për tjetrin vetëm nëse beson se mund të përfitojë diçka nga ai person. Përndryshe, nuk ka ndonjë arsye përse personi do t'i kushtonte tërë energjinë e tij kujdesit ndaj tjetrit. Sipas rastit, mund të ketë disa shkallë që ai t'i bëjë mirë dikujt; megjithatë injoranca e kërkon që ky të mos bëhet një parim i adoptuar. Nisur nga kjo pikëpamje, njerëzit injorantë bëhen të pakonsideratë dhe egoistë. Një ndjenjë e thellë egoizmi rrënjohet thellë nga prindërit edhe te fëmijët derisa ata janë ende shumë të rinj. Refuzimi që të ndajnë lodrat e dashura, ushqimin ose anëtarët e dashur të familjes me të tjerët janë shenjat fillestare të këtij qëndrimi. Në vitet e mëvonshme të jetës ky qëndrim negativ mbështetet nga sjellje jonjerëzore e të pamenduara.

Një person egoist mendon vetëm për vete. Nevojat dhe problemet e të tjerëve nuk e shqetësojnë kurrë. I ulur pranë një personi të uritur, ai kënaqet në ushqimin e vet, duke mos

menduar kurrë që ta ndajë atë. Kur është i sëmurë, ai kujdeset për veten shumë mirë, megjithatë dështon në kujdesin ndaj dikujt tjetër kur tjetri është i sëmurë. Ai bëhet sikur nuk sheh mikun e tij të qullet në shi në rrugë, sepse po t'i ofrojë bartje kujton se ulëset e veturës së tij do të lagen. Dikë që mund të rrëzohet afër tij, ai vetëm e tejkalon.

Kur rrethanat kërkojnë veprim të nxituar njerëzit injorantë shfaqin gjithashtu sjellje jonjerëzore. Për shembull, ata refuzojnë të dhurojnë gjak për një person të lënduar i cili ka nevojë urgjente për të.

Në religjion, sidoqoftë, egozimi, dhe jonjerëzorja janë zëvendësuar nga mëshira dhe sjellja e pakonsideratë. Sa herë që ka nevojë, besimtari vjen në ndihmë. Në thirrjen për ndihmë ai përgjigjet menjëherë. Besimtari as që i shkakton telashe palës së kundërt. Një shembull i mrekullueshëm për sjellje të tillë, në Kuran është rrëfyer siç vijon:

Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të All-llahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim. Ne i frikësohemi (dënimit) Zotit tonë në një ditë që fytyrat i bën të zymta dhe është shumë vështirë. (Surja Insan 8-10)

Të qenit me karakter të keq

Në shoqëritë injorante, vetëm njerëzit që janë me të vërtetë ngatërrestarë referohen si njerëz të vështirë. Njerëzit që nxisin grindje ose provokojnë konflikte të përditshme

përrjashtohen tërësisht nga ky përshkrim. Sidoqoftë, në situata të veçanta, edhe njerëzit tolerantë dhe të qetë gjithashtu shprehin jo-tolerancë dhe bëhen me temperament të keq. Përfundimisht, ka disa njerëz që ata nuk i dojnë dhe me të cilët nuk mund të bëjnë. Sidoqoftë, arsyeshmëria e injorancës e pranon një qëndrim të tillë si shumë të arsyeshëm dhe normal.

Në jetën familjare, zënkat e pandërprera ndërmjet anëtarëve të familjes poashtu konsiderohen si të zakonshme. Sjelljet e pacipa hudhen poshtë si të pavërteta ose madje mbulohen duke përdorur shprehje se problemet familjare janë të këtilla ose se gjëra të tilla ndodhin në çdo familje. Mentaliteti i njëjtë vlen edhe për raportet mes miqve. Për shembull, ata thonë, se vetëm për faktin që kemi disa mosmarrëveshje kjo nuk do të thotë se nuk jemi miq. Ekzistojnë mospajttime të vazhdueshme mes mësuesve e nxënësve në shkollë, shefave e të punësuarve, punëdhënësit e punëmarrësve në punë. Ngasësit, për shembull, zihen me të tjerët në trafik. Ka ftohje mes fqinjve, të afërmve, shkurt, ndërmjet të gjithë atyre që janë në kontakt social me njëri tjetrin.

Në të shumtën e rasteve këto grindje bazohen në arsye gesharake. Edhe nëse nuk ka asgjë për të polemizuar, ata sajojnë diçka. Për shembull, njeriu e sheh mungesën e ushqimit të tij të preferuar në tavolinë si një shkak të mirë për t'u grindur me gruan e tij. Gruaja, e paafte për ta bindur të shoqin që të shëtitet, gjithashtu mund të grindet. Çdo moment i përditshmërisë është burim telashesh e diksutimesh

për njerëzit injorantë; zhurma që bëjnë fqinjët, fëmija që qan, geni që leh, vetura që zë vendparkingun privat, makina që bën zhurmë, ose zvogëlimi i pagës, shkurt, gjithçka...

Këta njerëz që tendosen edhe për situata të vogla nuk shohin asgjë të gabuar në këtë ose në ambientin e padurueshëm në të cilin jetojnë. Nganjëherë të kaluarit e shumë kohe me personin e caktuar bëhet shkak i mirë për zënka. Ata i mërzojnë njëri tjetrit, madje edhe dëshirat e tyre të pranueshme bëhen shqetësuese. Kjo lidhje me kohë bëhet jo toleruese. Ajo që është më interesante është se ata janë të ndërgjegjshëm për faktin se ndryshimi në rrethana e njerëz nuk do ta ndryshojë situatën. Kudo që shkojnë e çkado që bëjnë, jo toleranca është gjithmonë një faktor.

Në këtë pikë ngritet pyetja: cilat janë shkaqet për këtë jo tolerancë?

Në shoqëritë injorante, të gjithë anëtarët besojnë se kanë të drejtë. Duke mos treguar tolerancë, ata kurrë nuk mendojnë të jenë gjentilë ndaj dikujt që është i vrazhdë. Në vend të kësaj, ata mbesin grindavecë dhe krijojnë më shumë tensione.

Megjithatë, Kurani është mjaft i qartë në këtë pikë dhe ata që e zbatojnë Kuranin shohin se çka është e drejtë dhe e ndjekin atë. Rrjedhimisht, opinionet konfliktuoze të individëve zëvendësohen me atë që është urdhëruar nga Allahu në Kuran. Urdhëresat e Allahut ofrojnë zgjidhje për problemet. Kështu, në vend të kundërshtive e problemeve, janë të disponueshme zgjidhjet. Ai që është i bindur tërësisht në parimet morale të Kuranit i respekton dhe i don njerëzit.

Zbatimi i Kuranit kërkon të maturi e respekt ndaj opinioneve të të tjerëve. Më një qëndrim të tillë, nuk lindin probleme. Derisa njerëzit injorantë e bezdisin vazhdimisht njëri tjetrin për gjëra të vogla, besimtarët jetojnë jetën duke zbatuar Kuranin. Sëkëndejmi, në shoqëritë e besimtarëve nuk ndodh asgjë që shqetëson njerëzit apo që i bën ata nervozë.

Të qenit kundërshtues

Një ndër karakteristikat e personit që i përmbahet parimeve morale të Kuranit është se ai nuk kënaqet me biseda të kota. S'ka dyshim, shmangja nga kjo ofron më shumë kënaqësi, si shpirtërisht ashtu edhe materialisht. Në vend se të hyjë në bisedë që s'ka asnjë kuptim, besimtari e kalon kohën në detyra më fitimprurëse e të rëndësishme. Në këtë mënyrë, ai i shmanget gjithashtu efektit mpirës të bisedave të kota.

Përkundrazi, njerëzit injorantë kanë një shprehje të papërmirësueshme për të mbytur kohën në biseda të gjata e të pamënçura. Arsyeja që fshihet pas kësaj tendencë joracionale është largimi i mendjes nga problemet serioze të jetës së përditshme. Sidoqoftë, qasja këmbëngulëse dhe arrogante që marrin ata në biseda përgjithësisht i kthen bisedat miqësore në polemika të nxehta. Në të shumtën, ata flasin me orë të tëra mbi një temë për të cilën dijnë fare pak dhe përgjithësisht arrijnë në konkluzione boshe. Gjatë këtyre polemikave ata provojnë të imponojnë bindjet e tyre te të tjerët. Nganjëherë ata bëhen aq kokëfortë saqë nuk e ndryshojnë këtë qëndrim edhe kur flasin me ndonjë ekspert.

Në botën e tyre të vogël, ata dijnë më shumë se mjeku dhe janë më të mençur se filozofët.

Komentet që ata bëjnë gjatë bisedave shpesh qëndrojnë në supozime ose thashethëna. Kjo gjithashtu është karakteristikë pse njerëzit në shoqëritë injorante kurrë nuk i përvishen punës. Këtyre njerëzve iu referohet si pakëz kokëfortë ose njerëz me ide të fiksuara. Për më tepër, mendohet se këto janë karakteristika personale, të veçanta, për atë person.

Sidoqoftë, arsyeja fundamentale për njerëzit që hyjnë në polemika të nxehta është fakti se shpirtërat e tyre janë të prirur për grindje. Allahu i adreson këto karakteristika në Kuran:

**... por njeriu është, në të shumtën, kundërshtues
(Surja Kahf: 54)**

Për të mbrojtur botëkuptimet e tyre, njerëzit mund të polemizojnë. Sidoqoftë, ajo që habit lidhur me ta është stili agjitativ, i trazuar, që ata përdorin në polemikat e tyre. Tipari më i spikatur është toni i zërit që ata përdorin. Individët injorantë supozojnë se nëse mbysin zërin e tjetrit përmes ngritjes së zërit të tyre, ata do të dalin fitimtarë. Sëkëndejmi, ata flasin me ton të lartë. Në atmosferën e ngarkuar që krijon një gjë e tillë, përmbajtja poashtu afekton polemizuesit fizikisht. Agjitacioni i tyre bëhet i dukshëm për shkak të skuqjes së tyre ose djersitjes në dell ose qafë. Fytyrat e tyre bëhen të egra nga zemërimi, që u jep pamje të shëmtuar tipareve të tyre. Ata nuk mund të rrijnë të qetë; ata provojnë të kërcënojnë palën tjetër. Ata ndërprejnë njëri tjetrin, ose

flasin në të njëjtën kohë, duke mos i kushtuar rëndësi asnjëri. Nëse njëra palë mbetet e qetë, tjetra e provokon, duke provuar që ta përfshijë në polemikë. Ata ndjehen të lirë nga ky tension dhe gjejnë prehje vetëm kur oponenti i tyre dorëzohet.

Në anën tjetër, besimtarët, nuk provojnë kurrë një gjendje të tillë mendore. Ata e dijnë se gjithmonë ka njerëz me kuptueshmëri superiore dhe nuk insitojnë kurrë që të mbajnë bindjet e tyre kur iu është thënë e vërteta. Nëse nuk kanë njohuri për temën, ata thjeshtë përmbahen nga shprehja e opinioneve. Ngjashëm, ata u ikin bisedave të kota dhe nuk vënë re thashethënat. Me një qëndrim të këtyllë, që nga fillimi besimtarët e vendosin që të mos hyjnë në polemikë. Bisedat e tyre nuk arrijnë kurrë rrugë qorre. Ata gjejnë lehtësim e paqe në ofrimin e zgjidhjeve për problemet apo zgjidhjen e konflikteve. Nëse nuk kanë informata për ndonjë ngjarje, në vend se të thonë mendimet e tyre dhe të përfshihen në polemika, ata preferojnë të marrin informata në mënyrë që të arrijnë në konkluzat e shëndosha. Kjo poashtu është diçka që është këshilluar nga Allahu në Kuran:

**... e mbi secilin të dijshtëm ka edhe më të dijshtëm.
(Surja Jusuf: 76)**

A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?" Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim. (Surja Zumer: 9)

Hipokrizia dhe shtirja

Në shoqëritë injorante, ajo që bezdis më së shumti njerëzit është paraqitja e mënyrës hipokrite dhe jo të sinqertë të sjelljes. Ajo që është me rëndësi, sidoqoftë, është fakti se ata që ankohen për këtë janë gjithashtu hipokritë vetë. Ky sigurisht është manifestim i qartë i mizorisë së sistemit të krijuar nga injorantët.

Hipokrizia shpalos dy karaktere të ndara; një që paraqitet haptas dhe tjetrin që fshihet përbrenda. Ai i botës së jashtme, mishëron aspektet false të karakterit artificial që tregohet para të tjerëve. I brendshmi strehon, mendimet e thella, të vërteta. Çuditërisht, në shoqëritë injorante, secili e di dhe e pranon këtë fakt. Allahu tregon një nga ve[oritë e hipokritëve në Kuran:

... Ata flasin me gjuhët e veta atë që nuk e kanë në zemrat e tyre. (Surja Fet'h: 11)

Sidoqoftë, secili e di kur dhe ku njerëzit shpalosin bindjet e tyre të vërteta. Derisa përgojnë, për shembull, njerëzit shprehin mendimet e tyre të sinqerta për të tjerët. Sidoqoftë, meqë fshehin mendimet e tyre të brendshme lidhur me personin me të cilin flasin në atë moment, as atëherë njerëzit nuk paraqiten plotësisht të sinqertë. Sipas të gjitha gjasave, bindja e tyre personale lidhur me personin me të cilin flasin do të shpaloset më vonë para dikujt tjetër.

Ngjashëm, njerëzit injorantë, shpalosin mendimet e tyre të brendshme kur besojnë se interesat e tyre janë në shënjestër. Për shembull, njerëzit nuk mund të fshehin ndjenjat e tyre të vërteta kur të xhindosur grinden me dikë.

Hipokritët gjithashtu mashtrojnë në mënyrë të vazhdueshme të tjerët dhe kurrë nuk sillen me ndershmëri me qëllim që të fshehin fytyrat e vërteta dhe mendimet e tyre. Arma që e përdorin shpesh për këtë qëllim është shtirja. Në vend se të jenë të sinqertë dhe ashtu siç janë, ata orvaten të japin një imitim të sinqeritetit. Megjithatë, meqë edhe në këtë dështojnë, ata sillen tërësisht në mënyrë jo të natyrshme.

Është e evidente se në ambientet ku njerëzit shtiren, nuk mund të arrihet kurrë dashuria dhe respekti i vërtetë. Njerëzit injorantë janë të ndërgjegjshëm për këtë fakt dhe mjaft të shqetësuar për këtë, megjithatë, për shkak të mënyrës së vrazhdë të të menduarit, ata vazhdojnë të kujdesen për këtë sistem. Me të vërtetë është e vështirë dhe mundimshme për një person që të mundohet të sillet si dikush tjetër kur në të vërtetë beson në sistem e vlera të tjera.

Ndershmëria dhe sjellja si një person i thjeshtë, si së jashtmi edhe së brendshmi, sjell çlirim të madh për individin i cili bëhet i mbështetshëm e i besueshëm, i respektuar e i dashur nga të gjithë. Ndershmëria dhe besueshmëria janë shpërblime të moralit për shpirtin njerëzor në islam. Të sjellurit në pajtim me urdhërat e Allahut sjell paqe e çlirim për mendjen, meqë nuk ka nevojë të sjelljes si dikush që nuk je. Kjo eliminon paragjykimet e injorancës dhe ofron një jetë të lehtë për besimtarin. Në kundërshtim me ambientin e zymtë të ambientit të injorancës, islami i bën të mundshme raportet e ngrohta e të sinqerta dhe sëmëndejmi një jetë me kënaqësi.

Tallja

Më parë se një sjellje negative që duhet eliminuar, në shoqëritë injorante tallja konsiderohet një mënyrë për t'u argëtuar ose për të kaluar kohë të mirë. Sëkëndejmi, kjo është e pranuar shoqërisht dhe kurrë nuk konsiderohet si vepër e keqe. Anëtarët e shoqërisë injorante supozojnë se ata mund të arrijnë superioritet duke degraduar të tjerët.

Njerëzit i tallin të tjerët jo vetëm me fjalë por edhe me metoda të sofistikuara siç janë gjestikulacionet, mimika, gjuha e trupit ose mënyra të tjera të maskuara të komunikimit.

Me të vërtetë mbetet mister se si këto metoda të sofistikuara transferohen nga një gjeneratë te tjetra dhe se si çdo anëtar i shoqërisë injorante është i mirëinformuar për to. Nuk ka as libra e as shkolla për të udhëzuar të rinjtë për këto mënyra të rafinuara të talljes. Megjithatë secili e di se çfarë kuptimi qëndron prapa një mimike ose gjesti. Askush nuk flet haptas për talljen, edhe pse dihet gjerësisht për të dhe përdoret fshehtë.

Në shoqëritë injorante çdo gjë mund të jetë temë e talljes. Nuk ka asnjë kufizim për këtë. Njerëzit e paaftë, një shqiptim i gabuar i fjalës, konstrukti fizik i një individi ose madje edhe të teshtiturit dhe dënësja mund të shndërrohen në tallje. Sipas shoqërive injorante ngecja dhe rrëzimi është diçka me të cilën duhet qeshur me orë të tëra. Personi me të cilin qeshet për një arsye të tillë ndjehet i poshtëruar. Për këtë arsye, edhe nëse dhembja është e madhe, njeriu paraqitet sikur nuk i dhemb aspak. Për më tepër, për të treguar se nuk bezdiset nga tallja, ai qeshet edhe vetë.

Njerëzit gjithmonë ndjehen të shqetësuar për mundësinë se mund të duken qesharakë për shkak të dështimeve ose të pamjes së tyre. Për shembull, dikush që belbëzon nuk ndjehet rehat madje as kur flet me mikun e tij më të afërt. Prandaj, ai në të shumtën e kohës hesht. Në një rreth të tillë, secili duhet të ketë kujdes që të mos përqeshet.

Gjithashtu, tallja nuk është veçori e një pjesë të caktuar të shoqërisë. Ajo është e përhapur në shtresën e lartë të shoqërisë, në geto, në punë, shkollë, shkurt, kudo ku “vlerat morale” të injorancës mbizotërojnë. Ajo nuk ndërron sipas kulturës ose shkallës së civilizimit. Përfundimisht, tallja e bën jetën të mundimshme duke kërkuar nga individit që në çdo moment t’i kushtojë vëmendje asaj dhe të përpiqet t’i shmanget talljes.

Sidoqoftë, njerëzit që i janë përshtatur vlerave morale të Kuranit, nuk ngacmojnë të tjerët. Besimtarët e dijnë se dobësitë janë krijuar nga Allahu veçanërisht për qenjet njerëzore. Ky fakt krijon bazën e komunikimit mes njerëzve. Prandaj, në vend të mospërfilljes ndaj të paaftëve, atyre që vuajnë ose kujtdo që ka dobësi, duhet të tregohet mëshirë. Allahu i kushton vëmendje të kujdesshme këtij fakti në ajetin që vijon:

O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që gratë e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin (duke nënçmuar njëri-tjetrin) dhe mos

etiketoni njëri-tjetrin me llagape. Pas besimit është keq të përhapet llagapi i keq. E ata që nuk pendohen, janë mizorë. (Surja Huxhurat: 11)

Ajo që kërkon të përmendet veçanërisht këtu është se të qenit në disponim për të bërë humor me çdo gjë, largon vëmendjen e njeriut nga religjioni, vdekja ose Dita e Gjykimit. Për skeptikët që supozojnë të njëjtin qëndrim Kurani thotë:

Ata thanë: “A pasi të bëhemi eshtra të kalbur, dhe e pluhur, a mos do të bëhemi krijesë e re e ringjallur?” Thuaj: “Edhe nëse të jeni gurë a hekur!” Ose ndonjë krijesë që ju duket e madhe! Ata do të thonë: “Kush do të na rikthejë neve në jetë?” Thuaj: “Ai që ju krijoi për të parën herë!” E ata do të tundin kokat e tyre nga ti e do të thonë: “Kur është ajo (ringjallja)?” Thuaj: “Ndoshta do të jetë afër!” (Surja Isra: 49-51)

Personi që tall njerëzit, sidoqoftë, duhet të mos harrojë se do të ballafaqohet me një fund të hidhur në përjetësi:

Mandëj përfundimi i atyre që bënë punë të këqia, ishte më i keqi, për shkak se argumentet e Allahut i përgënjeshtroan dhe talleshin me to. (Surja Rum: 10)

Emotionalizmi dhe të qenit romantik

Në shoqëritë injorante, emocionalizmi dhe të qenit romantik njihen si sjellje njerëzore dhe realitet i jetës. Njerëzit që nuk janë emotivë shikohen si të pamëshirshëm

dhe të çuditshëm. Të qenit romantik shoqërohet me imazh të idealizuar, të ngjyrosur me magji e bukuri.

Megjithatë emocionalizmi është gjendje në të cilën njeriu mbetet tërësisht nën ndikimin e emocioneve të tija dhe e rrethon veten tërësisht nga instiktet. Të lënë pa aftësinë e të menduarit, personi i tillë dështon që të bëj gjykim të shëndoshë. Askush, madje as ai vetë, nuk e di se si do të afektojnë vendimet emocionet e tija. Një person emotiv është thjeshtë nën ndikimin e mëshirës së ndjenjave të tija. Nën drejtimin e ngjarjeve, ai dështon që të ketë parasysh fazat e fundit ose pasojat e dëmshme të vendimit dhe bëhet i vetëdijshëm për gabimet e tija vetëm kur çdo gjë të ketë mbaruar e përfunduar. Ai ndërmerr veprime të befashme e të pamenduara. Disponimi i tij gjithashtu ndryshon befas; në një moment ai ndjehet i kredhur në errësi ose në dëshpërim, ndërsa në momentin tjetër ngërthehet nga xhelozia. Ai lehtë ndjehet i ofenduar dhe bëhet i xhindosur. Jeta e tij është sikur një tren i shpejtë që shkon vërdallë.

Në të vërtetë ky është një qëndrim i ankthshëm i atyre që synojnë kënaqësi emocionale në raportet e tyre. Duke mos e ditur se çfarë lloj humori përjetojnë njerëzit e tjerë, ata gjithmonë presin një kohë më të mirë që të komunikojnë. Në këtë mënyrë, jeta e tyre kalohet në përmbushjen e të priturve emocionale të të tjerëve. Ndërkohë, ata presin të njëjtën gjë nga të tjerët. Edhe pse nuk e pëlqejnë bezdinë që ajo jep, për çudi, njerëzit injorantë gëzojnë mjerimin dhe humorin e trishtuar që sjell emocionalizmi. Për më tepër, ata e gjejnë jetën pa emocionalizëm si shumë monotone dhe të

trishtuar. Në të vërtetë kjo është pretekst për të mbuluar sjelljen e tyre të sëmurë dhe që ta bëjnë këtë sjellje të pranueshme shoqërisht.

Në mënyrë të pashmangshme gjendja emocionale krijon persona mentalisht jostabilë. Duke qenë në mënyrë të vazhdueshme nën ndikimin e melankolisë, atyre asgjë nuk u jep kënaqësi. Në një rreth ku secili ka diçka me të cilën kënaqet, ata gjejnë pashmanshëm diçka për t'u mërziur. Nganjëherë ata orvaten të intensifikojnë hidhërimin e tyre përmes skenareve imagjinare që krijojnë në mendjet e tyre. Për këtë arsye, edhe pse përpiqen të duken mirë, thellë në vete, ata ndjejnë një nervozizëm të pashuar. Në vend se të jetojnë në paqe, ata jetojnë në mërzi e ankth.

Në botën romantike, njerëzit mbesin nën ndikimin e ngjarjeve për një kohë të gjatë. Për shembull, ata nuk mund të ikin lehtë nga ndikimi i incidenteve të këqija që ata ndeshin, dhe nuk janë të fortë emocionalisht për të eliminuar efektet e tyre negative. Në vend të kësaj, ata l gjejnë incidentet e tilla si një shkak të mirë për të qenë emotivë.

Urtësia është baza e vetme në të cilën duhet gjetur kënaqësinë nga jeta, për të pasur sukses dhe drejtuar një jetë në paqe. Kjo e kuptuar arrihet vetëm duke qenë në pajtim me urdhërat e Allahut. Zbatimi i Kuranit eliminon emocionalizmin dhe ofron një perspektivë pozitive duke i mundësuar njeriut që të zgjidhe problemet e jo që t'i ekzagjerojë ato e t'i shndërrojë në buril të telasheve.

Qarja

Një ndër shqetësimet që sjell emocionalizmi është edhe nevoja për të derdhur lotë. Kjo nevojë, sidoqoftë, e ka bazën në themele jo të arsyeshme. Thjeshtë nuk ka arsye për të. Njerëzit injorantë, veçanërisht femrat, thjeshtë besojnë se të qarët është një nevojë fundamentale ashtu sikurse edhe të ngrënët, të pirët ose gjumi. I njëjti paragjykim thotë se nëse personi nuk e bën këtë, ai mund të zhvillojë sëmundje të ndryshme që vijnë nga hidhërimi e mërzia. Kështu, njerëzit injorantë mbështeten në të qarët si një ofrues çlirimi.

Për këtë, kjo pikëpamje negative dhe e dëshpërueshme e njerëzve injorantë është faktor që i shtyen ata të qajnë. Me këtë pikëpamje, ata gjithmonë gjejnë arsye për ta bërë këtë. Në vend se të eliminojnë problemin, shkaktar që mund t'i hedhë në hidhërim, ata preferojnë të qajnë. Ata kanë një interes të fortë që ta lëshojnë veten dhe duan që të kenë këtë përvojë sa herë që gjejnë një arsye të “përshtatshme”.

Për shkak të kushtëzimit të tyre intensiv nga shoqëria, ky besim mbahet nga të gjitha pjesët e shoqërisë injorante, veçanërisht nga femrat. Në shumë kultura, imazhi i burrit shoqërohet me jo të qarë. Në anën tjetër, gratë inkurajohen që të qajnë. Është një bindje injorante sipas së cilës meqë gratë janë fizikisht më të dobëta se burrat, ato duhet të jenë më të dobëta edhe shpirtërisht. Prandaj, njerëzit injorantë presin që gruaja të jetë e ndikuar fuqishëm nga ngjarjet dhe të mbetet e tillë për një kohë të gjatë. Gratë e adoptojnë me gatishmëri këtë model dhe nuk tregojnë asnjë kundërshtim ndaj këtij kalkulimi të gabuar nga shoqëria.

Në shoqëritë injorante të qarët nuk është përceptuar kurrë si shenjë e pamundshmërisë ose e personalitetit të dobët. Askush nuk e fajëson njeriun për ndonjë rënje. Përkundrazi, në jetën e përditshme njerëzit inkurajohen që të shfaqin ndjenja në këtë mënyrë, përmes TV serialeve, filmave e magazinave. Njerëzit ndjejnë një simpati për njerëzit që përjetojnë skena dramatike të cilat tregojnë lumturi, dashuri dhe dhimbje duke derdhur lotë.

Në shoqëritë injorante qarja është aq e zakonshme sa që njerëzit do të kënaqen në të, madje edhe pa asnjë arsye. Ata qajnë derisa dëgjojnë lajmet në Tv ose kur shohin një film dramatik. Madje ata qajnë edhe kur janë të gëzuar, në ceremonitë e diplomimit, martesë etj. Derdhja e lotëve është bërë pothuajse traditë.

Njerëzit të cilët janë udhëzuar për dobitë e të qarit e kuptojnë shumë shpejt se kjo është poashtu armë e fortë që mund të përdoret në situata të veçanta. Kjo vërtetë, është një mënyrë jo e sinqertë e të realizuarit të qëllimeve të cilat ndryshe nuk mund të realizohen. Kjo ndodh sepse të qartë flet drejtpërsëdrejti për ndjenjat dhe zgjon ndjenjën e mëshirës në shoqëritë injorante. Sëkëndejmi, është një metodë efikase për të abuzuar me ndjenjat e njerëzve të tjerë. Është një fakt i kryer, që kur bëhet fjalë për të qarët, njerëzit injorantë në të shumtëne rasteve do të pranojnë propozime të cilat normalisht do t'i hidhnin poshtë.

Nga përvoja, ata që qajnë e dijnë mirë dobitë e kësaj sjelljeje. Duke filluar nga fëmijëria e hershme, secili anëtar i shoqërisë injorante i drejtohet qarjes me qindra herë dhe

secilën herë ia del të marrë atë që dëshiron. Një përvojë e tillë jep një përcaktim të paepur për të përdorur këtë armë; për të arsyetuar një sjellje të veçantë, për t'u dukur i sinqertë etj., ose nga njëherë vetëm sa për të tërhequr vëmendjen.

Sidoqoftë, Kurani pohon se të qarët është një fatkeqësi që e godet njeriun, e jo një favor që i është dhënë atij. Kjo është shpjeguar më tutje në ajetin vijues:

Le të qeshin pak (në dunja) e le të qajnë shumë (në botën tjetër). Ai është shpërblim i asaj që fituan.. (Surja Tevbe: 82)

Në Kuran është shpallur qartë se njerëzit e ferrit nuk do ta arrijnë lumturinë, paqen dhe qetësinë edhe nëse duan. Sëkëndejmi, sigurisht nuk është urtësi që të rivalizohet me njerëzit e ferrit në këtë botë. Në shumë pjesë të Kuranit, përsëritet se mjerimi është vetëm një veti e njerëzve injorantë:

Do të këshillohet ai që ka frikë, E do t'i shmanget asaj, ai që është shumë i keq, (Surja A'la: 10-11)

Unë u kam tërhequr vërejtjen për zjarrin të ndezur fort. Që aty nuk hyn tjetër, pos atij që është më i prishuri. (Surja Lejl: 14-15)

E kur të vijë ajo ditë, askush nuk do të flasë, pos me lejen e Tij, e prej tyre (të tubuarëve), ka fatzi dhe fatbardhë. (Surja Hud: 105)

Të qenit i/e ofenduar

Një ndër manifestimet e emocionalizmit është të ofenduarit e lehtë. Siç sygjeron edhe fjala emocionalizëm, faktori që dominon sjelljen e personit janë ndjenjat e tija. Kur udhëheqin emocionet, nuk mbetet hapësirë për mençuri. Në këtë rast, bëhet pothuajse e pamundur për individin emocional që të merret me çështjet në mënyrë të arsyeshme. Kjo në të vërtetë është shkak që të ofendohen lehtë.

Personi që përcepton ngjarjet me prirje joracionale të mendjes supozon se gjithçka vërtitet rreth tij. Ai supozon se secili flet për të dhe bën plane kundër tij. Kjo tendencë që veçanërisht drejton sjelljen e të gjithë anëtarëve të shoqërive injorante bëhet pothuajse obsesion. Duke u rritur personi kjo tendencë bëhet e dukshme qartë. Pavarësisht se a ka të bëjë me ta apo jo, të moshuarit e marrin gjithçka si ofendim. Për më tepër, ata gjenerojnë skenare të imagjinuara; ata mund të kenë kujdes shumë të mirë por ata supozojnë se fëmijët e tyre nuk i duan dhe se duan t'i dërgojnë në shtëpi pleqsh. Ata mëtutje mendojnë se janë pengesë për fëmijët e tyre.

Kjo në fakt është rezultat i rrethit të pasigurtë që krijon morali i injorancës. Mënyra se si sillen anëtarët e shoqërisë injorante me të vërtetë mund të përceptohet lehtë si ofendim. Sjellja e pamëshirshme, hipokrite e hakmarrëse sigurisht që është mjaft shqetësuese, veçanërisht kur dikush konsideron mundësinë që një sjellje e tillë të jetë e qëllimshme. Megjithkëtë këto shpjegime nuk justifikojnë sjelljen e keqe të të qenit lehtë i ofenduar. Sidoqoftë, kjo

është e rëndësishme në kuptimin që shpalos bazën e prishur mbi të cilën qëndron morali i injorancës. Një person i moshuar që rri me të birin e nipërit ndjehet i ofenduar, por sigurisht që ka një arsye pse ai ndjehet ashtu. Të vjetrit përgjithësisht përceptohen si pengesa në shtëpi dhe nuk janë të pëlqyeshëm. Sidoqotë këto ndjenja janë vetëm të nënkuptuara dhe nuk thuhet kurrë drejtpërsëdrejti.

Kur njëherë të kenë adoptuar këtë karakter emocional njerëzit injorantë jetojnë me të derisa të vdesin. Për më tepër, ata vuajnë shumë nga ana negative e këtij karakteri. Në një ambient ku secili e trajton tjetrin në mënyrë miqësore, ata që ofendohen lehtë nuk jetojnë kurrë në lumturi e paqe të vërtetë. Kur gjithë të tjerët kënaqen, ata rrijnë të vetmuar në qoshe.

Siç e kemi parë, çdo aspekt i injorancës krijon ambient të pakëndshëm.

Në anën tjetër, në zbatimin e Kuranit, njerëzit zhvillojnë karakter transparent. Me fjalë tjera, ata thonë atë që mendojnë. Nëse ka diçka që nuk u pëlqen, ata e thonë qartë dhe kurrë nuk orvaten të lënë të kuptohet përmes shikimit, gjesteve ose qëndrimit tjetër. Kështu, meqë ata janë të rrethuar me njerëz që janë poashtu të pajisur me këto morale, askush nuk ndjehet i ofenduar nga qëndrimi i të tjerëve. Në Kuran, Allahu urdhëron njeriun që të urdhërojë të drejtën e të ndalojë të ligën. Një qasje e tillë eliminon tërësisht situatat e pakëndshme që kanë gjasa të rezultojnë nga emocionalizmi.

Të gënjerit

Njerëzit injorantë tregojnë shumë shpesh gënjeshtër. Pothuaj të gjitha raportet shoqërore janë të bazuara në mashtrim.

Një person i ndershëm e i sinqertë nuk e ulë kurrë veten duke thënë gënjeshtër. Në anën tjetër, personi që e rregullon jetën e vet të bazuar në sistem hipokrit duhet pashmangshëm të përdorë metoda të pandershme për të arritur sukses. Të gënjerit është një ndër këto metoda të pandershme që aplikohen intenzivisht. Kur njëherë personi ta besojë këtë si një metodë funksionale, ai fillon të ngushëllohet në të në mënyrë të vazhdueshme dhe pothuaj e shndërron këtë në stil jetese. Gjuha e mendja e tij mësohen me idenë e të gënjerit, kështu që ai kënaqet në këtë praktikë saherë që ballafaqohet me probleme. Në shoqëritë injorante kjo është një shprehje që është në pajtim me miratimin shoqëror, gjithmonë derisa nuk ka pasoja të dëmshme. Madje edhe thënja e gënjeshtërve mikut më të afërt konsiderohet normale. Vetëm kur këto gënjeshtër fillojnë të paraqesin kërcënim për mirëqenjen materiale ose shpirtërore e veçanërisht për interesat personale, viktimat fillojnë të shprehin neverinë për të. Shkurt, edhe pse të gënjerit është në përdorim të gjerë, ajo shkakton vuajtje serioze në shoqëritë injorante. Por, vuajtja që do të shkaktojë në jetën e përtejme do të jetë shumë më serioze.

Allahu paralajmëron njeriun kundër dhëlpërive sipas urdhërave të Tij:

Pra, kështu: Kush madhëron atë që All-llahu e bëri të shenjtë, ajo është më e dobishme për te Zoti i vet. Juve u janë lejuar kafshët, pos atyre që u lexohen (në Kur'an) pra largohuni nga ndytesitë e idhujve dhe largohuni fjalës shpifëse. (Surja al-Haxh: 30)

Në një ajet tjetër, ai e shpjegon natyrën e njerëzve që tregojnë gënjeshtria:

Gënjeshtren e trillojnë vetëm ata që nuk i besojnë argumentet e All-llahut; të tillët janë ata gënjeshtarët. (Surja Nahl: 105)

Në shoqëritë e besimtarëve, sidoqoftë, çdo bazë për gënjeshtren është e eliminuar tërësisht. Për shembull njerëzit injorantë gënjejnë sepse ata thjeshtë duan që të mbulojnë gabimet ose pamaturinë e tyre ose sa për të lënë përshtypje të mirë te të tjerët. Ata gënjejnë me qëllim që të mashtrojnë njerëzit për të pasur ndonjë dobi, shkurt për të fituar çfarëdo lloj përfitimi të kësaj bote. Besimtari, në anën tjetër, i përmirëson gabimet dhe i korrigjon e jo t'i mbulojë ato. Ai nuk bën miqësi me njerëz që nuk i pëlqejnë. Miqtë e tij janë vetëm ata që synojnë kënaqësinë e Allahut dhe kështu sillen me nder e përgjegjësi ndaj Allahut. Kështu, nuk ka asnjë bazë për besimtarin që të gënjejë. Ai nuk u ofrohet njerëzve me shpresë për të përfituar diçka. Ai është i sinqertë për jetën e tij; ai nuk ka asgjë për të fshehur dhe kështu nuk ndjen nevojë për të gënjyer. Prandaj, besimtari jeton në rehati me të qenit i besueshëm gjatë tërë jetës së vet.

Sjelljet e përcipta

Me qëllim që të arrihet caku, njerëzit injorantë do të lëshohen në gjithçka edhe pse e dijnë se moralisht ajo është e gabuar. Kjo në të vërtetë është arsyeja se pse sjelljet e përcipta janë mjaft të zakonshme. Në kundërshtim me besimet mbizotëruese se sjelljet e përcipta janë tipike për një pjesë të caktuar të shoqërisë, ato zakonisht përputhen me sjelljen e të gjithë anëtarëve të shoqërisë injorante. Njerëzit në përgjithësi besojnë se sjellja e tillë është e veçantë për njerëzit e pakulturuar dhe të paedukuar. Sidoqoftë, këto sjellje janë pasojë fundamentale e të metës në të arsyetuar. Sëkëndejmi, pavarësisht inteligjencës, kulturës ose edukatës, të gjithë njerëzit që i binden parimeve të injorancës paraqesin sjellje të tilla.

Sjelljet e përcipta, në realitet, sinjalizojnë të gjitha llojet e qëndrimeve e të sjelljeve që rrjedhin nga moralet e injorancës. Kur njëherë të ketë rënë në këtë nivel, individi tregon tendencë natyrore për të demonstruar gjithë sjelljen primitive të injorancës. I pajisur me idenë se sjellja jo e mirë i shërben qëllimit të tij, personi që vjen nga shoqëria injorante nuk shfaq as hezitimin më të vogël për të treguar gënjeshtër, për të shfaqur lakminë, ose për të qenë xheloz ose vetjak. Arsyeja kryesore që e shtyn personin injorant që të sillet në ëmnyrë kaq të poshtër është fakti se, në ndjekjen e pëfitimeve të kësaj bote, ai e lejon veten shumë shpejt që të lërë anash sjelljet fisnike dhe që të shfrytëzojë principet e ulëta të injorancës.

Si të gjitha karakteristikat e injorancës, sjelljet e përcipta janë poashtu të indoktrinuara në vitet e hershme të fëmijërisë.

Mos i ndaj sheqerkat me fëmijët e tjerë, ose mos l beso as babait tënd, janë disa pjesë tipike të këshillave që u jipen fëmijëve kur ata janë ende të rinj. Nisur nga një botëkuptim i tillë, njerëzit injorantë në mënyrë të pashmangshme i bazojnë parimet morale të tyre në të arsyetuar sipërfaqësor — plotësisht pa vlera fisnike e virtuoze. Më vonë në jetë ata demostrojnë versione “të përmirësuara” të sjelljeve të tyre të këqija siç është mungesa në të menduarit e gjerë.

Për shembull, në jetën e biznesit, drejtori i kompanisë i cili është gjithmonë i keq ndaj ndërvartësve të tij të cilëve u jep urdhëra e u bërtet, e paraqet një karakter krejtësisht tjetër kur pronari i kompanisë viziton zyrën. Kur mbërrin shefi, drejtori përnjëherë bëhet person i nënshtruar, i gatshëm që t’u bindet shumë urdhërave që i jepen nga shefi. Ndërkohë, ai bëhet i këndshëm edhe ndaj ndërvartësve të tij. Ai bën gjithçka që të kënaqë shefin e tij. Në këtë rast, ai guxon të bëjë gjëra të pabesueshme. Njerëzit e tillë e marrin përsipër rrezikun e të qenit i degraduar ose i poshtëruar në shoqëri. Megjithatë, kurrë nuk ndjehen të ofenduar.

Është interesante se këta njerëz janë të edukuar dhe kanë diploma universitare. Megjithatë dëshira për t’u promovuar i bën ata që të sillen në mënyrë aq degraduese. Ata besojnë se ky është realiteti jetësor. Edhe pse e dijnë që është mënyrë e keqe e sjelljes, ata e shohin këtë si një pjesë thelbësore që të promovohen në jetën e biznesit. Sigurisht ata nuk e respektojnë shefin e tyre por paratë dhe statusin.

Qasje e njëjtë është shihet edhe në shtëpi. Le të marrim si shembull qëndrimin e njerëzve injorantë ndaj vizitorëve të

padëshiruar. Vizita nga miqtë e tillë të padëshiruar shmanget përmes gënjeshtreve në telefon. Nëse vizitori vjen i paparalajmëruar, ata vetëm rrijnë të qetë në shtëpi, pa bërë zhurmë, duke pritur që ai të largohet. Ata e shohin mikpritjen si një pengesë dhe e shprehin mos pëlqimin e tyre për këtë në mënyrë të hapur. Nëse u duhet ta argëtojnë dikë, ata fillojnë të flasin prapa shpinës së tij sapo ai të ketë shkuar. Ata e dijnë mirë se është jomorale që t'i flasësh dikujt në fytyrë si mik i ngushtë dhe që pastaj t'i flasësh prapa shpinës, por ata nuk mund të mos kënaqen në sjellje kaq të ultë.

Në jetën e përditshme, mund të jipen shembuj të tjerë të ndryshëm që lidhen me arsyeshmëri të tillë të përciptë. Për shembull, është sjellje e zakonshme për njerëzit injorantë që të nguten në autobusë, duke shtyrë të tjerët anash, në mënyrë që të ulen afër dritares. Ose në autobus ata nuk ua lëshojnë karriget të vjetërve ose të sëmurëve që duhet të udhëtojnë duke qëndruar në këmbë. Edhe pse nuk janë të uritur e mund të blejnë ushqim të mirë, ata me lakmi hanë diçka vetëm sepse jipet falas. Ngjashëm, në qendra tregtare, ku jipen mostra të të mirave falas, ata presin disa herë në rradhë që të marrin më tepër sosh. Për më keq, ata e bëjnë shprehi për të kaluar rradhën. Ata kujtojnë se një sjellje e tillë është shenjë e mençurisë dhe i etiketojnë si “budallenj” ata që janë mjaft modest që të mos sillen në këtë mënyrë të pavlefshme.

Sigurisht, ajo që ata e quajnë mençuri është thjeshtë të qenit vetjak dhe të mbrojturiot e interesave vetjake. Njerëzit të cilët i quajnë budallenj, në anën tjetër, janë njerëz fisnikë që nuk e lejojnë veten të degradohen.

Personi që zbaton parimet morale të prezentuara në Kuran silltet në mënyrën më të ndershme. Pa marrë parasysh se sa imponuese mund të jenë kushtet, ai nuk pushon kurrë së bëri çdo gjë që e degradon atë apo të tjerët.

Malli

Një tipar goditës i të gjitha pjesëve të shoqërive injorante, nga njerëzit e getove e deri te anëtarët e shoqërisë së lartë, është fakti se ata kanë mall për gjëra që nuk mund t'i realizojnë. Në kundërshtim me pikëpamjet e mbajtura, përmallimi I tillë nuk është tipar tipik për disa pjesë të shoqërisë. Në vend të kësaj, është një tipar që mbizotëron në të gjitha shtresat e shoqërisë. Sidoqoftë, meqë e shohin këtë si degraduese, njerëzit në përrgjithësi i shmangen njohurisë se ata kanë tendencë që të mbajnë mall për gjërat që nuk mund t'i kenë dhe thjeshtë ia mveshin këtë të metave të të tjerëve.

Si edhe me të gjitha çështjet e tjera, modeli ideal është përcaktuar jo nga vetë njerëzit por nga shoqëria injorante. Ve[oritë që janë esenciale për të realizuar një shkallë të caktuar të epërsisë në shoqëri janë të njohura për secilin: që të jenë të arsimuar mirë, të jenë të shkathtë në gjuhët e huaja, të udhëtojnë shpesh jashtë vendit, të shkojnë në kafiteritë e restorantet e njohura, të jenë të ndërgjegjshëm për modën, të kenë vetura luksoze dhe karta prestigjioze të kreditit. Këta janë faktorët që ju bëjnë të jeni dikushi me rëndësi në shoqëri. Kjo poashtu është mënyra e jetesës që e kanë për zemër njerëzit injorantë. (Me që ra fjala, ne duhet të përmendim se është vështirë që të arsimuarit ose aftësia për të folur gjuhë

të huaja të jenë vlera personale). Megjithatë, është gabim që të përdoren aftësitë e dikujt thjeshtë për t'u treguar).

Për shumicën e njerëzve, sidoqoftë, realizimi i standardve të larta të jetesës është e pabesueshme. Kjo në të vërtetë është pika ku fillon malli për jetën e njerëzve të tjerë. Ata që janë të pazotët për të realizuar jetë të tillë provojnë të fitojnë respektin e atyre që janë pajisur më mirë, së paku duke u orvatur të bëhen si ata.

Sidoqoftë, ata që ndjekin udhëzimet e Kuranit, janë të vetëdijshëm se të gjitha gjërat, që njerëzit i kanë mall në këtë jetë nuk janë të përhershme. Ky fakt, që do të kuptohet nga disa njerëz vetëm kur ata të kenë arritur në jetën e përjetshme, kuptohet mirë nga besimtarët. Sëkëndejmë besimtarët kurrë nuk kanë mall për stilin e jetesës tjetër, përveç asaj që është projektuar si e mirë nga Kurani. Edhe nëse janë më të pasurit ose më të mençurit në botë, ata nuk e përdorin ato që t'i impresionojnë të tjerët. Duke e ditur se pasuria dhe pushteti jipen si të mira nga Allahu, ata i vënë këto gjëra në përdorim të mirë dhe ndjehen falënderues ndaj Krijuesit. Allahu, në ajetin vijues, e bën të qartë se gjëja e vetme me vlerë në prezencën e Allahut është frika nga Allahu.

O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat) e All-llahu është i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë. (Surja Huxhurat: 13)

Frika dhe ankthet e injorancës

Njerëzit injorantë janë të paaftë për ta pranuar faktin se është Allahu ai që ka fuqinë absolute mbi të gjitha gjërat. Kjo është arsyeja, pse duke filluar nga fëmijëria, ata zhvillojnë frikë joracionale për gjithçka. Më vonë gjatë jetës, kjo frikë bëhet burim i përhershëm i bezdisë e vështirësive. Çdo incident që ndeshet në jetë bëhet burim i plotë i pazbatuar i ankthit; ata gjithmonë janë të cënueshëm. Për shembull ata u frikësohen nejrëzve të tjerë. Ngjashëm, ngjarjet e zakonshme siç janë tërmetet, vetëtimat dhe tornadot fusin frikë vdekjeprurëse në zemrat e tyre.

Në Kuran, Allahu jep shembull të atyre që adhurojnë zotëra tjerë përveç Allahut:

All-llahu solli një shembull: Një njeri (rob) në posedimin e të cilit ishin ortakë pa marrëveshje mes vete dhe njëri (rob) që është thjesht në posedimin e një njeriu. A janë ata të dy të një lloji (të një gjendjeje)? Lavdërimi i takon vetëm All-llahut, por shumica e tyre, nuk e dinë.

Ti do të jesh i vdekur, e edhe ata do të jenë të vdekur. E pastaj, në ditën e kijametit pranë Zotit tuaj do të grindeni mes vete. (Surja Zumer: 29-31

Në të vërtetë mund të bëhet një listë e situatave nga të cilat frikësohen njerëzit e zhytur në injorancë me shumë zotëra. Këto janë situata që ata i përceptojnë se janë rrezik i vërtetë për mirëqenjen e tyre. Të qenët i sëmurë, të pushuarit nga puna, bankrotimi, jo martesë ose mos pasja fëmijë, bashkë me shumë ankthe tjera, dyshimi, frika, imazhe,

mendime ose brenga për të ardhmen e kthejnë jetën e tyre në gjendje të skëterrshme. Veç kësaj ata kanë frika dhe mendime të përsëritura të cilat janë të paaftë t'i kontrollojnë, edhe pse e kuptojnë se janë të panevojshme e jorelevante. Paragjykimet janë ndër këto frika joracionale; ata i frikësohen territ, u ikin macave të zeza ose ecjes nën shkallë, duke besuar se kjo u sjell fat të keq.

Në faqet në vijim do të shohim aspekte të ndryshme të këtyre frikave dhe konfuzionin e humbjen që e shkaktojnë si në këtë edhe në botën tjetër.

Frika nga pabesia

Njerëzit injorantë nuk i besojnë askujt, përfshirë edhe anëtarët e familjes së ngushtë. Për ta, një ditë kur të vlerësojnë se interesat e tyre janë në pyetje, ata besojnë se ka gjasa që secili t'i tradhtojë. Duke marrë parasysh faktin se ata nuk i janë dorëzuar Allahut si njerëzit që zbatojnë Kuranin, ata kanë të drejtë në këtë pikë.

Me të vërtetë, do të ishte e gabuar që të pritët mbështetje e besim i plotë nga dikush që nuk ka frikë nga Allahu ose besim në jetën e përtejme, meqë vetëm frika në zemrën e dikujt është ajo që shtron rrugën drejt sigurisë.

Një ndër masat esenciale të njerëzve injorantë është që të luftojnë efektet e dëmshme të pabesisë duke mos ia pasur besën askujt. Frika jetëgjatë e pabesisë pothuaj gjithmonë bëhet një ankth dhe manifestohet në fraza të njohura si, “Mos i beso as tët atë”.

Duke pasur gjithmonë parasysh këtë frazë, ata nuk i

besojnë askujt përveç vetes; megjithatë kjo nuk ofron aspak siguri nga pabesimtarët. Çdo ditë, gazetat raportojnë për raste të ndryshme të pabesisë. Në jetën e biznesit, partnerët mashtrojnë njëri tjetrin. Nuk është e habitshme që një arkatar që ka kaluar vite në shërbim të një kompanie mashtron shefin e tij me mijëra paund. Nganjëherë edhe bijtë tentojnë të mashtrojnë babain.

Raste të këtilla nuk mbarojnë vetëm në çështje materiale. Për shembull, gruaja ndjehet e lirë që t'ua tregojë mikeve të saja sekretet e burrit. Ose çiftet, gjatë bisedës me miqtë e ngushtë, flasin prapa shpinës së njërit tjetrit. Ngjashëm, edhe pse të martuar ata mbesin jobesnikë ndaj njërit tjetrit.

Sigurisht, ka shembuj të panumërt që mund të thuhet. Duke ndeshur shpesh këto raste, njerëzit injorantë ndjejnë një frikë të vazhdueshme se një nga këto fatkeqësi mund t'i godasë një ditë edhe ata.

Frika nga varfëria

Një ndër dobësitë domethënëse të injorantëve është frika nga varfëria. Shkak kryesor për një frikë të tillë është sistemi i paedukatë që qëndron mbi pasurinë materiale. Ata kujtojnë, se me ndihmën e parave, ata mund të jetojnë një jetë të plotë, të shpërblyer e të shëndoshë. Përndryshe, ata besojnë se do të jenë të privuar nga shumë elemente dhe përfitime të domosdoshme të jetës, siç është statusi social, që është i lidhur me prosperitetin.

Ajo që është interesante është ekzistenca e njerëzve të pasur të cilët gjithashtu vuajnë nga kjo frikë dhe gjithmonë

janë nën stres të madh. Shpesh këta njerëz shkojnë shumë larg; për shembull ata i shmangen shpenzimit të parave, madje edhe për nevoja të domosdoshme. Ata punojnë zellshëm, edhe pse kanë një shumë të konsiderueshme të parave që do t'u mjaftojë për tërë jetën. Ata besojnë se është urtësi që të grumbullojnë paratë nëpër xhirollogaritë e tyre. Kjo në të vërtetë është mënyra se si ata orvaten ta qetësojnë frikën e tyre për të ardhmen.

Megjithatë, arritjet e tyre nuk përputhet kurrë me ato që ata presin; derisa qëllimi i tyre është që të kenë një jetë të shpërblyer në këtë botë, ngjarjet përparojnë dhe ata e gjejnë veten në gjendje të plotë mërzie, që thjeshtë i turbullon ata.

Të dyja, si frika nga varfëria edhe të qenët koprrac janë pasojë e mosbesimit në Allah. Allahu i paralajmëron njerëzit kundër të qenit të mbërthyer nga kjo frikë:

Djali ju frikëson nga varfëria dhe ju urdhëron për të këqija, e All-llahu ju garanton falje (mëkatesh) e begati; All-llahu është Dhurues i Madh, i Dijshëm. (Surja Bekare: 268)

Mënyra e vetme për t'i qetësuar këto ankthe është bindja në Allahun, meqë frika nga Allahu i bën të gjitha frikërat tjera të pavlera.

Besimtari i vërtetë e kupton plotësisht se është Allahu ai që e furnizon atë me të gjitha nevojat. Prandaj, ai kurrë nuk ankohet për një çështje të tillë. Duke e ditur se Allahu është most zemërgjerë ndaj robërve të vet, mendja e tij preokupohet vetëm me kujtimin e Allahut dhe kurrë nuk ndjen frikë për të ardhmen.

Frika nga pleqëria

Të qenit i ri dhe i bukur është një ndër çështjet kryesore të cilës i kushtohet rëndësi në shoqëritë injorante. Gjatë tërë jetës, ambicja kryesore e njeriut është që të mirëmbajë shëndetin. Megjithatë, duhet pranuar se kjo shpesh dëshmohet të jetë një përpjekje e kotë. Të plakurit dhe sëkëndejmi humbja e pamjes dhe të qenit në shëndet të dobët janë fakte të paevitueshme të jetës, prandaj këto janë edhe burime të rëndësishme të mërisë për njerëzit injorantë. Gratë ndjehen të lira që të shprehin frikën e tyre, përderisa burrat shpesh i shmangen zbulimit se çfarë ndjejnë brenda vetes. Shenjat e dukshme të pleqërisë i prekin ata thellë. Në një mënyrë, plakja i vë një fund të gjitha sjelljeve ekstravagante. Prandaj, çdo ditë, shenjat e plakjes bëhen më të dukshme në fytyrat e trupat e tyre, e kjo u jep atyre edhe më shumë pikëllim. Megjithatë, pa marrë parasysh se sa shumë mundohen, ata kurrë nuk mund t'i rezistojnë këtij procesi natyror.

Jeta në moshë të shtyrë është padyshim krejtësisht e ndryshme nga ajo që ka qenë. Moshë e shtyer është periudhë e jetës së njeriut kur njeriu shihet si pengesë. Ata që kujdesen për të vjetrit i bëjnë pleqtë të ndjehen si burim i telasheve. Një qasje e tillë krijon ndjenja të ndryshme të shqetësimit të ta. Ata frikësohen se mos do të dërgohen në shtëpi pleqsh ose se do të mbesin vetëm. Në të vërtetë ka një arsye pse ata ndjejnë frikë. Në shoqëritë ku njerëzit nuk kanë bindje ndaj Allahut, sistemi tërësisht ka mungesë mëshire e drejtësie. Për këtë arsye, ajo së cilës i frikësohen më së shumti, bëhet realitet.

Një shkak tjetër i frikës nga pleqëria është fakti se ajo e përkujton njeriun mbi vdekjen dhe fundin e kësaj jete. Çdo shikim në pasqyrë sinjalizon shkurtimin e kohës në këtë botë. Kjo sigurisht është një torturë për pabesimtarin. Për njeriun që nuk ka besim në jetën e përtejme, fundi i kësaj jete dhe shkatërrimi i trupit nën tokë është një fund pa kthim. Meqë ai e ka rrethuar atë tërë jetën, ai frikësohet shumë që ta humbasë.

Në anën tjetër, besimtarët, nuk i frikësohen pleqërisë e as dobësive që mund të vuajnë kur plaken. Kjo ndodh sepse; ata nuk orvaten të marrin mirënjohje ose status shoqëror përmes pamjes së mirë. Ata janë të vetëdijshëm se, në prani të Allahut, besimtari lavdërohet për përsosmërinë morale e jo për pamjen. Në anën tjetër, ndër miq ata janë të dashur sepse janë të afërt me Allahun.

As lidhja e ngushtë e pleqërisë me vdekjen nuk i frikëson besimtarët. Për ta, jeta e përtejme është fillim; një fillim i një jete të pakrahasueshme e të padëgjuar, e të plotë që do të zgjasë përgjithmonë. Personi që kalon vitet e hershme duke u angazhuar në vepra të mira për të arritur Parajsën dhe kënaqësinë e Allahut hyn në moshën e shtyer me gëzim e lumturi.

Frika nga sëmundja

Ata që janë të lidhur thellë me këtë jetë, strehojnë një nervozë të brendshme dhe frikë të madhe që i turbullon saherë që mendojnë për mundësinë e sëmurjes. Ata besojnë se agjentët që prodhojnë sëmundje, mikrobet e virusët, janë

qenje të ndara, jashtë pavarësisë së Allahut. Kjo është asryeja pse këta agjentë mikroskopikë bëhen ankth për njerëzit injorantë.

Para së gjithash, të qenit i sëmurë do të thotë të jesh i deprivuar nga të mirat e kësaj bote. Madje edhe gripi është pengesë për shumë aktivitete dhe humbje e një pjese të kohës së jetesës, që edhe ashtu është e limituar. Sëmundjet e pengojnë njeriut që të udhëtojë, argëtohet, punojë... kjo sigurisht është një e çarë në sistemin e tyre tanimë të krijuar.

Duke përceptuar sëmundjen si një fatkeqësi, njerëzit e jo informuar injorantë shpesh ndjehen në ankth se mos sëmuren. Sidoqoftë, pikëpamja e besimtarëve për këtë çështje është krejtësisht tjetër: së pari, ata janë të vetëdijshëm se në një mënyrë ose në një tjetër, kjo jetë definitivisht do të mbarojë një ditë. Sëkëndejmi, nëse arrijnë t'i ikin sëmundjes, ata e dijnë se një aksident mund të ndryshojë jetën e tyre në çdo moment. Ose, ata nuk e harrojnë kurrë se procesi natyror i plakjes herët a vonë do të bëjë dëm të pakthyeshëm në shëndetin e tyre. Përveç kësaj, ata e dijnë se, përveç vullnetit të Allahut, asnjë virus ose bakterje nuk mund t'u bëjë asnjë dëm. Sëkëndejmi, kur sëmurën, ata e dijnë se çka është paracaktuar nga Allahu për një qëllim të caktuar. Nënshtrimi ndaj Allahut ofron çlirim të plotë nga frika prej sëmundjeve. Sigurisht, ata ndërmarrin të gjitha masat e mundshme që të gëzojnë shëndet të mirë. Por nëse sëmuren, ata tregojnë durim dhe shpalosin përsosmëri morale, siç tregon ajeti në vijim:

... dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë, dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën

e luftës. Të tillët janë ata të sinqertit dhe të tillët janë ata të devotshmit. (Surja Bekare: 177)

Shoqëria injorante është në frikë nga vdekja

Një ndër të metat më të mëdha të shoqërisë injorante është frika nga vdekja. Megjithatë, derisa jetojnë me këtë frikë dhe orvaten të largojnë qoftë edhe mendimin për të, ata shpërfillin faktin kryesor: pa marrë parasysh se sa fort luftojnë, jeta rrëshqet sekond pas sekonde. Se nuk ka ikje nga vdekja është përkujtuar kështu:

Kudo që të jeni vdekja do t'ju kapë, po edhe në qoftë se jeni në pallate të fortifikuara. E nëse i qëllon ata (munafikët) ndonjë e mirë, thonë: “Kjo është nga All-llahu”. E nëse i qëllon ata ndonjë e keqe: “Kjo është nga ti (Muhammed)”. Thuaju: “Të gjitha janë nga All-llahu!” Ç’është me këtë popull që nuk kupton gati asnjë send? (Surja Nisa: 78)

Thuaj: “S’ka dyshim se vdekja prej së cilës po ikni, ka për t’ju zënë, e mande do të silleni te Ai që e di të padukshmën dhe të dukshëm, dhe atëherë Ai do t’ju njoftojë me atë që keni punuar”. (Surja Xhum’a: 8)

Siç është shpjeguar nga ajetet, vdekja është një fund i pashmangshëm. Si të gjithë njerëzit, të pasurit, më të bukurit ose edhe individët më të respektuar në botë do të vdesin. Askush, pa përjashtim, nuk mund t’l ikë kësaj. Ata që

aktualisht jetojnë dhe ata që do të jetojnë ndonjëherë do të përballen gjithashtu me vdekjen në ditën e paracaktuar.

Duke e ditur këtë fakt njerëzit injorantë bëjnë orvatje të mëdha për të shtyer këtë fund dhe mundohen të nxjerrin më shumë nga kjo jetë. Vdekja do t'i ndajë ata nga të afërmit më të dashur ose miqtë dhe do të zvogëlojë të gjitha orvatjet botërore në parëndësi. Për më tepër, ata i shmangen shqiptimit të fjalës “vdekje”. Ata që përkujtojnë të tjerët për këtë, etiketohen si “të pamenduar” dhe bisedat për vdekjen shpesh ndërpriten me pretekstin se nuk është koha apo vendi i duhur për të folur për të.

Procesi mendor i njeriut është i prirur për të mos treguar kujdes se çka do ose çka nuk do. Ai madje është i prirur për të mohuar ekzistencën e gjërave të cilat ai shmanget që t'i konfrontojë. Kjo tendencë duket të jetë shumë më e dukshme kur është në pyetje vdekja. Ai i shmanget çështjeve siç është sëmundja ose moshja e shtyrë, që e përkujtojnë atë në vdekje. Frika e tij është aq e madhe saqë vetëm nëse e sheh mjekun bëhet nervoz. Ai frikësohet se mos diagnostifikohet me sëmundje fatale. Me kohë, ankthet e tilla madje ia kthejnë mendjen nga shkuarja te mjeku. Natyrisht, funeralet janë ngjarje që shkaktojnë shqetësimin më të thellë. Akti i vënjes së një anëtari të afërt të familjes ose mikut të dashur në varr përkujton pashmangshëm kohën që secili do të ndeshet me vdekjen e vet.

Sidoqoftë, kjo frikë, nuk sjell asgjë pozitive. Ata frikësohen nga humbja e jetës së kësaj bote. Megjithatë, edhe pse jetojnë gjatë, ata shpenzojnë gjithë këto vite duke u frikësuar. Kjo me

të vërtetë është fatkeqësi nga Allahu për ata që këmbëngulin në këtë frikë paragjyquese dhe nuk e zëvendësojnë atë me frikën nga Allahu.

Besimet paragjyquese

Në shoqëritë injorante, gati secili është i obsesionuar nga besimi në bestytini. Siç sygjeron fjala “bestytini”, një besim i tillë është ai që njeriu e di se është joracional, por që ai sidoqoftë insiston që t'i përmbahet. Sidoqoftë, ky është një fenomen natyror për dikë që nuk është i njohur me Kuranin, dhe kështu nuk është i afërt me Kuranin.

Një ndër aspektet më të njohura të bestytinive është se ato barten nga një brez te tjetri. Pa marrë parasysh se sa joracionale dhe e pabazë mund të jenë, shumica e shoqërive i kanë inkorporuar këto besime në mënyrën e tyre të të jetuarit.

Për më tepër, shumë shoqëri i pranojnë këto besime si rregulla dhe u përmbahen atyre përpiktë. Ata kurrë nuk ecin nën shkallë, duke besuar se kjo sjell fat të keq. Nëse shihet macja e zezë poashu është shenjë e keqe. Ata godasin në dru që t'i ikin një ngjarje të pakëndshme. Këto rregulla të panumërta, që shkaktojnë frikë të madhe, janë të formuluar nga njerëzit injorantë. Nëse ata dështojnë që të zbatojnë këto rregulla, ata ndjehen në ankth se do të goditen nga një shkatërrim.

Në të vërtetë gabimi më i madh që e bëjnë këta njerëz është se harrojnë se secila ngjarje ndodh vetëm me vullnetin e Allahut. Kështu, as shkallët e as macja e zezë nuk kanë

pushtet individual që t'i sjellin fat të keq. Sidoqoftë, njerëzit, mendjet e të cilëve janë në errësirë, bëhen të obsesionuar nga “pseudo-frikat” që ia kanë shpikur vetes.

Obsesionimi me fatin e keq

Në një shoqëri të pandriçuar besimet bestypte janë të shoqëruara në masë të gjerë me fatin e keq. Këto besime kanë ndikim të thellë në jetën e përditshme të njerëzve injorantë. Numri, ngjyra ose madje edhe personi mund të supozohet se është i mallkuar. Është pothuaj e pranuar tërësisht se numri trembëdhjetë është baraz me fatin e keq. Ngjashëm, përveç atyre që pranojnë mënyrën kuranore të të jetuarit, të gjithë njerëzit në botë do të marrin rrugë të ndryshme që t'i shmangen maceve të zeza.

Njerëzit e keqinformuar gjithashtu kanë frikë për vete, kur kanë kaluar ndonjë vështirësi. Për shembull, ata kurrë nuk veshin sërish rrobat që i kishin në kohën e një incidenti. Ose, në rast të tillë ata me nguti shesin veturat e tyre.

Frika nga të qenit i mallkuar është shumë e fuqishme ndër injorantët saqë vendimet e rëndësishme për jetët e tyre, madje edhe miqësitë, formësohen sipas tyre. Është e mundshme që një frikë e tillë joracionale të shtrojë rrugën për t'i dhënë fund një miqësie të gjatë. Sidoqoftë, përderisa nuk i japin fund frikave të këtilla, ata nuk mund të lirojnë veten nga këto obsesione. Sëkëndejmë, zgjidhja është jo në ikjen prej tyre por në zhdukjen e tyre. Mënyra e vetme për të realizuar këtë është duke braktisur të gjitha besimet e rrënjësura në injorancë dhe duke e vënë besimin në Allahun.

Fobitë

Ankthi fobik ose frika fobike është një frikë iracionale të cilën individ i fjalë e di se është jo e domosdoshme dhe jashtë kërkimesave të situatës në fjalë, por të cilën, sidoqoftë, ai është e pazoti që ta tejkalojë. Paraqitet pa ndonjë logjikë në situata të cilat zakonisht nuk duhet të shkaktojnë frikë. Sidoqoftë, përkundër të qenit problem mendor, njerëzit injorantë i pranojnë ata që vuajnë nga ankthi fobik ose nga frika fobike si njerëz normalë, e jo pacientë që u duhet tretmani. Fjalorët mjekësorë numërojnë ndërmjet 250 deri në 300 fobi. Në të vërtetë, injorantët mund të bëhen fobikë për çdo gjë. Nuk është e rrallë për personin që të ketë një listë situatash që i shkaktojnë shqetësim fobik.

Disa nga frikat mund të jenë racionale për çdo njeri. Megjithatë, frikat e individëve fobikë janë mjaft ekstreme. Për shembull, personi me frikë fobike nga gjarpërinjtë, klithë, kërcën në shtrat kur sheh gjarpërin në televizion ose gazetë. Disa i lidhin vendet e mbyllura me varrin ose vendet nën tokë dhe kështu zhvillojnë agorafobi, frikë nga vendet e mbyllura. Kjo në fakt është manifestim i frikës nga vdekja. Në mendjet e tyre, ata barazojnë errësirën me shkatërrimin dhe kështu ndjehen nervozë madje edhe në shtëpi, vend ku normalisht duhet të ndjehen të sigurtë. Ata i mveshin fuqi errësirës, syzozojnë se është e ndarë dhe e veçantë nga Allahu, dhe besojnë se është burim i gjithë të këqijave. Ata tmerrohen në errësirë, duke syzozuar se forca të padukshme qëndrojnë për ta lënduar ose vranë atë.

Ka një arsye pse këta njerëz ndjehen të tmerruar pa asnjë arsye racionale e të dukshme: ata nuk i besojnë Allahut dhe i përshkruajnë Atij. Në Kuran, Allahu tregon se frika e pabazë është joshje nga djalli dhe se nuk ka asnjë frikë as brengë për besimtarët e vërtetë që e kanë frikë Allahun.

Po atë (propagandë) e bëri vetëm shejtani që dëshironte me miqtë e vet (idhujtarët), t'ju friksojë, po ju mos u frikësoni prej tyre, frikësomënu Mua, nëse jeni besimtar. (Surja Ali Imran: 175)

Nuk është ashtu (si thonë ata), po ai që është dorëzuar All-llahut dhe është bamirës, ai e ka shpërblimin e vet te Zoti i tij, për ata nuk ka frikë, as nuk kanë pse të mërziten. (Surja Bekare: 112)

BESIMET E DEVIJUARA TË NJERËZVE INJORANTË LIDHUR ME RELIGJIONIN



Në kundërshtim me pikëpamjet që mbahen, njerëzit injorantë nuk janë të pandërgjegjshëm tërësisht për religjionin. Shumica nga ta e njohin ekzistencën e Allahut, të Gjithëfuqishmit, Atij që krijoi veten dhe krejt universin. Megjithkëtë, ata zhvillojnë një të kuptuar devijant të religjionit. Në shumë ajete të Kuranit, Allahu thotë se njerëzit nuk mund të kuptojnë ekzistencën e Allahut, meqë ata nuk mendojnë mbi krijimin e Tij:

Nëse ti i pyet ata: “Kush krijoi qiejt e tokën, kush i nënshtroi (të lëvizin) diellin dhe hënën?” Ata do të thonë: “All-llahu!” E si prapsoheni, pra? (Surja Enkebut :61)

Po nëse ti i pyet: Kush i krijoi ata, me siguri do të thonë: “All-llahu!” E si pra, i kthejnë shpinën? (Surja Zuhruf: 87)

Thuaj: “Kush ju furnizon me ushqim nga qielli e toka, kush e ka në dorë të dëgjuarit e të pamët (tuaj), kush nxjerr të gjallin nga i vdekuri e kush nxjerr të vdekurin nga i gjalli, kush rregullon çdo çështje?” Ata do të thonë: “All-llahu”. Ti thuaj: “A nuk frikësoheni?” (dënimet). (Surja Junus: 31)

Arsyeja kryesore se përse këta njerëz shmangen nga rruga e Krijuesit është lidhja e fortë që ndiejnë për këtë jetë. Për shkak të kësaj lidhshmërie, ata thjeshtë mospërfillin faktet dhe mashtrojnë veten me disa arsyetime jobindëse. Nëse kanë menduar thellë, ata do ta kupojnë se duhet të mbesin si robër të përkushtuar të Allahut gjatë tërë jetës së tyre. Nëse ndonjëherë e kanë besuar Allahun, ata do ta kuptojnë ekzistencën e jetës së përtejme dhe do ta dijnë se duhet të përgatiten për të. Sidoqoftë, ata rezistojnë fuqishëm që ta bëjnë këtë meqë një qëndrim i tillë fton për përkushtim ndaj jetës tjetër në vend të jetës së kësaj bote. Në një situatë të tillë, kursi i adoptuar nga njerëzit injorantë është që të mos mendojnë për këtë.

Në këtë pikë, besimet e çoroditura sa i përket religjionit vijnë për shpëtimin e tij. Këto besime e ndihmojnë të zhytyrve në errësi të qe ti shmangen ndërjegjes së fajshme. Përkundër llojshmërisë së këtyre besimeve, arsyeja që shtron bazën për to është një e vetme: të shmangurit e të qenit rob i Allahut.

Secili nga këto besime të çoroditura është shpjeguar në detaje në Kuran, udhëzues fundit mbijetuar në rrugën e vërtetë për njerëzimin dhe i shpallur 1400 vjet më parë. Këto besimet të çoroditura, që do të shpjegohen në faqet në vijim,

nuk do t'i shpëtojnë qenjet njerëzore nga dënimi përjetshëm, edhe pse ato mund të shërbejnë që t'i mashtrojnë ata në këtë jetë. Në ditën e dhënjes së llogarisë secili do të gjykohet sipas veprave që ka bërë dhe askush nuk do të ketë rast që të fshehë veprat e këqija. Sipas meritës së gjykimit hyjnor, ata që binden në rrugë të drejtë do të shpërblehen me parajsë përgjithmonë. Ata që kanë gabuar do t'i kenë të gjitha për tu penduar dhe do të ballafaqohen me fund të frikshëm:

E sikur t'i shihje ata kur janë ndalur pranë zjarrit e thonë: “Ah sikur të ktheheshim (në dunja), të mos gënjejmë faktet e Zotit tonë e të bëhemi nga besimtarët!” (Surja En'am: 27)

Ata që nuk besuan shpeshherë do të kishin dëshiruar të kishin qenë myslimanë. (Surja Hixhr: 2)

Ata mendojnë se ajo që e mendon shumica është e vërtetë

Një ndër besimet e çoroditura që mbizotërojnë ndër njerëzit injorantë është se ajo që është e pranuar si e drejtë nga shumica është e vërtetë ose e vlefshme. Ajo që i mashtron ata është shpesh arsyeja e njëjtë: meqë shumë njerëz e bëjnë këtë, ata duhet të kenë një qëllim. Nëse këto parime janë formësuar brenda një grupi të respektuar lartë të njerëzve nga elita, atëherë ndikimi i këtyre parimeve ndjehet edhe më thellë ndër njerëzit injorantë. Në këtë rast, në fund nuk ngritet asnjë dyshim për vlefshmërinë e këtyre parimeve, të cilat pastaj u shërbejnë si udhëzues të jetës përgjithmonë.

Sidoqoftë, edhe pse të pranuar si të vërteta nga shumica, këto pikëpamje nuk legjitimohen me asnjë mjet. Kjo sigurisht është një kurthë e rrezikshme së cilës duhet ti shmanegn ata besimi i të cilëve në Kuran nuk është i prerë. Allahu i paralajmëron besimtarët kundër zbatimit të rrugës së shumicës:

Në qoftë se u bindesh shumicës (mohuese që janë) në tokë, ata do të largojnë ty nga rruga e All-llahut. Ata nuk ndjekin tjetër vetëm supozime dhe nuk janë tjetër vetëm se rrenacakë. (Surja En'am: 116)

Në pajtueshmëri me këtë paralajmërim, besimtarët ndjekin vetëm urdhërat e Kuranit e të ndërgjegjës së tyre. Sidoqoftë, individët injorantë kërkojnë strehë në pushtetin e shumicës në këtë botë. Ata gjithashtu shpresojnë se në jetën e përtejme të qenit pas shumicës do të shërbejë si një pretekst për mosdhënjen e përgjegjësisë ndaj Krijuesit. Sidoqoftë, ky është vetëm një mendim i dëshiruar. Ata që neglizhojnë religjionin e tyre në këtë botë do të mbesin vetëm dhe të pandihmë në jetën e përtejme:

Dhe asnjë mik nuk pyet për mikun. (Surja Me'arixh: 10)

Atë ditë të gjitha shfajësimet e bëra për t'i ikur ferrit janë të pavlera. Arsyeja mbas deklaratave: secili bënte të njëjtën, ose unë besoja se shumica kishte të drejtë, nuk do ta shpëtojë askënd nga mundimi:

E atë ditë për ata që bënë zullum, arsyetimi nuk u bën dobi e as që kërkohet prej tyre të justifikohen. (Surja Rum: 57)

Siç e bën të qartë Allahu në ajet:

Këto ajete të kësaj kaptine dhe e tërë ajo, që t'u shpall ty nga Zoti yt, janë realitet, por shumica e njerëzve nuk besojnë. (Surja Rad: 1)

Përderisa ata nuk janë në pajtim me urdhërat e Kuranit, mbizotëron ajo që e imponon shumica. Gjatë historisë ata që besojnë në Kuran gjithmonë kanë qenë pakicë.

Ata mendojnë se pas vdekjes do të zhduken

Njerëzit injorantë besojnë vetëm në atë që e përceptojnë me të pesë shqisat. Kjo qasje materialiste shtron bazën e mohimit të jetës së përtejme. Megjithatë një mohim i tillë nuk është tjetër përveçse një arsye e varfër që shpikin ata për mosbesimin e tyre. Çdo njeri i pajisur me aftësinë e të menduarit e kupton se teknikisht nuk ka ndonjë dallim midis krijimit të kësaj botë dhe botës tjetër. Fakti se njeriu erdhi në ekzistencë nga asgjëja e dëshmon se ekzistenca e çdo gjëje është rezultat i vullnetit të ushtruar nga Allahu.

Sidoqoftë, njerëzit e prirur për të mbetur injorantë thjeshtë e trajtojnë këtë realitet sikur të mos ekzistonte fare. Në Kuran, Allahut I vjen keq për shfajësimin që e bëjnë ata për të mbështetur mohimin tyre:

Ai na solli Neve shembull, e harroi krijimin e vet e tha: “Kush i ngjall eshtrat duke qenë ata të kalbur? Thuaj: “I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, e Ai është shumë i dijshtëm për çdo krijim. (Surja Jasin: 78-79)

E ata thanë: “A pasi që ne të tretemi në tokë, a thua ne rishtazi do të krijohe mi?” Por (çka është edhe më keq) ata nuk besojnë se do të dalin para Zotit të tyre. (Surja Sexhde: 10)

Sigurisht që ka një arsye për mohimin e tyre. Pas të gjithave, refuzimi i ekzistencës së jetës së përtejme justifikon lidhjen e tyre me këtë jetë. Pranimi i ringjalljes do të thotë të përkushtuarit ndaj idesë se njeriu do të thirret për të dhënë llogari për veprat e mira e të liga në Ditën e Gjykimit. Ky fakt sigurisht është i papranueshëm në kuptimin e sistemit të tyre të pabazë.

Personi që dëshmon për ekzistencën e jetës së përtejme gjithashtu duhet të dijë se duhet të përgatitet për të. Sidoqoftë, për shkak të ambicjeve të pafre të njerëzve injorantë, kjo është një gjë e vështirë për ta bërë. Sëkënde jmi, zgjidhja e vetme e ofruar nga arsyeshëmria e tyre primitive është që të mohojnë jetën e përtejme.

Sidoqoftë, një qasje e tillë është e dëmshme për injorantët; si rrjedhojë, ata bëjnë jetë të mërzitshme dhe meritojnë mundime të pandalshme në jetën e përtejme. Atëherë është e dukshme se mohimi i jetës së përtejme në asnjë mënyrë nuk është në interesin e mirë të njeriut. Përkundrazi, ai lë humbje të madhe si në këtë edhe në botën tjetër.

Ata presin që të ndodhin mrekulli para se të fillojnë së besuari

Para se të besojnë, disa njerëz presin që të ndodhin ngjarje mbinatyrore. Sidoqoftë, kjo është vetëm një metodë për t'ju shmangur së vërtetës, dhe gjatë gjithë historisë kjo është aplikuar nga të gjitha shoqëritë që ishin të patundura në mosbesimine tyre. Këta njerëz që thjeshtë kërkojnë që profetët të tregojnë mrekulli përmenden në Kuran:

E ata që nuk e shpresojnë takimin Tonë, thanë: “Përse të mos na dërgohen neve engjëj, ose përse të mos e shohim Zotin tonë?” Ata tejçmuan lartë veten dhe u sollën me arrogancë. (Surja Furkan: 21)

Ne u sqaruam njerëzve në këtë Kur’an shembuj (argumente) të çdo lloji, e shumica e njerëzve nuk deshi tjetër, vetëm mohimin. Ata thanë: “Nuk të besojmë ty derisa që të na nxjerrësh prej tokës burime. Ose, (nuk të besojmë deri që) të kesh kopshte me hurma e me rrush, e të bësh të rrjedhin vazhdimisht lumenj në mesin e tyre. Ose, (nuk të besojmë derisa) të bjerë mbi ne qiell copa - copa, ashtu si po mendon ti (se do të na dënojë Zoti), apo të na sjellsh All-llahun dhe engjëjt pranë nesh. Ose të kesh një shtëpi prej ari, apo të ngjitësh lart në qiell, po ne nuk të besojmë për ngjitjen tënde derisa të na sjellësh një libër që ta lexojmë?!” Thuaj “SubhanAllahu - i Madhërisëm është Zoti im, a mos jam unë tjetër vetëm se njeri, pejgamber?” (Surja Isra: 89-93)

E ata që nuk dinë (kurejshitët politeistë) thanë: “Përse të mos na flasë neve All-llahu, ose të na vijë ndonjë argument!” Po kështu, thëniet e tyre në mënyrë të njëjtë i patën përsëritur edhe ata që ishin para tyre. Të njëjta janë zemrat e tyre. Ne tanimë sqaruar argumentet për një popull që dëshiron të bindet. (Surja Bekare: 118)

Siç thotë ajeti, ata që presin profetin e Allahut për të treguar mrekulli gjithmonë kanë qenë jobesimtarë. Ata duan mrekulli, thellë në zemrat e tyre ata e dinë se profetët u kanë dhënë atë që është e drejtë dhe e vërtetë. Megjithatë, për t’ju shmangur këtij fakti, ata thjeshtë gjejnë arsye për të mohuar. Ky qëndrim i pandershëm tregohet në ajetin vijues:

Ata u betuan me një betim të fortë në All-llahun, se nëse u vjen atyre ndonjë mrekulli, do ta besojnë. Thuaj: “Çështja e atyre mrekullive është te All-llahu”. E ku e dini ju, ndoshta kur të vijnë ato nuk u besojnë. (Surja En’am: 109)

Ata besojnë se Allahu është lart në qiej

Njerëzit injorantë kanë besime të çoroditura për religjionin, meqë ata i bazojnë vendimet e tyre lidhur me atë se çfarë është e drejtë dhe çfarë e gabuar mbi arsyen e tyre primitive, e jo në Kuran. Në të shumtën ata i mbledhin këto besime nga prindërit e tyre ose nga njerëzit e tjerë që aktualisht i rrethojnë ata, e që ndikojnë thellë gjatë viteve të tyre të hershme. Megjithatë, këto besime, veçanërisht ato që

lidhen me ekzistencën e Allahut, i largojnë nga rruga e drejtë gjatë tërë jetës së tyre.

Shumë njerëz, që në fakt nuk mohojnë ekzistencën e Allahut por kanë përceptim të gabuar mbi Të, ndajnë gabimet bazike me ata që e dënojnë atë. Ata nuk e dënojnë krijimin, por kanë besime supersticioze lidhur me atë se ku është Allahu. Shumica nga ta mendojnë se Allahu është lart në qiell. Ata imagjinojnë se Allahu është prapa ndonjë planeti të largët dhe ndërhyjnë në çështjet e botës sonë vetëm nganjëherë. Ose, ndoshta, se Ai nuk ndërhyjnë fare: Ai krijoi universin dhe pastaj atë ia la vetvetes dhe njerëzit janë lënë të përcaktojnë fatin e tyre vetë. Megjithatë të tjerët kanë lexuar se në Kuran shkruan se Allahu është çdokund, por ata nuk e përcetojnë se çfarë do të thotë kjo në të vërtetë. Ata mendojnë se Allahu rrethon gjithçka ashtu sikurse radiovalët ose një gaz i padukshëm, i paprekshëm. Për disa, në anën tjetër, Allahu ndjell imazhin e një njeriu të vjetër të mençur.

Sidoqoftë, ata që interpretojnë e vlerësojnë të gjitha ndodhitën sipas Kuranit, kanë një të kuptuar të saktë të Allahut. Njerëzit e tillë e kuptojnë se i tërë universi ka një Sovran të vetëm, se Ai ndryshon tërë botën fizike, përfshirë qenjet njerëzore, ashtu siç do Ai, dhe se Ai nuk është i kufizuar në një pjesë ose kohë të veçantë. Ata e dinë se edhe një grimcë pluhur, e padukshme për syrin e njeriut, është nën kontrollin e tij. Ekzistenca e Allahut rrethon të gjitha gjërat dhe arsyeja e kupton këtë. Siç sygjeron ajeti: **Allahu është më afër njeriut se damari (që rrah) i qafës së tij. (Surja Kaf, 16)** ashtu siç e ka krijuar tërë këtë rregull të

gjithë përhapur, Ai është i Vetmi që e mban vazhdimisht. Ai i rrethon të gjitha gjërat e vendet siç është thënë në Kuran:

Të All-llahut janë edhe (anët nga) lindja edhe nga perëndimi, dhe kahdo që të ktheheni, aty është anë e All-llahut. Vërtetë, All-llahu është i gjerë (në bujari) e i dijshtëm. (Surja Bekare: 115)

Vetëm të All-llahut janë ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë. All-llahu ka përfshirë çdo send (Surja Nisa: 126)

Ata mendojnë se mjafton që të praktikojnë vepra të rregullta të adhurimit në vitet e vonshme të jetës

Duke ndjekur aktivitete të kota, njerëzit injorantë e kalojnë jetën duke mos bërë asgjë për jetën e përtejme. Sidoqoftë, fakti që ata dështojnë që t'i japin konsideratë jetës së përtejme u jep atyre një nervozë të brendshme. Tani e tutje, shpirti i tillë i shtyn ata në pendim. Megjithatë, në këtë pikë, ata ndjejnë nevojë që të qetësojnë këto ndjenja me preteksin: është ende heret që të jepem pas religjionit ose; tani e kam vënë mendjen në listën e prioriteteve, megjithatë një ditë do ta marr seriozisht religjionin tim. *Një ditë* e përmendur këtu, sidoqoftë, është në vitet e vonshme të jetës, kur ndjehet shumë afër vdekja.

Këta njerëz e shtyjnë përkushtimin e tyre ndaj religjionit deri në vitin e fundit të jetës së tyre. Ata besojnë se mosha e pjekurisë duhet të kalohet duke përfutur sa më shumë nga jeta. Përndryshe, ata mendojnë se jeta e tyre do të shkojë kot.

Përveç kësaj, për shkak të paaftësisë fizike që shoqëron moshën e shtyrë, do të jetë e vështirë që të gëzohet jeta. Sëkëndejmi, vetëm në vitet e vonshme ata vendosin të shfaqin përkushtim ndaj religjionit. Ndërkohë, ata ndjejnë dhimbjen e brendshme për mos ndjekjen e rrugës së vërtetë.

Ky pozicion merr përkrahje ndër njerëzit injorantë. Sidoqoftë, nëse është vetëm mosha e shtyer që sjell një ndryshim të tillë, ndershmëria e këtyre njerëzve vihet në pikëpyetje. Veç tjerash, kjo nuk është mënyrë e ndershme për t'u sjellur: duke mos lejuar që shqetësimi për jetën e përtejme të peokuptojë mendjen e njeriut në vitet e rinisë, dhe duke mos ndarë kohë për të kujtuar Allahun derisa të arrihet mosha e shtyer. Edhe kështu, ata presin që veprat e tyre të gabuara të falen.

S'ka dyshim, që është e mundshme t'i kthehemi Allahut për pendim. Allahu e fal secilin që e sheh në rrugën e drejtë dhe e mendon rrugën e tij sinqerisht. Ajeti relevant për pendim është sa vijon:

Pendim i pranueshëm te All-llahu është vetëm ai i atyre që e bëjnë të keqen me mosdije shpejt pendohen; të tillëve All-llahu ju pranon pendimin, se All-llahu është më i dijshti, më i urti. Nuk është pendim (i pranueshëm) i atyre që vazhdimisht bëjnë punë të këqia dhe vetëm atëherë kur t'i vjen vdekja ndonjërit prej tyre, të thotë: “Unë tash u pendova!” e as i atyre që vdesin duke qenë jobesimtarë. Ndaj tyre kemi përgatitur dënim të ashpër. (Surja Nisa: 17-18)

Ata që kanë humbur rrugën nga besime të këtilla të çoroditura duhet të dijnë se ata mund të mos kenë kohë për t'u plakur dhe të pendohen për veprat e këqija që i kanë bërë sa ishin të rinj. Jetërat e tyre mund të përfundojnë papritmas, duke mos i dhënë rast për t'u penduar. Në këtë rast, njeriu duhet të ketë pendim të thellë. Ky fakt është përkujtuar në shumë ajete:

E, sikur të shihje mëkatarët se si ulin kokat e veta pranë Zotit të tyre: “Zoti ynë, tash pamë dhe dëgjuam, na kthe pra edhe një herë e të bëjmë vepra të mira, se tash jemi të bindur”. (Surja Sexhde: 12)

E sikur t'i shihje ata kur janë ndalur pranë zjarrit e thonë: “Ah sikur të ktheheshim (në dunja), të mos gënjejmë faktet e Zotit tonë e të bëhemi nga besimtarët!” (Surja En'am: 27)

Ata mendojnë se do të harrohen nën çdo rrethanë

Edhe pse në esencë besojnë, shumë njerëz ngrejnë dyshime për jetën e përtejme. Ata i shmangen të menduarit serioz për Ditën e Gjykimit, meqë të menduarit për këtë i bën ata të pranojnë vdekjen dhe jetën e përtejme. Probabiliteti i ekzistimit të jetës pas vdekjes është një stimul për ta që të arsyetohen, meqë ata e dijnë se duhet të japin llogari në prezencën e Allahut për të gjitha veprat e këqija që kanë bërë gjatë jetës në këtë botë. Alternativisht, ata e

kuptojnë se do të gjykohen përfundimisht në një jetë të përgjithmonshme në mundimet e ferrit. Në këtë pikë, ata janë në mes të të qenit në pajtimit me urdhërat e Allahut dhe gjetjes së mënyrave për të lehtësuar brejtjen e ndërjegjes duke qenë të lidhur ngushtë me këtë jetë.

Të arsyetuarit e injorancës, imponon padyshim alternativë sekondare. Njerëzit injorantë e mashtrojnë veten duke menduar se ata do të falen pavarësisht se sa me papërgjegjësi janë sjellur ndaj Krijuesit të tyre. Duke kërkuar strehim në mëshirën e Allahut, ata supozojnë se Allahu do të jap mëshirën e tij në çdo rast dhe do t'ua falë jofalënderimin, veprat e këqija dhe jobesimin e tyre.

Qëndrimi i njëjtë i shfaqur nga të tjerët poashtu mund ta udhëzojë për keq njeriun. Ata e ngushëllojnë dhe mbështesin njëri tjetrin duke thënë; ne do të jemi të falur. Allahu shpreh mospajtimin e këtij indoktrinimi të injorancës në Kuran:

E pas tyre erdhi brezi që trashëgoi librin. Këta merrnin mjete të pavlerë të kësaj bote (lakmues që nuk dallonin të mirën a të keqen) e thonin: “Do të na bëhet falje”, e merrnin atë përsëri. A nuk është marrë prej tyre zotimi në librin (Tevratin) se nuk do të thonë ndaj All-llahut tjetër pos të vërtetës dhe ata e dinim mirë se çka në të (libër). Po, a nuk po kuptoni se bota tjetër është më e mirë (se ajo çka merrnit ju) për ata që ruhen. (Surja A’raf: 169)

Sidoqoftë, siç shpallet në Kuran, kjo mënyrë e të kuptuarit në shoqëritë injorante në asnjë mënyrë nuk ka vlefshmëri para

Allahut dhe në Ditën e Gjykimit. Allahu është sigurisht Falës, i Gjithëmëshirshëm. Megjithatë kjo vlen vetëm për ata që kuptojnë menjëherë veprat e tyre të këqija dhe pendohen, e jo për ata që sajojnë plane dhelpërake për të pasur dobi gjatë ndëshkimit hyjnor. Allahu përshkruan besimtarët e vërtetë si:

Edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë (mëkat) të shëmtuar ose i bëjnë zullum vetës së tyre, e përmendin All-llahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre - e kushi i falë mëkatet përveç All-llahut? - dhe që duke ditur, nuk vazhdojnë në atë që kanë punuar (në të keqen). Shpërblimii të tillëve është falja nga Zoti i tyre dhe xhenetet nëpër të cilët rrjedhin lumenj e aty do rrijnë përgjithmonë. Sa i mirë është shpërblimi i atyre që punojnë. (Surja Ali Imran: 135-136)

Ata mendojnë se e meritojnë parajsën

Të poseduarit e qëllimeve të mira në zemër është një frazë që shpjegon më së miri metodën e pranuar zakonisht nga njerëzit injorantë për të lehtësuar pendimin e tyre. Edhe pse kjo është një mënyrë e humbjes nga rruga e Krijuesit, njerëzit injorantë sypozojnë se ata meritojnë një shpërblim të përhershëm vetëm për shkak të të ashtuquajturës dëlirësi të zemrës. Ata supozojnë se janë të mirë sepse nuk i bëjnë askujt keq. Duke pasur këtë mentalitet, ata nuk shohin pengesë për të arritur në parajsë, edhe nëse kanë shkuar ndonjëherë në ferr. Sidoqoftë, sipas Kuranit, një bindje e tillë është plotësisht

e pabazë. Ky është thjeshtë një besim supersticioz siç është shpallur në ajetin vijues:

E nëse pas të këqiave që e goditë, Ne i japim të mira nga ana Jonë, ai me këmbëngulje do të thotë: “Këtë e kam arritur vet (këtë do ta kemë gjithnjë), e nuk mendoj se do të bëhet kijameti, po, edhe nëse do të kthehem te Zoti im, unë te Ai do të kemë edhe më mirë!” Ne pa tjetër do t’i njoftojmë ata që nuk besuan për atë që punuan dhe do t’u japim të përjetojnë dënim të rëndë. (Surja Fusilet: 50)

Në të vërtetë, këta njerëz dështojnë që të demonstrojnë besim të sinqertë. Ata madje edhe ngrisin dyshime për ekzistencën e Ditës së Gjykimit. Kjo në të vërtetë është metodë psikologjike e nëndijshme që merret me brejtjen e ndërgjegjes; nëse ka mundësi për ringjallje, ata e ngushëllojnë veten me bindjen se do të shpërblehen për përjetësi në parajsë, në vend se të dënohen vrazhdë.

Atij që Allahu i jep lajmet e gëzuara të një shpërblimi të përjetshëm shfaqin veti të veçanta. Të tillët e duan Allahun shumë dhe i frikësohen Atij. Personi i tillë i di urdhërat e Allahut. Ai e shpreh falënderimin ndaj Tij, i kthehet Atij dhe pendohen te Ai. Ai gjithmonë synon udhëzimin e ndriçimin e Allahut duke u angazhuar në vepra të mira. Allahu pohon se vetëm ata që demonstrojnë përkushtim ndaj rrugës së Tij do të shpërblehen.

Siç e pamë, zemra e pastër nuk është nocion kuranor. Kjo është një metodë e shpikur nga njerëzit injorantë që t’i

shmangen përgjegjësiive hyjnore dhe të lehtësojnë frikën nga dënimi i përjetshëm. Mëtuqje, bazat për një arsyeshmëri të tillë janë të panjohura. Kriteri mbi të cilin qëndron ajo sigurisht që ndryshon nga një person te tjetri. për shembull, personi mund të arsyetojë vjedhjen, duke thënë se është angazhuar në të, jo sepse dëshiron, por sepse ka nevojë. Kjo sigurisht paraqet dështim në të arsyetuar.

Atëherë ne mund të konkludojmë kështu: sistemi i injorancës qëndron tërësisht mbi jondershmërinë dhe në asnjë mënyrë nuk është i pranueshëm nga Kurani. Kriteri sipas të cilit njerëzit e fitojnë parajsën është i qartë: të mos i frikësohen askujt përveç Allahut, të duan Allahun dhe të shohin kufizimet e tij. Në Kuran Allahu shpall:

Ndërsa besimtarëve të ruajtur Xhenneti u afrohet krejt afër. Kjo është ajo që u premtohet për secilin që pendohet dhe që e ruan besën e dhënë. Për secilin që i është frikësuar Zotit pa e parë dhe ka qenë i kthyer te Ai me zemër të sinqertë. (U thuhet) Hyni në te, të shpëtuar, se kjo është dita e përjetshme. (Surja Kaf: 31-34)

Ata besojnë se do të arrijnë parajsën pasi të jenë dënuar përkohësisht në ferr

Njerëzit që zbatojnë vlerat e tyre gjithmonë gjejnë rehati duke menduar se çdo vepër e keqe do të dënohet në ferr përkohësisht. Për më tepër, kjo mënyrë e të arsyetuarit i inkurajon ata që të mëkatojnë, meqë sygjeron se jeta e

përtejme në parajsë do të pasojë pas kësaj periudhe të mundimit. Një mentalitet i tillë padashje lehtëson frikën nga dënimi i rëndë në fund të jetës. Sidoqoftë, iracionaliteti i kësaj mendjeje të errët është shpejguar kështu në Kuran:

E atë (e bënin) ngase ata thonin: “Neve nuk do të na djegë zjarri vetëm për pak ditë të numëruara, e ajo që shpifën për fenë e tyre, i mashtrroi keq. (Surja Ali Imran: 24)

Është e dukshme që ky është skenar që sjell lehtësim në zemër. Njerëzit injorantë e pranojnë se ata kanë mëkate, por ata thonë se ato janë minore dhe nuk i pengojnë për të arritur parajsën. Edhe pse kanë rast të pendohen dhe ndërrojnë mënyrat e tyre, nuk ka gjasa që ata të largohen nga pozita e tyre.

Ky sigurisht është manifestim i të kuptuarit të varfër që kanë ata mbi ferrin. Ferri, ku jobesimtarët do të mbesin përgjithmonë, është i krijuar veçanërisht për të dhënë dhembje në trupin e shpirtine njeriut. Kjo ndodh vetëm sepse jobesimtarët janë fajtorë të gabimeve të mëdha dhe drejtësia e Allahut detyron dënimin e tyre.

Të qenit jofalënderues e rebel ndaj Krijuesit, Atij që i jep njeriut shpirtin, është mëkati më i madh që mund të bëhet në univers. Sëkëndejmi, në jetën e përtejme ka një dënim të dhimbshëm për një mëkat të tillë vdekatar. Ky është qëllimi për të cilin shërben ferri. Njeriu është i krijuar që të jetë skllav i Allahut. Nëse ai e mohon qëllimin kryesor të krijimit të tij, atëherë ai sigurisht e merr atë që meriton. Allahu shpall:

Ata edhe thanë: “Neve nuk do të na kapë zjarri vetëm për disa ditë të numëruara!” Thuaj: “A

mos keni marrë prej All-llahut ndonjë premtim, e All-llahu nuk e thyen premtimin e vet, ose jeni duke thënë për All-llahun atë që nuk e dini? Po, (do të ju kapë zjarri) ai që bën keq dhe që e vërshojnë gabimet e tij, ata janë banues të zjarrit, aty janë përgjithmonë. (Surja Bekare: 80-81)

Personi mund të mashtrrojë veten lehtë në këtë botë. Megjithatë, jeta e pëртеjme do të jetë vendi ku do të shpalosen të gjitha faktet për të. Ajo që është edhe me më rëndësi, sigurisht që është se ai është një vend nga l cili nuk ka kthim prapa.

Ata besojnë se vetëm një numër i kufizuar i njerëzve do të dënohen në ferr

Kjo është një përsiatje që shtron bazën e të menduarit injorant. Ata supozojnë se ferri është një vend me kapacitet të kufizuar. Krahasuar me numrin e njerëzve që kanë jetuar në tokë ndonjëherë, ata kujtojnë se nuk ka gjasa që të gjithë këta njerëz të dënohen. Rrjedhimisht, ata kujtojnë se nuk ka gjasa që ata të jenë në mesin e atyre që do t'i ekspozohen vuajtjeve, meqë ka shumë njerëz të tjerë që e meritojnë këtë më shumë.

Sidoqoftë kjo arsyeshmëri është tërësisht e gabuar. Ata që kanë bindje të tillë nuk do ta kuptojnë fuqinë e Allahut. Sigurisht Allahu ka fuqi që të mbledhë të gjithë njerëzit e të gjitha moshave në ferr, një vend i dimensioneve gjigande përtej asaj që mund të mbërthejë mendja e njeriut. Ajeti vijues na jep një ide për ferrin:

**(Përkujto) Ditën kur Ne Xhehennemit i themi:
“A je mbushur?” E, ai thotë: “A ka ende?**

Surja Kaf: 30

E, ku e di ti se çka është Sekar? Ai nuk lë send të mbetet pa e djegur. Ai është që ua prish dhe ua nxin lëkurat. (Surja Muddeththir: 27-29)

Ata që i frikësohen Allahut edhe që besojnë pa asnjë dyshim në jetën e përtejme, e dinjë me siguri se do të ringjallen edhe gjykohen bashkë me shpirtin e tyre. Ky gjykim është drejtësi bazë e Allahut. Prandaj, ata që janë të pavëmendshëm për urdhërat e Allahut në këtë botë nuk do të shpëtohen nga vuajtjet e ferrit. Në Kuran, drejtësia absolute e Allahut është e shpjeguar kështu:

**A nuk ke kuptuar për ata që vlerësojnë vetveten?
Jo, All-llahu vlerëson atë që do dhe nuk bën padrejtë asnjë fije. (Surah Al-Nisa: 49)**

Atë ditë All-llahu ua plotëson shpërblimin e merituar, e ata e dinë se All-llahu është Ai i vërteti, i qarti në drejtësi. (Surja Nur: 25)

NJË KARAKTERISTIKË E RËNDËSISHME E SHOQËRIVE INJORANTE: PAMUNDSHMËRIA E PABINDSHMËRISË SË TYRE



Pa marrë parasysh se cili është pozicioni origjinal i tij, personi me mendje të shëndoshë dhe të kuptuar të qartë i jepet së vërteteës që ofrohet e të cilën e gjen si dëshmi të bindjes. Kjo sepse ai e di, si qenje njerëzore, se ai është i gabueshëm. Ai mëtutje e di se të mësuarit është thelbësore për të zgjeruar horizontin e dijes. Personi me të kuptuar të qartë, sëkëndejm, nuk gjen në asnjë mënyrë diçka të turpshme në të mësuar dhe në pajtueshmëri me këtë e ndërron mendjen.

Sidoqoftë, ka disa njerëz të cilët mbajnë disa paragjykime të rrënjosura të cilat pothuajse është e pamundur të eliminohen. Këta njerëz janë të prirur ndaj qasjes së caktuar

edhe vlerësojnë dëshminë e vlefshme me paragjytime. Përvoja personale që ata e mësojnë me kohë është formësuar përbrenda sistemit injorant dhe është prej një rëndësie të veçantë për ta. Sëkëndejmi, është pothuaj e pamundshme që të ndërrosh botëkuptimet e tyre. Këta njerëz njihen si kokëfortë. Në vend se të jenë të hapur ndaj ideve dhe kështu të gjejnë të vërtetën, ata insistojnë që t'u përmbahen besimeve tradicionale. Ata kurrë nuk mendojnë se mund të jenë të gabuar. Më tutje, ata mendojnë se janë të mençur. Nganjëherë edhe dëshmitë konkrete nuk ia dalin që t'ua ndryshojnë mendjet e tyre. Sidoqoftë, kjo nuk ndodh sepse ata janë të paafte për të shquar ndërmjet të mirës e të keqes, por sepse ata pretendojnë të mos e kuptojnë të vërtetën. Në Kuran, Allahu hedh fjalën ndaj këtyre të metave te injorantët në ajetin vijues:

A shpresoni se do t'u besojnë ata juve (jehuditë), kur dihet se një grup prej tyre dëgjuan fjalët e Allahut, edhe pse i kishin kuptuar, e duke qenë të vetëdijshëm (ç'bënin) i ndryshuan ato. (Surja Bekare: 75)

Nuk është e mundur që të binden këta njerëz për të vërtetën. Të gjitha orvatjet e provat për t'i bërë ata që ta shohin të vërtetën janë të padobishme. Kjo pandjeshmëri bëhet edhe më e ashpër kur është pyetje feja:

E ata që mohuan (Kur'anin dhe Muhammedin) për ta është njësoj ua tërhoqe vërejtjen apo nuk ua tërhoqe, ata nuk besojnë. (Surja Bekare: 6)

Si ndodh që provat i bëjnë disa njerëz të shohin të vërtetën, kurse dështojnë që t'i bindin të tjerët? Çka i bën ata aq kokëfortë e të pandjeshëm?

Më herët në këtë libër, ne e përmendëm disa herë lidhjen e fortë të cilën njerëzit injorantë e kanë për këtë jetë. Kjo lidhje sigurisht që shpjegon motivet prapa këtij qëndrimi të pakuptueshëm. Edhe pse ata e shohin të vërtetën qartë, ata ndjekin dëshirat e tyre të kota, meqë e dijnë se ndryshe do t'u duhet të barktisnin ambicjet e tyre dhe duhet të shndërrojnë fitimin e kënaqësisë së Allahut në qëllimin bazë të jetës së tyre. Kjo në të vërtetë është gjëja e fundit që duan ta bëjnë dhe në pajtim me këtë ata rezistojnë duke ndryshur zërin e arsyes. Këta njerëz i binden anës negative të shpirtit të tyre: një sjellje e tillë është në dëm të njeriut, siç thuhet qartë në ajetin vijues;

Unë nuk e shfajsoj veten time, pse epshi është shumë nxitës për të keqen, përveç atë që ka mëshiruar Zoti im, se Zoti im është që fal e mëshiron shumë. (Surja Jusuf: 53)

Për këtë arsye shpirti luan një rol të rëndësishëm që njeriu t'i rezistojë së vërtetës.

Një qenje tjetër që i keq udhëzon ata që kanë ambicje të forta për këtë jetë është djalli. Allahu e thekson këtë në ajetin në vijim:

Iblisi) Tha: “Për shkak se më humbe mua, unë do t'u ulem atyre (do t'u zë pusi) në rrugën Tënde të drejtë, Mandej, do t'ju sillem atyre para, prapa,

nga e djathta dhe nga e majta e tyre, e shumicën e tyre nuk do ta gjejsh që të falënderohen (të besojnë)!” (Surja A’raf: 16-17)

Bindja e këtyre njerëzve të udhëhequr nga Satana dhe nga ana negative e shpirtit të tyre, ka qenë beteja kryesore e profetëve përgjatë historisë. Të gjithë profetët gjithmonë e kanë udhëzuar njeriun në rrugën e drejtë, rrugën e Allahut, por njerëzit e tyre, përveç pakicës, kanë refuzuar. Një shembull i dhënë në Kuran sa i përket kësaj çështje është profeti Nuh dhe njerëzit e tij. Përkundër përkushtimit të profetit Nuh për të udhëzuar njerëzit e tij në rrugë të drejtë, ata insistuan në mosbesim.

Ai tha: “O Zoti im, unë e thirra popullin tim natën e ditën. Por thirrja ime vetëm ua shtoi ikjen. Dhe sa herë që unë i thërritja ata për t’u falur Ti mëkatet, ata i vënin gishtat e tyre në veshë dhe e mbulonin kokat me teshat e tyre dhe vazhdonin në atë të tyren me një mendjemadhësi të fortë. Pastaj, unë i kam thirrur ata haptazi. Pastaj unë thirrjen ua drejtoja atyre haptazi, e shumë herë edhe fshehurazi”. (Surja Nuh: 5-9)

Nuhu tha: “Zoti im, ata më kundërshtuan, ata shkuan pas atyre (paskanikëve), të cilëve pasuria dhe fëmijët e tyre vetëm ua shtuan dëshpërimin. (Surja Nuh: 21)

Qasja e pandershme e njerëzve injorantë është shpalosur në Kuran. Pa marrë parasysh se sa të fuqishme ishin provat që jipeshin, ata kthenin kokën anash nga e vërteta dhe shfaqnin

një lidhje të fuqishme me këtë botë. E pastaj ata gjejnë shumë arsye për të justifikuar qëndrimin e tyre devijant. Në Kuran, Allahu jep një llogari të çështjeve e situatave që njerëzit injorantë pretendojnë të mos i kuptojnë. Këto në të vërtetë janë çështje për të cilat ata kurrë nuk ndryshojnë mendimin. Allahu ka përmendur arsyet që gjejnë ata dhe pandershmërinë që shfaqin ata ndaj besimtarëve.

Para se të vazhdojmë me këtë çështje, do të sqarohet një ndër metodat kryesore që përdorin njerëzit injorantë për të justifikuar pandershmërinë e tyre.

Një nga mësimet e Satanës: Demagogjia

Për të justifikuar veten njerëzit injorantë shpesh drejtohen në demagogji. Kjo është metodë përmes së cilës ata ruajnë të drejtat e tyre, ose prestigjin duke përdorur fakte emocionale, të pandershme ose fakte jo të drejta në vend të arsyes. Ndaras nga këto marifete, mënyra se si sillen njerëzit është gjithashtu një element efikas i demagogjisë. Ndërpreja, të bërtiturit dhe thënja e gënjeshtreve janë metoda të njohura të demagogjisë. Jobesimtarët demonstrojnë një kapacitet të mahnitshëm për këtë art. Për të justifikuar pikëpamjet e veta ose për të krijuar superioritet ndaj të tjerëve, ata drejtohen në metoda jobindëse. Qëllimi kryesor për të gjitha këto orvatje është që t'i kundërvihen së vërtetës. Ata i bëjnë të gjitha këto orvatje që të justifikojnë veten e kështu të gjejnë pretekst që të lehtësojnë brejtjen e ndërgegjes.

Kjo, sidoqoftë, nuk është metodë e zhvilluar vetëm nga individët. Sikur edhe në shumë çështje tjera, Satana i udhëzon

ata. Deklarata e Satanës në ajetet në vijim ishte demagogjia e parë në histori.

(Zoti) Tha: “O Iblis, çka të pengoi ty t’i përulësh atij që Unë vetë e krijova? A bëre kryeneçësi, apo ke qenë prej atyre që shesin fodullëk?” Ai (Iblisi) tha: “Unë jam më i miri prej tij, mua më ke krijuar nga zjarri, e atë e krijove nga balta!” (Zoti) Tha: “dil pra prej tij (prej Xhennetit), ti je i mallkuar. (Surja Sad: 75-77)

Kur atij iu tha që t’i gjunjëzohej para Ademit, Satana refuzoi me arrogancë, dhe ofroi shpjegime të liga. Kjo ishte demagogji tipike; preteksti i tij për të mos ndjekur urdhërat e Allahut është thënë në deklaratën vijuese të Satanës: ti më ke krijuar mua nga zjarri, kurse atë nga balta. Sidoqoftë, qëllimi i tij kryesor ishte të revoltohej kundër Allahut. Krahasimi ndërmjet zjarrit e baltës ishte vetëm pretekst.

Qëndrimi i njerëzve injorantë është saktësisht i njëjtë. Ata së pari vendosën që të mos binden e pastaj të gjejnë arsye për mosbindjen e tyre. Në këtë pikë, ata bëjnë atë që bëri Satana duke aplikuar metoda të ndryshme të demagogjisë për të mbuluar pandershëminë e tyre si dhe për të rehatuar veten.

Satana i indoktrinon ata me marifet dhe u pëshpërit vazhdimisht metoda të demagogjisë në shpirt. Ndërkohë, betejat individuale për të zgjedhur ndërmjet zërit të kësaj arsyeje të shëndoshë që i pëshpërit të vërtetën dhe zërit të shpirtit të tij që flet për Satanën. Në këtë mënyrë, Sartana i qaset njeriut në të gjithë rrethanat dhe e josh atë.

Kjo është arsyeja se përse, për kohë kaq të gjatë, njerëzit

në tërë botën shfrytëzojnë tërësisht taktika e metoda të njëjta kundër religjionit. Ky fakt është nënvizuar në Kuran:

Por ja ata flasin, ashtu si flasin ata para tyre. (Surja Mu'minin: 8)

Sidoqoftë, këtu duhet përmendur një pikë: Satana është një qenje nën kontroll të plotë të Allahut ashtu sikurse edhe krijesat e tjera, si xhinët, engjujt dhe qenjet njerëzore. Në kundërshtim me pikëpamjen e zakonshme që ekziston, Satana nuk është një qenje e ndarë nga pavarësia e Allahut. Ai është në shërbim të Allahut për të provokuar njerëzit në këtë botë. Ky fakt është i shpjeguar në ajetin vijues:

Iblisi) Tha: “Zoti im, më jep pra afat deri në ditën kur ata (njerëzit) të ringjallen!” (Zoti) Tha: “Ti je prej të afatizuarve, deri në kohën e ditës së caktuar”.(Iblisi) Tha: “Zoti im, për shkak që më përzune (më largove), unë do t’ua zbukurojë (të këqiat) atyre sa të jenë në tokë (në këtë botë) dhe të gjithë ata do t’i largoj nga rruga e drejtë!”
Përveç robërve të Tu, të cilët i ke bërë të sinqertë. (Madhëria e Tij) Tha: “Kjo është rruga Ime e drejtë (e qartë)”. Se ti ndaj robëve të Mi (të sinqertë) nuk ke kurrëfarë force (as fizike as mendore), përveç atyre të humburve që vijnë pas)teje. (Surja Hixhr: 36-42

Përgjatë historisë, shumë njerëz kanë aplikuar metoda klasike të demagogjisë kur janë përkujtuar për urdhërat e Allahut. Në këtë mënyrë, ata menduan se mund t’i shmangen së vërtetës. Në Kuran, Allahu jep një llogari për këtë

psikologji të jobesimtarëve dhe llojin e demagogjisë që ata aplikojnë, që të mos jenë të bindur për të vërtetat e caktuara.

Ata nuk janë të bindur për afërsinë e vdekjes

Nuk është e mundshme që njerëzit injorantë të binden se vdekja është afër. Edhe pse ky është një realitet i skajshëm, shumica e njerëzve orvaten që të harrojnë për afërsinë e vdekjes. Vdekja pashmangshëm i jep një fund jetës për të cilën ata janë të lidhur aq shumë. Gjithashtu i përkujton njerëzit për jetën e përtejme dhe për përgjegjësitë e tyre ndaj Allahut si dhe për realitetin e ferrit. Sëkënde jmi, ata thjeshtë i shmangen të menduarit për të duke “mos menduar fare”.

Njerëzit injorantë, të cilët vendosmrisht largojnë mendjen e tyre nga vdekja, shprehin parezervë mospajtimin e tyre me të. Duke harruar se është urdhër i Allahut, ata dështojnë që ta kuptojnë se ajo është një ngjarje e paracaktuar nga Allahu. “Të mos menduarit” thjeshtë i ndal ata që të shohin se një qëndrim i tillë është një kundërshtim i hapur ndaj vullnetit të Allahut.

Njerëzit injorantë strehojnë shumë bindje të tjera iracionale sa i përket vdekjes. Për shembull, sipas tyre, vdekja e një njeriu të moshuar e të sëmure është e arsyeshme. Për më tepër, ata supozojnë se vdekja në shtrat pa vuajtje është gjëja më e mirë që mund t'i ndodhë një të moshuari. Siqodoftë, ata nuk mund t'i bëjnë ballë një vdekjeje të befshme të personit të ri. Në këtë pikë ata dështojnë që të kuptojnë që vdekja e tij ishte paracaktuar.

Një tjetër besim iracional për vdekjen sygjeron se vdekja

paraqitet si rrjedhojë e ngjarjeve të caktuara. Për shembull, për dikë që vdes në aksident trafiku ata thonë: Ai nuk do të vdiste sikur të mos ngiste në atë autostradë të ngarkuar. Në Kuran është nënvizuar l' njëjti mentalitet në ajetin:

“Sikur të kishin nderitur pranë nesh (e të mos dilnin), ata nuk do të vdisnin ose nuk do të ishin vrarë (Surah Al-i Imran: 156) dhe besimtarët janë të paralajmëruar seriozisht kundër një mentaliteti të tillë të korruptuar. Kjo ndodh për faktin se asnjë vdekje nuk vjen rastësisht. Edhe para lindjes së dikujt, vendi, koha e vdekjes janë të paracaktuara. Ky fakt thuhet në ajetin në vijim:

ne kemi urdëruar vdekjen mes jush, e nuk do ta lëmë pas. (Surja Al-Vak‘a: 60)

Përnjerëzit injorantë, vdekja e një personi, veçanërisht e anëtarit të familjes, është një incident i papritur. Për më tepër është e frikshme. Të parët e trupit të personit me të cilin ka drekuar disa ditë më parë, se si është ndrydhur tmerrshëm në veturë, është sigurisht një skenë që asnjë nuk mund ta harrojë gjatë tërë jetës. Duke parë zyrtarët si vënë të mbeturat e tij në qese kjo i përkuqton pashmangshëm për shumë fakte që njeriu është insistues e inkurajues t'i harrojë nga mentaliteti l injorancës.

Personi i cili bartet për në morg në qese najloni ndoshta disa orë më herët ishte duke folur me entuziazëm për ndërmarjen e tij të re ose për planet e fundjavës. Derisa thoshte këto plane, gjëja më e fundit që mund t'i ketë shkuar ndër mend sigurisht ishte vdekja. Megjithatë, tani trupi i tij, i mbetur vetëm në eshtra dhe mish që e pret procesi i shpejtë

i prishjes, është duke u bartur shpejt për në morg. Në morg, ai do të lihet në të ftohtë bashkë me kufomat tjera. Për disa ditë, i mbështjellë në vel, trupi i tij do të vendoset në varr. Vëzhguesi është i kredhur në dëshpërim, meqë një gjë e tillë e përkujton për ditën kur ai do të mbarojë.

Sidoqoftë, ndikimi i një ngjarjeje të tillë në shpirtin e njeriut zgjat vetëm për pak. Shpejt njerëzit injorantë i kthehen mënyrës së vjetër të të jetuarit dhe fillojnë ta shohin vdekjen si një incident të pakëndshëm. Sa më shpejt që e zënë veten me llafet e përditshme, kur përballen me realitetin e jetës, ata menjëherë u kthehen shprehive të vjetra sikur të mos ishin ata njerëz që përjetuan vdekjen aq afër vetëm pak ditë më parë. Ata madje bëjnë edhe fjalime demagogjike lidhur me vdekjen kështu duke provuar të lehtësojnë seriozitetin e situatës. Ata në mënyrë të vazhduar përmendin shkurtësinë e jetës, megjithatë kurrë me të vërtetë nuk mendojnë për të. Për më tepër, ata e inkurajojnë njëri tjetrin që të mos mendojnë për këtë.

Menjëherë pasi që mërzia për vdekjen e një anëtari të familjes të bëhet e durueshme, të afërmit e tij fillojnë të mendojnë për pasurinë që do ta trashëgojnë nga ai. Në këtë mënyrë, ata gjejnë mënyrë që të lidhen për këtë jetë, edhe kur fjala është për vdekjen.

Ata nuk janë të bindur se Kurani është shpallje e Zotit

Fakti që shoqëritë injorante nuk janë të bindura se Librat e Shenjta janë të Allahut ishte një tipar tjetër i tyre gjatë

historisë. Qëllimi kryesor që fshihet pas këtij qëndrimi është pavullneti i tyre për t'iu bindur urdhrave të Allahut. Ata thjeshtë duan të harrojnë për Ditën e Gjykimit dhe për faktin se ata do të mbahen përgjegjës për të gjitha sjelljet e tyre, meqë duan të jetojnë siç jetojnë. Sëkëndejmi, edhe pse e shohin të vërtetën, ata thjeshtë e injorojnë atë.

Qëndrimi i thjeshtë i shoqërive injorante ndaj Biblës dhe librave tjera të shenjta ka qenë i supozuar sikur edhe ndaj Kuranit. Profeti ynë i ka thirrur njerëzit në rrugën e drejtë në mënyra të ndryshme, megjithatë ata insistonin në mosbesim. Ndërkohë, me qëllim që të tejkalojnë brejtjen e ndërgjegjes, ata përdorin shumë metoda. Një nga këto metoda, që aplikon demagogjinë, është shpallur në ajetin vijues:

Dhe ata që nuk besuan, thanë: “Ky (Kur’ani) nuk është tjetër vetëm se një gënjeshtër, që e trilloi ai (Muhammedi), të cilit i ndihmuan edhe njerëz të tjerë. Pra ata (idhujtarët) bënë shtrembërim e shpifje”. Edhe thanë: “(për Kur’anin) Janë legjenda të të parëve, që ai (Muhammedi) kërkoi t’i shkruhen ato, e i lexohen atij mëngjes e mbrëmje”. (Surja Furkan: 4-5)

Ata madje thanë: “(për Kur’anin) Ëndërra të përziera, madje thanë se ai (Muhammedi) vet e trilloi, ai është poet! Le të na e sjellë një mrekulli ashtu si u dërguan të mëparëshmit (me mrekulli)!” (Surja Enbija: 5)

Është evidente se, përkundër të qenit të ndërgjegjshëm për superioritetin e profetit, njerëzit injorantë e akuzuan atë

për magji. Për më tepër, shumica syresh pohuan se Kurani u shkrua nga ai. Sidoqoftë, ata e dinjë mirë se Kurani është një shpallje nga Allahu. Ngjashëm, ata e dinjë me siguri se profeti nuk është as poet e as magjistar. Megjithatë, siç është përsëritur vazhdimisht në këtë pjesë, njerëzit injorantë thjeshtë përdorin pretekstin për të tërhequr më shumë njerëz që do të pajtoheshin me mënyrën e tyre të të jetuarit.

Në Kuran, Allahu ofron përgjigje të qarta për thënjet boshe të injorantëve:

Pra Unë betohem në atë që e shihni! Edhe në atë që nuk e shihni! Se me të vërtetë ai (Kur’ani) është fjalë (e Zotit) që e lexon i dërguari i ndershëm. Ai nuk është fjalë e ndonjë poeti, po ju nuk besoni. Nuk është as fjalë e ndonji falltori, po ju nuk besoni. Është zbritje prej Zotit të botëve!

(Surja Haka: 38-43)

A mos ata thonë: “Ai (Muhammedi) e trilloi!” Jo, por ata nuk besojnë. Pra, nëse ata janë drejt, le ta sjellin një ligjërim si ai. (Surja Tur: 33-34)

Nuk është e logjikshme të mendohet se ky Kur’an është i trilluar prej dikujt pos All-llahut, por është vërtetues i asaj (shpalljes) që ishte më parë, dhe sqarues e komentues i librit. Nuk ka farë dyshimi se është (i zbritur) nga Zoti i botëve. Përkundër kësaj, ata (idhujtarët) thonë se atë e trilloi ai (Muhammedi). Ti thuaj: “Sillne pra ju një kaptinë

të ngjajshme me këtë, madje thirrni kë të doni në ndihmë, pos All-llahut, po qe se jeni të drejtë në atë që thoni”. Por ja, ata përgënjeshtroan atë (Kur’anin) pa e kuptuar dhe pa ju ardhur shpjegimi i tij. Po kështu, gënjenin dhe ata që ishin më përpara. Shiko si ishte përfundimi i zullumqarëve. (Surja Junus: 37-39)

TË LARGUARIT NGA TË KEQKUPTUARIT QE E BART MOSBESIMI



N ë tërë libër ne kemi nënvizuar faktin se të gjitha planet që bëhen nga njerëzit injorantë i bëjnë ata që bien në telashe nga të cilat nuk mund të dalin. Edhe pse ata realizojnë standardet më të mira të jetesës, ata ende ndjehen nervozë që nuk mund të arrijnë lumturinë e vërtetë. Sidoqoftë, ka vetëm një mënyrë për t'u mbrojtur nga monotonia, pakënaqësia, paqëllimshmëria, frika e ankthi. Allahu e informon njeriun për këtë sekret të rëndësishëm në ajetin vijues:

Ata që besuan dhe me të përmendur All-llahun, zemrat e tyre qetësohen; pra ta dini se me të përmendur All-llahun zemrat stabilizohen. (Surja Rr'ad: 28)

Siç u tha në ajetin e lartpërmendur, individi e arrin lumturinë e paqen e vërtetë vetëm kur e mban mendjen të

zënë me të kujtuarit e Allahut dhe kur e kalon jetën duke bërë vepra të mira me qëllim që të aarrijë kënaqësinë e Tij. Njerëzit injorantë, të pavetëdijshëm për këtë sekret të rëndësishëm të Kuranit, besojnë se telashet nëpër të cilat kalojnë janë realitet i jetës dhe thjeshtë heqin dorë nga jetesa në disa kohë, meqë nuk mund të gjejnë mënyra për t'u ikur vështirësive. Në këtë pikë, besimtarët që janë të vetëdijshëm për këtë sekret të rëndësishëm, ndërmarrin përgjegjësi të rëndësishme të të shfaqurit **se si të pastrojnë veten nga arsyeshmëria e injorancës dhe të jetojnë të lumtur e të kenë jetë të shpërblyer, si në këtë edhe në jetën e përtejme** me fjalë tjera, të ftojnë njerëzit në rrugën e drejtë për te Allahu.

Edhe një pikë tjetër kërkon të përmendet këtu: Allahu u premtton të gjithë njerëzve nga shoqëria injorante se veprat e tyre të këqija do t'u falen nëse ata me të vërtetë besojnë Allahun dhe nëse l dorëzohen udhëzimeve të Kuranit. Në këtë mënyrë, Allahu u tregon një rrugë të gjithë njerëzve për t'i ikur shoqërive injorante.

Personi që braktis mënyrën injorante të të jetuarit dhe ia nënshtron veten Allahut, falet në prezencën e Tij. Ndërkohë, besimtarët e pranojnë një person të tillë pa paragjykime rreth mënyrës së tij të mëhershme të të jetuarit. Ndër besimtarë, personi vlerësohet sipas pozicionit të fundit. Sëkëndejm, edhe pse ai ka shkuar pas kënaqësive ekstravagante në jetën e tij të mëhershme, jeta e tij e mëparshme kurrë nuk bëhet temë e interesimit të besimtarit.

Kështu, Allahu e bën të lehtë të pasurit e jetës së mirë

përmes udhëzimit të Kuranit. Nën rrethana të tilla, do të ishte më së miri t'i dorëzojmë veten Allahut. Përkujtoni se njeriu është i lirë që të bëjë zgjidhjen e lirë: 60-70 vite bezdisëse të cilat mund të përfundojnë me ferr, vend ky që është krijuar në veçanti për të dhënë dhimbje në trupin e shpirtin e jobesimtarit. Ose, si alternativë, jetën e kaluar mes njerëzve të besueshëm, në vendet më të bukura, duke pasur gjithë të mirat që do të zgjerohen deri në qiell, një vend i bukurisë që s'mund të imagjinohet. Sigurisht që njeriu i mençur do të zgjedhë këtë të fundit; jo vetëm sepse është alternativë logjike por sepse është ajo që urdhëron ndërgjegja njerëzore. Kthimi te Krijuesi të Cilit ia kemi borxh ekzistencën tonë është sigurisht ajo që e kënaq shpirtin e njeriut.

Përkundër asaj që u tha deri më tani, mund të ketë ende njerëz të caktuar që ngrejne dyshime rreth pajtimit me të jetuarit sipas mënyrës kuranore. Në Kuran, Allahu shpall se njerëzit ndjehen më të lidhur me këtë jetë, në vend se me atë tjetrën, sepse këtë jetë e ndjejnë më të afërt:

Jo, nuk është ashtu! Por ju jeni që e doni të ngutshmen (dunjanë). Dhe e lini pas shpine atë të ardhmen (ahiretin). (Surja Kijame: 20-21)

Në këtë pikë, Kurani i këshillon njerëzit që të mendojnë për vdekjen. Një ndër arsyet kryesore pse njerëzit ndiejnë një sens të thellë të lidhjes me jetën dhe e lënë anash religjionin është të supozuarit se jeta, në të vërtetë e kufizuar në 60-70 vite, është e përjetshme. Sidoqoftë, vdekja ka gjasa që t'i japë fund jetës në çdo moment. Kur vjen vdekja, personi do të lë prapa prestigjin, diplomat, pasurinë, xhirrollogritë bankare,

kartat e kreditit, shkurt, të gjitha format e prosperitetit të cilat ose I posedon ose përpiqet t'i posedojë. Shpejt pasi të varroset, trupi i tij konsumohet nga krimbat dhe ai thjeshtë reduktohet në eshtëra. Fitimi i vetëm i tij në jetën e përtejme do të jenë veprat e mira që ka bërë për të fituar kënaqësinë e Allahut.

Sëkëndejm, ata që janë të përfshirë në mënyrën injorante të të jetuarit duhet ta shohin këtë fakt sa më parë. Pas vdekjes, ka një jetë të përjetshme. Në Ditën e Gjykimit, secili do të përballet me pasojat e sjelljes së tij. Ata që nuk janë sjellë me përgjegjësi ndaj Allahut do të shkojnë në ferr, një vend i pikëllueshëm i dënimit. Atje ata nuk kanë askë që t'i ndihmojë:

Prandaj shijoni këtë (dënim) për shkak se ju e patët harruar takimin tuaj në këtë ditë, e edhe Ne tash u harruam juve, ndaj, për shkak të asaj që keni vepruar, shijoni dënimin e përjetshëm. (Surja Sexhde:14)

Në anën tjetër, ata që sinqerisht pendohen dhe kërkojnë faljen e Allahut dhe e ndjekin udhëzimin e Tij, do të arrijnë shpëtimin, si në këtë ashtu edhe në botën tjetër.

Ata do të kenë atë që duan nga bujaria e Zotit. Ky është shpërblimi i të mirëve:

Ata te Zoti i tyre kanë çkado që dëshirojnë, e ai është shpërblimi i bamirësve. All-llahu do t'ua shlyej atyre edhe më të keqen që e punuan dhe do t'u jepë shpërblime më të mira për ata që punuan. (Surja Zumer: 34-35)

Kush bën veprë të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre. (Surja Nahl: 97)

KONKLUZION



Gjatë tërë librit ne kemi diskutuar pikëpamjet, qëllimin e ekzistencës, besimet, frikat e karakteret e njerëzve që zbatojnë mënyrën injorante të të jetuarit. Qëllimi i ekzaminimit të tyre në detaje ishte që të tregohet se si jeta pa religjion e bën njeriun të bie në keqkuptime të vrazhda. Qëllimi tjetër i rëndësishëm ishte që të bëjmë ata të mendojnë arsyeshëm për pasojat e dëmshme të preferencave të tyre, si në këtë botë ashtu edhe në botën e përtejme.

Kurani tërheq vëmendjen tonë ndaj faktit se, për ata që ndjekin dëshirat e tyre, në fund, do të ketë zhgënjim të rëndë:

E sikur të përputhej e vërteta me dëshirat e tyre, do të shkatërroheshin qiejt e toka dhe çdo gjë që gjendet në to. E megjithatë që Ne atyre u sollëm (me këtë Kur'an) famën e tyre, ata u zbrapsën ndaj përkujtimit të vet. (Surja Muminum: 71)

Meqë ndjekja e dëshirave të kota është shumë shkatërruese, secili duhet të synojë rrugët për t'ju shmangur

atyre. Ka vetëm një mënyrë për t'ju shmugur zhgënjimit: të jetuarit sipas vlerave morale të Kuranit. Kjo sepse vetëm Kurani garanton nderin që e meritojnë qenjet njerëzore. Kurani e mbron shpirtin e njeriut nga injoranca, nga të keqkuptuarit e vrazhdë, inspirimet negative, frikat iracionale, dhe të gjitha besimet e çoroditura, nga ankthi si dhe prej ferrit të përhershëm shkatërrues. Ai i garanton njeriut urti, sjellje të mirë, rreth paqësor të ngjashëm me parajsën dhe që është më me rëndësi, jetë në parajsë për tërë përjetësinë.

Ky libër përfshin referencë të gjerë të **ambientit të zymtë** me të cilin janë të rrethuar njerëzit injorantë si edhe **jetën e shpërblyer** që prezentohet në Kuran. Një krahasim midis këtyre dyjave, nga natyra, fton njeriun në udhëzimin e Kuranit. Ajeti

Ai robit të vet i shpall argumente të qarta për t'iu nxjerrë juve prej errësirave në dritë. E, s'ka dyshim se All-llahu është i butë e i mëshirshëm ndaj jush.

(Surah Al-Hadid: 9) sygjeron se ata që e zbatojnë Kuranin do të fitojnë shpëtimin e përhershëm.

Ky libër është përkujtues dhe paralajmërues për injorantët. Siç thotë ajeti: **Këto janë një përkujtim qortues, e kush do, ai e zgjedh rrugën për te Zoti i vet. (Surja Muzemmil: 19) ata që duan të ndjekin udhëzimin e shenjtë duhet të pranojnë** paralajmërimin dhe të kenë vëmendjen.

Kjo jetë është e shkurtër dhe e përkohshme. Për të gjithë njerëzit, pa ndonjë përjashtim, koha e kaluar në këtë botë

është e shkurtër sikur rrahja e qerpikut. Sigurisht që është jomençuri të neglizhohet bota tjetër vetëm për hir të kënaqësisë së përkohshme të kësaj jete. Mënyra e vetme për të fituar shpëtimin e përjetshëm është të spastruarit e vetvetes nga mësimet e shoqërive injorante dhe të zbatuarit e religjionit të vërtetë, religjionit të urdhëruar nga Allahu. Ajo që pritet nga lexuesit e kësaj libre është që të bëjnë zgjidhjen e vërtetë.

**Dhe thuaj: “Erdhi e vërteta e u zhduk e kota”.
Vërtet, e kota gjithnjë ka qenë e zhdukur. (Surja
Isra: 81)**

MASHTRIMI I EVOLUCIONIT



Darvinizmi, me fjalë të tjera teoria e evolucionit, u prezantua me qëllim të mohimit të faktit të krijimit, por që në të vërtetë nuk është asgjë përveç një marrëzi e dështuar joshkencore. Kjo teori, e cila pretendon se jeta lindi rastësisht nga materia e pajetë, u zhvlerësua nga faktet shkencore të “projektimit” të qartë në gjithësi dhe në gjërat e gjalla. Në këtë mënyrë, shkenca vërtetoi se Allahu krijoi gjithësinë dhe gjallesat në të. Propaganda e zhvilluar sot për të mbajtur në jetë teorinë e evolucionit mbështetet kryekëput në shtrembërimin e fakteve shkencore, interpretimin e paragjykuar dhe gënjeshttrat dhe pavërtetësitë e maskuara si shkencë.

Mirëpo kjo propagandë nuk mund ta fsheh të vërtetën. Fakti se teoria e evolucionit është mashtrimi më i madh në historinë e shkencës ka ardhur në shprehje shumë e më shumë në botën shkencore gjatë 20-30 viteve të fundit. Hulumtimet e bëra pas viteve të 80-ta në veçanti kanë zbuluar se pohimet e Darwinizmit janë krejtësisht të pabaza, gjë që

është thënë nga një numër i madh i shkencëtarëve. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti, shumë shkencëtarë prej fushave të ndryshme biologjia, biokimia dhe paleontologjia pranojnë gjyminë e Darwinizmit dhe e përdorin konceptin e projektimit inteligjent për të shpjeguar zanafillën e jetës. Ky “projektim inteligjent” është një shprehje shkencore e faktit se Allahu i krijoi të gjitha gjallesat.

Ne kemi ekzaminuar rënien e teorisë së evolucionit dhe provat e krijimit në mënyrë shumë të hollësishme shkencore në shumë prej punimeve tona dhe vazhdojmë ta bëjmë këtë. Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje, do të jetë shumë e dobishme që ta bëjmë një përmbledhje të saj këtu.

Dështimi shkencor i Darwinizmit

Teoria e evolucionit, edhe pse është një doktrinë që i ka fillimet në Greqinë e lashtë, u përqaftua gjerësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit Origjina e Llojeve të Çarlls Darvinit. Në këtë libër, ai doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. Teoria e Darvinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor konkret, siç e pranoi edhe ai vet, ajo ishte vetëm një “supozim”. Veç kësaj, ashtu siç e pranoi Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë”, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare.

Darvini mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat shpresonte që do të zgjidhnin këto vështirësi. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive. Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmbliidhet në tre tituj kryesorë:

1) Teoria nuk arrin të shpjegoj se si ka zënë fill jeta në tokë.

2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që tregon se “mekanizmat e evolucionit” të propozuara nga kjo teori, posedojnë asnjë force evoluese.

3) Të dhënat fosile provojnë pikërisht të kundërtën e ideve të parashtruara nga kjo teori.

Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:

Pengesa e parë e pakapërcyeshme: Zanafilla e jetës

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në Tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikua dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk është në gjendje të jap përgjigje. Por në fillim, duhet të pyetemi: Si u krijua kjo “qelizë e parë”?

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyrshme, ajo supozon se “qeliza e parë”

është shfaqur rastësisht pa asnjë projektim, planifikim apo rregullim, përbrenda ligjeve të natyrës. Sipas kësaj teorie, materia e pajetë duhet të ketë krijuar rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më të pakundërshtueshme të biologjisë.

“Jeta rrjedh nga jeta”

Darvini, në librin e tij, nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Koncepti primitiv shkencor në periudhën kur jetoi ai supozonte se gjallesat zotërojnë një konstrukt shumë të thjeshtë. Sipas teorisë së krijimit të rastësishme që besohet në mesjetë, lëndët e pajetë/inorganike, duke u bashkuar, mund të formojnë një qenie të gjallë. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi se insektet formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të provuar diçka të tillë janë bërë eksperimente nga më të çuditshmet: Një leckë e ndotur me pak grurë mbi të, në një anë, ndërsa në anën tjetër një shkencëtar, duke pritur që pas një kohe të formoheshin minj.

Gjithashtu mendohej se shfaqja e krimbave në një copë mishi ishte dëshmi e krijimit të vetvetishëm/spontan. Por më vonë do të kuptohej se ata krimba nuk formoheshin vetvetiu në mish, por nga larvat e padukshme për syrin që sillleshin nga mizat.

Madje edhe kur Darvini shkroi librin Origjina e Llojeve, besimi se bakteret formoheshin nga materia e pajetë ishte një gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

Por vetëm 5 vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui

Paster shpalli përfundimet e arritura pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata që rrëzuan plotësisht krijimin spontan, i cili përbënte gur-themel in e teorisë së Darvinit. Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonë në vitin 1864, Pasteri tha: *“Kurrë më nuk do të rimarr veten krijimi spontan prej grushtit vdekjeprurës të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë.”*¹

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pasterit. Mirëpo shkenca, e cila po përparonte duke nxjerrë në dritë ndërtimin kompleks të qelizës së organizmit të gjallë, e përforcoi edhe më tepër pavlefshmërinë e pretendimeve mbi krijimin e rastësishëm të jetës.

Përpjekjet e pafrytshme të shekullit njëzet

Evolucionisti i parë, i cili u mor me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të krijohej rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej ta bënte këtë rrëfim:

*Mirëpo, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të gjithë studimit të evolucionit të organizmave.*²

Pasuesit evolucionist të Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u ndërmor në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar

gazrat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën primitive në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Milleri formoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbulohesh se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të Tokës.³

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Milleri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte reale.⁴

Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit të njëzet për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses. Xhefri Bada, gjeo-kimisti i njohur nga Instituti Skrips i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën “*Earth (Toka)*”, pranon këtë fakt:

*Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin e njëzet: Si zuri fill jeta në tokë?*⁵

Ndërtimi i ndërlikuar i jetës

Shkaku kryesor që çështja mbi zanafillën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë është se madje ata organizma të gjallë që mendohej të jenë më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një gjallese është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. Sot, madje edhe në laboratorët

më të përparuara të botës, duke bashkuar materie kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përfitojmë një qelizë të vetme.

Kushtet që nevojiten për formimin e një qelize janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. Probabiliteti që proteinat, njësia bazë e qelizës, të sintetizohen rastësisht është 1 në 10^{950} (për një proteinë mesatare me 500 aminoacide). Në matematikë probabilitetet më të vogla se 10^{50} konsiderohen të pamundura.

Molekula e ADN-së përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. Nëse do ta hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN-ja e njeriut, do të krijohej një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secili.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë shumë interesante: ADN-ja mund ta kopjoj/përsëris vetveten vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimave). Mirëpo, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm me anë të informacionit të koduar në ADN. Pasi që ato të dyja janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për kopjim/përsëritje. Kjo e sjellë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu në një rrugë pa krye. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në botimin e revistës *Scientific American* të Shtatorit të vitit 1994:

Është krejtësisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Po ashtu duket e pamundshme ta kemi njërën pa tjetrën. Dhe

*kështu, në shikim të parë, njeriut do t'i duhej të vjen në përfundimin se, në të vërtetë, jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike.*⁶

Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u “krijua” në mënyrë të mbinatyrshme. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.

Mekanizmat imagjinarë të evolucionit

Çështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si “mekanizma të evolucionit”, u kuptua se në të vërtetë nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në tërësi në mekanizmin e “seleksionimit natyror.” Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit të tij: *Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror*...

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë evoluimin e sorkadheve e t'i kthejë në një lloj tjetër gjallese, për shembull, në kuaj.

Për këtë arsye, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet, ndaj në librin e tij Origjina e Llojeve u detyrua të pohonte:

Seleksionimi natyror s'mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale.⁷

Ndikimi i Lamarkut

Si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej nga këndvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Shevalie Lamark (1774-1829), i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat kishin fituar gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto cilësi, të cilat u akumuluan nga një brez në tjetrin, bënë që të formohen specie të reja. Për shembull, ai pohonte se gjirafat evoluuan nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga njëri brez në tjetrin Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm. Në librin e tij Origjina e Llojeve, për shembull, ai thotë se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit me kohë u shndërruan në balena.⁸

Por zbulimet e Gregor Mendelit (1822-1884) të ligjeve të trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkenca e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzet, hedhën poshtë plotësisht legjendën e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefektiv.

Neo-darvinizmi dhe mutacionet

Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët nxorën në dritë “Teorinë Sintetike Moderne”, apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e gjallesave për shkak të faktorëve të tillë të jashtëm si rrezatimi apo gabimet në përsëritje, si “shkaqe të ndryshimeve të dobishme” përveç mutacionit natyror.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p. sh., veshët, mushkëritë dhe krahët) iu nënshtruan “mutacioneve,” domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori: Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: ADN-ja zotëron një ndërtim shumë të ndërlikuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund vetëm t'i shkaktojë dëm asaj. Gjeneticisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si në vazhdim:

Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që janë të rastësishme, më parë se ndryshime të rregullta në strukturën e gjeneve; çfarëdo ndryshimi i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të ndikojë për të keq, jo për të mirë. Për shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të

rregullt siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim.⁹

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, i cili është paraqitur si një “mekanizëm i evolucionit,” është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë të gjymtuara. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv.” Seleksionimi natyror, në anën tjetër, “s’mund të bëj asgjë i vetëm,” siç e pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se nuk ekziston ndonjë “mekanizëm evolutiv” në natyrë. Pasi që nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, asnjë proces i tillë i imagjinuar i quajtur “evolucion” nuk ka mundur të ndodhë.

Të dhënat fosile: asnjë gjurmë e formave kalimtare

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sugjerohet nga teoria evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas kësaj teorie, të gjitha gjallesat kanë evoluuar nga një paraardhës. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shndërrua në diçka tjetër dhe të gjitha speciet u krijuan në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Po të kishte qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk–gjysmë zvarranik duhej të kishin jetuar në të kaluarën të cilat kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato tashmë i kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët fituan disa tipare të zogjve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqë këto gjallesa do të duhej të kishin ekzistuar në një periudhë kalimtare, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë të metash. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajnë “forma kalimtare”.

Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë do të duhej të kishte me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojlojshmëria. Ajo që është më me rëndësi, mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin *Origjina e Llojeve*, këtë fakt e shpjegon kështu:

Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin speciet e të njëjtit grup, duhet të kenë ekzistuar sigurisht... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre të mëparshme do të mund të gjendeshin vetëm në mbetjet fosile.”¹⁰

Shpresat e venitura të Darvinit

Mirëpo, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në

mbarë botën, ende nuk është gjetur asnjë formë kalimtare. Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin evolucionistët, tregojnë se jeta në Tokë u shfaq rastësisht, krejt papritur dhe plotësisht e formuar.

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse një evolucionist, e pranon këtë realitet:

Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, hasim gjithmonë e më tepër jo evolucion gradual, por shpërthim të papritur të një lloji në llogari të një tjetri.¹¹

Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të përfunduar, pa asnjë formë të ndërmjetme në mes. Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darvinit. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që gjallesat janë krijuar. I vetmi shpjegim që një specie e gjallë të shfaqet papritmas e plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ajo u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar po ashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

Krijimi dhe evolucioni janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth origjinës së qenieve të gjalla. Krijimi dhe evolucioni, në mes tyre, shter shpjegimet e mundshme për zanafillën e gjallesave. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plotfuqishëm.¹²

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në Tokë të

formuara plotësisht dhe në gjendje të përkryer. Me fjalë të tjera “origjina e llojeve,” në kundërshtim me supozimin e Darvinit, nuk është evolucioni, por krijimi.

Përralla e evolucionit të njeriut

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë kësaj periudhe të supozuar, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Ka katër “kategori” bazë në gjithë këtë skenar të imagjinuar:

1. Australopiteku
2. Homo habilis
3. Homo erectus
4. Homo sapiens

Evolucionistët i japin emrin “Australopitek” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunët. Këto qenie të gjalla nuk janë në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lordit Solli Cukerman dhe Profesorit Çarlls Oksnard, dy anatomistë me famë botërore nga Anglia dhe SHBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekëve tregojnë se këto qenie i përkisnin një lloji të majmunit të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore.¹³

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “homo,” domethënë “njeri”. Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë “homo” ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës me një renditje të caktuar dhe përpiluan një plan imagjinar evolucioni. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Majër, njëri prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij *Një argument i gjatë* pohon se: “në veçanti (enigmat) historike si zanafilla e jetës apo e Homo sapiensit, janë tejet të vështira dhe mund madje t’i bëjnë ballë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.”¹⁴

Kur konturojnë zinxhirin Australopitek > Homo Habilis > Homo Erektus > Homo Sapiens, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet më të fundit të paleo-antropologëve tregojnë se Austrolopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erektus kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës.¹⁵

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo Erektus ka jetuar deri në kohërat moderne. Homo sapiens, Neandertalët dhe Homo Sapiens Sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon.¹⁶

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto specie nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stefën Xhej Gould, njëri prej paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse

është evolucionist, e shpjegon qorrsokakun në të cilin gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët robust (shtat-mëdhenj) dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë.¹⁷

Me pak fjalë, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të krijesave imagjinare “gjysmë-majmun-gjysmë-njeri”, që shfaqen në media apo libra shkollorë, domethënë, sinqerisht, me anë të metodave propagandistike, s’janë gjë tjetër veçse një mit pa asnjë bazë shkencore.

Lordi Solli Cukerman, një nga shkencëtarët më të njohur dhe më të spikatur të Mbretërisë së Bashkuar, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e Australopitekut. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut.

Cukerman gjithashtu bëri një “spektër interesant të shkencave”, duke i radhitur ato nga ato që ai i konsideronte si më shkencoret tek ato që i konsideronte si më joshkencoret. Sipas spektrit të Cukermanit, më “shkencoret,” duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, janë shkenca e fizikës dhe kimisë. Më pas vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më “joshkencore”, radhitet “perceptimi jashtë-shqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe në fund të

fundit u vendos “evolucioni i njeriut”. Cukerman shpjegon kështu arsyetimin e tij:

Më pas zhvendosim regjistrin e të vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të konsideruara si shkenca biologjike, si p.sh. perceptimi jashtë-shqisor apo interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarrtë (i evolucionit ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë.¹⁸

Siç shihet, evolucioni njerëzor nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e “disa interpretimeve të paragjykuara të fosileve të zhvarrosura prej njerëzve të caktuar, të cilët ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

Formula e Darvinit!

Përveç të gjitha provave teknike me të cilat jemi marrë gjer më tani, le ta shtjellojmë njëherë, se çfarë paragjykimi kanë evolucionistët me një shembull të thjeshtë që të kuptohet madje edhe prej fëmijëve:

Teoria e evolucionit pohon se jeta u krijua rastësisht. Sipas këtij pohimi, atomet e pajetë dhe të pavetëdije u bashkuan për të formuar qelizën dhe pastaj ata disi formuan gjallesat tjera, duke përfshirë edhe njeriun. Le të mendojmë për këtë. Kur i bashkojmë elementet që janë bazë e ndërtimit jetës si karboni, fosfori, nitrogjeni dhe potasiumi, vetëm një grumbull formohet. Pa marrë parasysh se çfarë trajtimi i nënshtrohet, ky grumbull atomev nuk mund të formojë madje as edhe një gjallesë të vetme. Nëse dëshironi, le ta

formulojmë një “eksperiment” në lidhje me këtë çështje dhe ta shtjellojmë në emër të evolucionistëve atë që ata vërtet e pohojnë pa e shprehur zëshëm me emrin “formula e Darvinit”:

Le të vendosin materialistët plot materiale të pranishme në përbërjen e gjallesave si fosfori, nitrogjeni, karboni, oksigjeni, hekuri dhe magneziumi në fuçi të mëdha. Veç kësaj, le të shtojnë në këto fuçi çfarëdo lloj materiali që nuk ekziston në kushte normale, por që ata mendojmë se është i domosdoshëm. Le të shtojnë në këtë përzierje aq sa të dëshirojnë amino acide – të cilat nuk kanë mundësi të formohen në kushte natyrore – dhe proteina – që një e vetme e ka probabilitetin e formimit 10 në 950 – sa të duan. Le t’ia ekspozojnë këto përzierje deri në masën që dëshirojnë nxehtësisë dhe lagështisë. Le t’i përziejnë këto me çfarëdo pajisje të përparuar teknologjike që të duan. Le t’i vënë shkencëtarët më të shquar pranë këtyre fuçive. Le të presin këta ekspert me radhë pranë këtyre fuçive për miliarda dhe trilionë vite. Le të lejohen të përdorin të gjitha llojet e kushteve që ata besojnë të jenë të domosdoshme për formimin e një njeriu. Pa marrë parasysh se çfarë bëjnë, ata nuk mund ta krijojnë një njeri prej këtyre fuçive, të themi një profesor që ekzaminon strukturën e qelizës së tij nën një mikroskop elektronik. Ata nuk mund të krijojnë gjirafa, luanë, bletë, kanarina, kuaj, delfinë, trëndafila, orkide, zambakë, karafila, banane, portokaj, molla, hurma, domate, pjepja, shalqi, fiq, ullinj, rrush, pjeshka, pallojë, fazanë, flutura shumëngjyrëshe apo me miliona gjallesa si këto. Me të vërtetë,

ata nuk do të mund të përfitonin as edhe një qelizë të vetme prej cilësdo prej tyre.

Thënë shkurt, atomet e pavetëdijshme nuk mund të formojnë qelizën duke u bashkuar. Ato nuk mund të marrin një vendim të ri dhe ta ndajnë këtë qelizë më dysh dhe pastaj të marrin vendime tjera dhe të krijojnë profesorët të cilët së pari shpikin mikroskopin elektronik dhe pastaj ekzaminojnë strukturën e qelizës së vet nën atë mikroskop. Materia është një grumbull i pavetëdijshëm, i pajetë dhe ajo vjen në jetë me krijimin e lartë të Allahut.

Teoria e evolucionit, e cila pohon të kundërtën e kësaj, është një gjykim plotësisht i gabuar i kundërt me arsyen. Të menduarit madje edhe vetëm për pak kohë për pohimet e evolucionistëve zbulon këtë të vërtetë, sikurse në shembullin më lartë.

Teknologjia e syrit dhe veshit

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes "Si shohim ne?" Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet "qendra e shikimit". Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si

imazh pas një sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësi të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësi të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë në këtë errësi të plotë.

Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë. Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me të cilat e mbani atë dhe pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekrani më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër. Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikin një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3-D. Për më tepër, bëhet fjalë vetëm për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishtëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton te veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. D.m.th. truri është i izoluar nga tingujt, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të mprehtë perceptohen nga truri.

Nëpërmjet trurit tonë, i cili është i izoluar nga tingujt, ne dëgjojmë simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz. Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, do të kuptonim se një qetësi absolute mbizotëron aty.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh

kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruarit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfutuar asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga krijimi i njeriut.

Kujt i takon ndërgjegjja që sheh dhe dëgjon në brendi të trurit?

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafilut?

Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe, tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru?

Ekziston një ndërgjegje në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për një sy, vesh apo hundë. Kujt i takon kjo ndërgjegje? Natyrisht se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej Allahut, i cili nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor do të duhej të mendonte thellë për Allahun e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

Një besim materialist

Informacioni që kemi paraqitur deri tani tregon se teoria e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore. Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës është në kundërshtim me shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se format kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë. Prandaj, teoria e evolucionit duhet të hidhet poshtë si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër

Tokën, janë nxjerrë jashtë agjendës së shkencës gjatë historisë.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si “sulm ndaj shkencës”. Po pse ndodh kjo gjë?

Arsyeja për këtë situatë të krijuar është se për disa njerëz të cilët u përkasin disa qarqeve të caktuara, teoria e evolucionit është shndërruar në një besim dogmatik të domosdoshëm. Këto qarqe kapen fort pas filozofisë materialiste dhe ndikohen nga Darwinizmi, i cili për ta është shpjegimi i vetëm materialist për natyrën.

Nganjëherë ata e pranojnë hapur këtë. Riçard Levontin, gjenetist i famshëm nga universiteti i Harvardit dhe në të njëjtën kohë një evolucionist i njohur pranon se është “së pari materialist, pastaj shkencëtar”:

Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, edhe nëse janë kundër intuitës, pa marrë parasysh se sa të mjegullta janë për të panisurën. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë të dalë në skenë një Qenie Hyjnore.¹⁹

Këto fjalë janë deklarata të qarta se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo predikon se materia e pajetë dhe e

pavetëdijshme krijoi jetën. Ajo këmbëngul se miliona specie të gjalla, (si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore) u shfaqën si pasojë e bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve dhe kështu me radhë prej materies së pajetë. Ky besim është në kundërshtim të plotë si me arsyen ashtu edhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që “të mos lejojnë daljen në skenë të një Qenie Hyjnore.”

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i Cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Ky Krijues është Allahu, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, i Cili e konstruktoi atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

Teoria e evolucionit: Magjia më e fuqishme në botë

Çdo njeri i lirë prej paragjykimit dhe ndikimit të çfarëdo ideologjie të caktuar, që përdor arsyen dhe logjikën e tij apo të saj, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, i cili na përkujton besëtytnitë e shoqërive pa dijeni të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Siç u shpjegua më lartë, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijojnë profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe gjykojnë; shkencëtarë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë si

Hemfri Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçano Pavaroti; si edhe antilopa, drurë limoni dhe karafila. Për më tepër, pasi që shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjepura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për “magjinë më të fuqishme në histori.” Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër nuk ua ka larguar aftësinë e të gjykuarit të njerëzve, nuk ka pranuar t’i lejojë ata të mendojnë me mençuri dhe me arsye dhe ua ka fshehur të vërtetën sikur ata t’i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e pabesueshme se adhurimi i Zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i Diellit nga totemeve në disa pjesë të Afrikës, adhurimi i Diellit nga populli i Sabës, adhurimi i idhujve që kishin mbaruar me duart e tyre nga ana e fisit të Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) apo adhurimi i Viçit të Artë nga ana e popullit të Profetit Musa (paqja qoftë mbi të).

Në të vërtetë, Allahu ka theksuar këtë mungesë arsyeje në Kuran. Në shumë vargje, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishme të shohin të vërtetën. Disa nga këto vargje jepen në vazhdim:

Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralamjërove apo nuk i paralamjërove - ata nuk besojnë. Allahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh. (Sure Bekare: 6-7)

... Ata kanë zemra me të cilat nuk kuptojnë. Ata kanë sy me të cilët nuk shohin. Ata kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe

më të humbur! Ata janë të pavetëdijshëm. (Sure A'raf: 179)

Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë), ata vetëm do të thoshin: "Neve na janë ndalë sytë (të parët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Sure Hixhr: 14-15)

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri, t'i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos ndërpritet për 150 vjet. Është e kuptueshme se një apo disa njerëz do të mund të besonin në skenarë dhe pohime të pabesueshme përplot marrëzi dhe mungesë arsyeje. Mirëpo, "magjia" është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në mbarë botën që besojnë se atomet e pavetëdijshme dhe të pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit, rregullit, arsyes dhe vetëdijes së përkryer; një planet të quajtur Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën; dhe gjallesat përplot sisteme të panumërta komplekse.

Në të vërtetë, Kurani rrëfen ngjarjen e Profetit Musa dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët përkrasin filozofitë ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:

“Hidhni ju!” – u përgjigj ai. Kur magjistarët hodhën shkopinjtë e tyre, i magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe shfaqën një magji të madhe. (Sure A’raf: 116)

Siç kemi vënë re, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtrorjme çdo njeri, përveç Musait dhe atyre të cilët i besuan atij. Mirëpo, dëshmia e tij zhduki magjinë, apo “gëlltiti atë që ata kishin sajuar,” siç përshkruhet në ajet.

Atëherë Ne i kumtuam Musait: “Hidhe shkopin tënd!” - dhe ai filloi të gëlltiste gjithçka që trilluan ata. Në këtë mënyrë, doli në shesh e vërteta dhe dështoi ajo që kishin bërë ata. (Sure A’raf: 117-118)

Siç kemi vënë re, kur njerëzit e kuptuan se ata u magjepsën dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët e Faraonit humbën gjithë besueshmërinë e tyre. Edhe në ditët tona, përveç nëse ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pretendime qesharake nën maskën e tyre shkencore dhe kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato, i braktisin besimet e tyre paragjyquese, ata po ashtu do të poshtërohen kur e vërteta e plotë shfaqet dhe magjia priset. Në të vërtetë, Malkolm Magerixh, një filozof ateist dhe përkrahës i evolucionit, pranoi se ishte i brengosur pikërisht nga kjo perspektivë:

Unë personalisht jam i bindur se teoria e evolucionit, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmen. Brezat e ardhshëm do të çuditen se si një hipotezë aq jo bindëse dhe e

dyshimtë ka mundur të pranohej me naivitetin e pabesueshëm që ajo posedon.²⁰

Se e ardhmja nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do ta shohin se “rasti” nuk është hyjni dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit si në mashtrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë ka filluar të ngrihet me shpejtësi prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë po pyeten me habi se si është e mundur që të jenë kapluar prej saj.



*Engjujt thanë: “Larg nga të metat je
Ti o Zot! Ne nuk kemi asnjë dije tjetër
përveç asaj që na mësove Ti. Vërtet,
Ti je i Gjithëdijshëm e i Urtë.”*

(Sure Bekare: 32)



SHĚNIMET

1. Sidney Fox, Klaus Dose, *Molecular Evolution and The Origin of Life*, Ę.H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, p. 4.
2. Alexander I. Oparin, *Origin of Life*, Dover Publications, NeĚYork, 1936, 1953 (reprint), p. 196.
3. "NeĚ Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", *Bulletin of the American Meteorological Society*, vol 63, November 1982, p. 1328-1330.
4. Stanley Miller, *Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules*, 1986, p. 7.
5. Jeffrey Bada, *Earth*, February 1998, p. 40.
6. Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on Earth", *Scientific American*, vol. 271, October 1994, p. 78.
7. Charles DarĚin, *The Origin of Species by Means of Natural Selection*, The Modern Library, NeĚ York, p. 127.
8. Charles DarĚin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 184.
9. B. G. Ranganathan, *Origins?*, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988, p. 7.
10. Charles DarĚin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 179.
11. Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record", *Proceedings of the British Geological Association*, vol 87, 1976, p. 133.
12. Douglas J. Futuyma, *Science on Trial*, Pantheon Books, NeĚ York, 1983. p. 197.
13. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory ToĚer*, Toplinger Publications, NeĚ York, 1970, pp. 75-13; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt", *Nature*, vol 258, p. 389.
14. "Could science be brought to an end by scientists' belief that they have final ansĚers or by society's reluctance to pay the bills?" *Scientific American*, December 1992, p. 20.
15. Alan Ęalker, *Science*, vol. 207, 7 March 1980, p. 1103; A. J. Kelso, *Physical Anthropology*, 1st ed., J. B. Lipincott Co., NeĚ York, 1970, p. 221; M. D. Leakey, *Olduvai Gorge*, vol. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, p. 272.
16. Jeffrey Kluger, "Not So Extinct After All: The Primitive Homo Erectus May Have Survived Long Enough To Coexist Ęith Modern Humans", *Time*, 23 December 1996.
17. S. J. Gould, *Natural History*, vol. 85, 1976, p. 30.
18. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory ToĚer*, p. 19.
19. Richard LeĚontin, "The Demon-Haunted Ęorld," *The NeĚ York RevieĚ of Books*, January 9, 1997, p. 28.
20. Malcolm Muggeridge, *The End of Christendom*, Grand Rapids:Eerdmans, 1980, p. 43